



## Polis NR 6 / 2008

Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale

### Bordi Editorial

Prof. As. Dr. Romeo GURAKUQI  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Dr. Ermal HASIMJA  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Lea YPI  
European University Institute, Firenze, Itali

Enis SULSTAROVA  
Universiteti i Durrësit

### Kryeredaktor

Blendi KAJSIU  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

### Redaktor

Henri ÇILLI  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

Elda PAPA  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

### Asitent-Redaktor

Blerjana BINO  
Universiteti Europian i Tiranës (JET)

### Dizenjimi / Grafika

Gersi MIRASHI



# KORUPSIONI NË SHQIPËRI

## PËRMBAJTA

- 4 - 14 Pikëpyetje Antropologjike Mbi Korrupsionin  
**SMOKI MUSARAJ**
- 15 - 30 Konceptet Ligjore Bazë të Anti-korrupsionit: Rasti i Shqipërisë  
**DR. BRYANE MICHAEL**  
**DR. MAURIZIO VARANESE**
- 31 - 41 Rreth Shkaqeve dhe Faktorëve që Lidhen me Korrupsionin: Rasti i Shqipërisë  
**DORIAN JANO**
- 42 - 57 Në Rrënojat e Një Utopie: Përse Dështoi Anti-korrupsioni Shqiptar  
**BLENDI KAJSIU**
- 58 - 68 Korrupsioni dhe Paqartësitë e Tij  
**FABIAN ZHILLA**
- 69 - 79 Gjinia dhe Korrupsioni: A Janë Gratë më Pak të Korruptuara se Burrat?  
**SONILA DANAJ**

## Teori Politike

- 80 - 100 Arsyeja Qeverisëse dhe Arti i Qeverisjes tek Michel Foucault  
**PROF. MUHAMEDIN KULLASHI**

## Recenca

- 101 - 106 Fukujama: Ndërtimi i Shtetit, Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e XXI  
**ENRI HIDE**

## PIKËPYETJE ANTROPOLOGJIKE MBI KORRUPSIONIN

Smoki MUSARAJ\*

**Abstrakt.** Ky artikull përqendrohet në dy kontekste të caktuara ku spikat diskutimi mbi korrupsionin në Shqipëri. Së pari, diskutohet tendenca mbizotëruese në fushatën anti-korrupsion që konsideron zhdukjen e informalitetit si ilaç kundër korrupsionit. Së dyti, shqyrtohen gjykimet e etikës së shkëmbimit të parasë apo dhuratave si "të korruptuara," "të korruptuara apo të justifikuara" apo si "të ndershme". Ky artikull ngre disa pikëpyetje antropologjike mbi parametrat e matjes dhe të luftës kundër korrupsionit nëpërmjet perceptimeve lokale të këtyre fenomeneve. Formulave zyrtare mbi strategjitë për të zhdukur korrupsionin si dhe mbi indeksimin e vlerësimeve të transaksioneve, që fushata ndërkombëtare konsideron si të korruptuara, i kundërvihen gjykime më të mjegullta dhe të shumëllojshme nga jeta e përditshme e njerëzve që përfshihen në këto shkëmbime. Ky ballafaqim synon të shtjellojë perceptimet më komplekse lokale mbi aktivitetet ekonomike dhe gjykimet e legjitimitetit të tyre në kontekstin e transformimeve sociale të tranzicionit. Në rradhë të parë, sugjerohet se raporti midis korrupsionit dhe informalitetit nuk duhet trajtuar si një ekuivalencë, por si një tension midis dy konceptesh shumë të ndryshme — korrupsioni si një vlerësim moral dhe informaliteti si një matës i përfshirjes së shtetit në ekonomi. Në vijim, sugjerohet që konkretisht informaliteti nuk është domosdoshmërisht e kundërta e shtetit, por që shpesh njëra mundëson apo edhe mishëron tjetrën. Si rrjedhim, kufiri formal/informal jo gjithmonë përputhet me atë të korruptuar/pakorruptuar.

### Hyrje: Korrupsioni dhe informaliteti: luftë armiqësore apo simbiozë?

**N**ë literaturën e shkencave shoqërore, në veçanti të atyre politike, korrupsioni përkufizohet si abuzim i të mirave publike për qëllime/interesa private apo personale.<sup>1</sup> E megjithatë ky përkufizim aq sa i thjeshtë në dukje në kontekste të ndryshme paraqet një sërë nuancash ekonomike, politike, juridike dhe etike, të cilat shpeshherë janë të paqarta. Diskutimet mbi korrupsionin si prioritet i politikës në fakt kanë hyrë në debatin publik dhe në politikat zyrtare shqiptare nëpërmjet influencës së një fushate ndërkombëtare kundër korrupsionit e udhëhequr nga Banka Botërore dhe e aplikuar nga një sërë organizatash jo-qeveritare me në krye *Transparency International*. Kjo fushatë iu bashkangjiti projekteve të zhvillimit të botës së tretë në fillimin e viteve 1990-të, por në Shqipëri ajo mori vull mbas

\* Smoki Musaraj është doktorante për antropologji kulturore në New School University (USA). Ajo zotëron një B.A. në Studime Kulturore dhe Politike nga Trent University (Kanada), një M.A. në Shkenca Politike dhe M.A. në Antropologji nga New School University. Ky artikull është bazuar në punën e saj në terren që po vazhdon aktualisht në Tiranë me mbështetjen e National Science Foundation dhe Social Science Research Council.

1997-ës. Si argument kryesor i fushatës për matjen dhe luftimin kundër korrupsionit është raporti i tij i drejtpërdrejtë me mos-zhvillimin ekonomik.

Një nga zgjidhjet që kjo fushatë i jep korrupsionit është lufta kundër informalitetit. Në influencën e kësaj fushate ndërkombëtare, edhe në diskutimet e sferës sonë publike fjalët “korrupsion” dhe “informalitet” përdoren si sinonime të njëra tjetrës. Presupozohet që zhdukja e informalitetit të jetë një hap konkret i zhdukjes së korrupsionit. Po a përputhen gjithmonë këto të dyja në praktikë? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje, na duhet të japim një përkufizim të shkurtër të informalitetit. Me informalitet përshkruhen aktivitete biznesi ose transaksione të tjera, të cilat zhvillohen jashtë strukturave ekzistuese shtetërore.<sup>2</sup> Kohët e fundit në sferën tonë publike fjala “informalitet” është përdorur më konkretisht në kontekstin e legalizimit të “zonave informale” të banesave të palegalizuara. Në të vërtetë informaliteti përfshin një gamë shumë të gjerë transaksionesh që kryhen jashtë strukturave ligjore, tatimore, pra jashtë vështimit të atij kompleksi strukturash, ligjesh dhe praktikash që ne për shkurt e quajmë “shtet.” Ndër të tjera, këtu përfshihen dhënia/marrja e ryshfeteve, përdorimi i favoreve ose ndereve, pagesat famëkeqe të dhjetë-përqindshit në tendera, evazioni fiskal, mosregjistrimi i bizneseve apo i të punësuarve, mospagimi i dritave, e shumë e shumë të tjera. E vetmja gjë e përbashkët e këtyre transaksioneve është marrëdhënia e tyre me shtetin: të gjitha llojet e informalitetit kanë të bëjnë me mënjanimin e shtetit. Duhet theksuar se në komunikimin tonë të përditshëm jo çdo veprim i përmendur më sipër konsiderohet si moralisht i dënueshëm, pra si korrupsion.

Gjithsesi, sot vihet re një fushatë e gjerë shtetërore dhe civile kundër informalitetit që konsiderohet si një kurë e korrupsionit. Si zgjidhje praktike në nismat zyrtare kundër informalitetit në Shqipëri mbizotëron logjika e formalizimit dhe legalizimit. Në mënyrë më të spikatur, punimi i Besnik Aliaj në *Misteri i Gjashtë* ka influencuar logjikën e legalizimeve dhe formalizimit të propozuar nga shteti shqiptar. Në këtë studim disa vjeçar, Aliaj adopton një logjikë ekuivalencash, ku informaliteti = korrupsion = moszhvillim ekonomik. Ky ekuacion përdoret gjithashtu si armë kërcënuese ndaj Shqipërisë nga institucionet ndërkombëtare të zhvillimit nga 1998-ta e sipër. Konkretisht, për çështjen e zonave të banesave informale, Aliaj propozon legalizimin e ndërtimeve pa leje në Shqipëri si një mënyrë rigjallërimi të ekonomive të këtyre zonave. Propozimi i tij thekson mbi të tjerat qartësimin e ligjit të privatizimit, por sidomos regjistrimin dhe mbledhjen e informacionit si armë kundër informalitetit.<sup>3</sup> Po të shohim edhe nisma të tjera anti-korrupsion në vend, ka një tendencë drejt regjistrimeve, deklarimit të pasurive, paraqitjen e dokumentacioneve (në tendera për shembull), të përmbledhura nën ombrellën e një termi tjetër tashmë të shpërdoruar në debatet publike: “transparencës”, një tjetër antidot i korrupsionit.

Si referencë intelektuale dhe praktike e kësaj rryme është një prej emrave më të njohur në rrethet ndërkombëtare të organizmave të zhvillimit, Hernando de Sotos dhe librit të tij *Rruga Tjetër: Revolucioni i Padukshëm në Botën e Tretë*<sup>4</sup>. Në këtë studim, kapitali që qarkullonte në aktivitetet informale, konsiderohej si “kapital i vdekur” dhe një fenomen që pengonte zhvillimin ekonomik. Megjithatë, paraja që qarkullon në mënyra informale nuk konsiderohet gjithmonë si i tillë. Kështu, një nga studiuesit e parë të informalitetit dhe nga frymëzuesit e de Sotos, Keith Hart,<sup>5</sup> vuri re se në zonat e varfëra të kryeqytetit Ghanez, Akra, ekzistonin një sërë aktivitetesh fitimprurëse informale që, sipas tij, e mbanin gjallë këtë

komunitet të përjashtuar nga instancat shtetërore. Qëndrimi pozitiv i Hart-it ndaj informalitetit vlen për t'u përmendur këtu për të theksuar dallimin e tij nga koncepti i korrupsionit. Hart-i arriti të vëzhgojë një realitet të neglizhuar më parë, por nuk e trajton këtë realitet nëpërmjet prizmit etik. Kalimi nga informaliteti në korrupsion nuk është pra i domosdoshëm. Në të vërtetë, për të gjykuar një aktivitet informal si të korruptuar apo jo nevojitet të vlerësohet jo vetëm të qenurit *legal*, por sidomos të qenurit *legjitim* kundrejt të mirës publike. Një vështrim i praktikave informale në kontekste të ndryshme tregon se raporti midis këtyre të dyjave është i lëkundshëm dhe në varësi të formës së shtetit dhe qeverisjes dhe asaj që konsiderohet si e mirë publike.

*Informaliteti: virus apo antidot i shtetit?*

Edhe pse studimi i Aliaj-t mbi gjendjen e informalitetit në Shqipëri sjell një vështrim shumë kompleks dhe informativ, është shqetësues fakti që fjala "informale" shpesh trajtohet si ekuivalente e "kriminale". A konsiderohet gjithmonë informaliteti si kancer i shtetit? Në fakt, aktivitetet informale shpesh janë konsideruar si alternativa shpëtuese ndaj një shteti autoritar. Kjo ishte në të vërtetë qasja e Hart-it ndaj informalitetit. Në rastin e banorëve të Akrës, të cilët merrfeshim me shumë aktivitete part-time për të nxjerrë bukën e gojës, Hart-i sugjeron se nëse këta banorë do të detyroheshin të ndiqnin rrugë ligjore punësimi ata do të dilnin jashtë kriterëve ose nuk do të arrinin të nxirrnin aq fitim sa të mund të mbijetonin. Një qëndrim i ngjashëm është mbajtur edhe ndaj informalitetit (quajtur ndryshe edhe si "tregu i zi", "ekonomia dytësore" apo "paralele") gjatë periudhës komuniste në vendet e Evropës Lindore. Shumë studiues të informalitetit në kontekstin e shteteve të centralizuara kanë argumentuar se ekonomia informale ka qenë një lloj sfide dhe rezistence ndaj shtetit autoritar.<sup>6</sup> Alena Ledeneva shkruan mbi sistemin e favoreve dhe njohjeve në ish-Bashkimin Sovietik si:

ana e kundërt e një qendre shumë të centralizuar, një reagim i njerëzve të thjeshtë ndaj kufizimeve strukturore të sistemit socialist të rishpërndarjes — një sërë praktikash që e lejuan sistemin sovietik të funksionojë dhe që e bënë atë të tolerueshëm, por që edhe e përmbysën atë. [1998:3]

Një shpjegim i ngjashëm gjen aplikim edhe në kontekstin e tregut të zi shqiptar gjatë periudhës komuniste. Po ashtu, përdorimi i praktikave informale sidomos i "mikut", i "ndereve" apo "dhuratave" në shkëmbim të një favorit shtetëror ka qenë në Shqipëri një praktikë shumë e përhapur që, në retrospektivë mund të konsiderohet gjithashtu si një sistem rishpërndarës i të mirave materiale si dhe e statusit social ku personat, të cilët nuk kishin akses në shërbime të ndryshme, përdornin armë të tjera sociale apo nganjëhere materiale për të përfituar atë shërbim të mohuar.

Rishikimi i studimeve antropologjike apo sociale të ekonomisë paralele në ish-vendet e bllokut lindor ndihmojnë të reflektojmë mbi vazhdimësitë apo dallimet e ekonomisë informale sot nga ajo para 1990-ës. Duke i lënë mënjanë krahasimet sasiore, nga ana kualitative, cili është ndryshimi i marrëdhënies shtet-ekonomi sot dhe pse kanë mbijetuar, madje janë shumëfishuar rrugët informale? Nëse sipas logjikës së Ledenevës e shumë studiues të tjerë ekonomia informale në Evropën Lindore lindi si një reagim ndaj ekonomisë së skarcitetit dhe

politikës së centralizuar, ai sot pozicionohet kundër një shteti që synon të funksionojë në ekonominë e tregut të lirë dhe një qeverisje demokratike.

Por gjykimi pozitiv ndaj informalitetit ka të bëjë edhe me mënyrat e përkufizimit të "të mirës publike," përkufizime që shpesh marrin nuanca të ndryshme në varësi të politikave të kohës. Vlerësimi i ekonomisë informale të periudhës së socializmit si legjitime bazohej në një koncept të së mirës publike që e konsideronte shtetin si një dhunues të kësaj të mire. Pra, informalja konsiderohej jo si një abuzim i të mirave publike, por si një barkë shpëtimi. Sot retorika dhe politikat zyrtare presupozojnë se në një ekonomi tregu dhe një shtet demokratik, e mira publike njehsohet me shtetin. Gjithsesi, mbizotërimi i informalitetit në ekonominë e sotme duhet të na bëjë të pyesim nëse bëhet ky njehsim 'shtet' = 'e mirë publike' nga njerëzit e thjeshtë. Fakti që sipas një raporti më të fundit shtetëror, 93% e biznesit vendas është ekstraligjor, ose informal,<sup>7</sup> duhet të na bëjë të hezitohet para se ta quajmë të gjithë këtë aktivitet si të korruptuar. Në vend që të përvetësohet pa u pyetur ky ekuacion, duhet pra të bëhet një indeksim, një shkaktisje më e hollësishme dhe e vëmendshme e llojeve të praktikave informale në shoqërinë tonë në mënyrë që dallohen ato praktika ekstraligjore që mund të jenë më të dëmshme për publikun dhe ato që ekzistojnë thjesht si antidoti i praktikave të padrejta të një shteti.

### *Shteti si mishërim i informalitetit*

Vazhdimësia e anashkalimit të shtetit edhe gjatë tranzicionit na shtyn të konsiderojmë më thellë arsyet dhe kushtet socio-kulturore që shpjegojnë mbijetesën dhe besimin e mbarë popullsisë në metodat informale të biznesit. Por nëse informaliteti gjatë periudhës komuniste mund të shpjegohej si një sferë që funksiononte sipas rregullave komplet të ndryshme nga ato shtetëroret, sot ky dallim është më i mjegullt. Sot edhe biznesi informal edhe ai zyrtar ndjek ligjet e tregut të lirë. Arsyet që parashtrohen sot për ekstralegalitetin kaq të përhapur janë ndër të tjera tranzicioni, mangësitë e ekonomisë së tregut, mungesa e ligjit të pronësisë, mbingarkesa ligjore për të ushtruar aktivitetet biznesi dhe mungesa e mundësive për kredi.<sup>8</sup> Megjithatë këto shpjegime zyrtare anashkalojnë një element akoma më të rëndësishëm: mungesën e besimit tek institucionet. Në një nga sondazhet e fundit mbi perceptimet dhe përvojën e korrupsionit në Shqipëri, publiku i gjerë tregoi se kishte 40% besim tek qeveria shqiptare, një shifër ende shumë e ulët. Përhapja dhe qëndrueshmëria e informalitetit si alternativë primare në aktivitetet e biznesit ka të bëjë me mosbesueshmërinë ndaj konceptit të shtetit (dhe jo vetëm qeverisë X apo Y). Ky "fakt social," siç do ta quante Emile Durkheim,<sup>9</sup> sugjeron se në fakt imazhi i pabesueshëm i shtetit në Shqipëri mundet që të jetë një katalizator i informalitetit. Ky fakt social na shtyn që të shikojmë më nga afër praktikën shtetërore dhe t'i veçojmë ato nga parimet që shpallen në media apo në raportet që u dorëzohen institucioneve ndërkombëtare.

Nëse flasim për korrupsionin si një "abuzim i të mirave publike për qëllime personale" duhet të marrim parasysh se ky abuzim nuk ndodh domosdoshmërisht jashtë kornizave të formales. Kështu, shumë mënyra të abuzimit me fondet apo të mirat publike vjen në forma të legalizuara, në forma preferencash/favoresh, të cilat i shpëtojnë "vështrimit" të ligjit. Në këtë rast, dukshmëria, pra transparenca, nuk është e thënë që të zgjidhi problemin e abuzimit. Në diskutimet e përditshme në sferën publike shqiptare flitet sa vjen e më shumë për të

ashtuquajturën "kapjen e shtetit". Ky koncept është diskutuar gjerë e gjatë jo vetëm në vendet e tjera të Evropës Lindore, por gjithashtu në vende të tjera me index të dobët të korrupsionit në kontinentin afrikan. Me kapjen e shtetit nënkuptohet një lloj monopolizimi i instancave të shtetit nga një grup i kufizuar pushtetarësh. Kapja këtu i referohet një procesi akoma më të padukshëm nga mjetet ligjore të praktikave përvetësuese të të mirave publike.

Studiues të formave të shtetit në disa vende afrikane të shquara për nivele të larta korrupsioni përdorin një term akoma më konkret për atë që ne sot e quajmë kapjen e shteti. Këta studiues flasin për "privatizim" e pushtetit, i cili nuk ka të bëjë vetëm me aktin e privatizimit të pronave shtetërore nga individë të caktuar, por edhe me një simbolikë të veçantë të ligjërimit dhe kulturës politike.<sup>10</sup> Më konkretisht, këtu flitet për mishërimin e personit privat të pushtetarit në postin e tij. Një fenomen i ngjashëm vihet re edhe në vendin tonë sidomos në kulturën politike të një numri sa vjen e më shqetësues i politikanëve tanë të cilët nuk bëjnë një ndarje midis ligjërimit formal me atë informal, midis çështjeve me karakter publik dhe atyre personale. Përkundrazi, është bërë praktikë mëse e zakonshme që në një fjalim në parlament apo në një konferencë shtypi në Shqipëri të bëhet kalimi nga e folura formale rreth një çështjeje të caktuar politike, në të folurën informale mbi karakteristikat personale të folësit.

Ky fenomen nuk kufizohet vetëm në rrethinat e parlamentit apo medias, por reflektohet edhe në mënyrën sesi individët e thjeshtë hyjnë në marrëdhënie me figurat politike. Kështu, kur flitet për një politikan apo figurë shtetërore si "i çmendur" apo "skizofren" nuk bëhet gjë tjetër veçse krijohet njëfarë intimiteti me figurat publike duke i nxjerrë ata nga diskutimi politik (siç mund të jetë analizimi i programit të tyre) dhe duke e sjellë atë në sferën e komenteve private që i përdorim normalisht për njerëz të afërm apo të njohur. Ky reflektim i dyanshëm i intimitetit të figurave politike paraqet një rrezik tjetër akoma më të frikshëm: neutralizimin e politikës. Por ky informalizim në fakt imponohet sistematikisht nga vetë praktikat formale të ligjërimit publik.

Mjafton të përmendim disa nga nofkat e fundit të përdorura në sferën publike të gjashtë muajve të fundit. Duke iu referuar deklaratës së kryeministrit se do të merrte përsipër shpenzimet e funeralit të viktimave të tragjedisë së Farkës, *Fiksi* satirizon qeverinë si "qeveri qokash",<sup>11</sup> duke i krahasuar funksionet e saj me traditat informale të bërjes së adeteve të ndryshme personale ndaj të vdekurit. Ndërsa një nga titujt e fundit të opinionistëve deklaron shtetin tonë si "shteti ynë informal".<sup>12</sup> Natyrisht që këto janë figura letrare të përdorura për sensacion. Por edhe simbolikës së kohës duhet t'i kushtojmë pak vëmendje. Ekziston një kulturë politike informale që ndihet si në fjalimet e politikanëve të rradhës ashtu edhe mënyra sesi analistët e ditës i referohen këtyre. Këtu me "informal" nënkuptohet jo më të qënurit jashtë kornizave formale, por thithjen e informales në atë që konsiderohet si hapësirë formale publike. Rasti më pikant padyshim është spektakli i fundit parlamentar ku në vend të diskutoheshin seriozisht planet buxhetore të qeverisë, diskutimi u shndërrua në një betejë maçiste sulmesh personale. Efekti i kësaj forme debati ama nuk mbetet vetëm në nivelin e formës, e "look"-ut. Përkundrazi, pasoja më alarmante e këtij evenimenti ishte se për javë me rradhë mbas tij u harrua fare buxheti ndërkohë që nuk mbeti intelektual, profesor, doktor a politikan pa e dhënë opinionin e vet mbi banalitetin e këtij konfrontimi. Është ndoshta ky imazh informal dhe banal që, për ironi, ka gjasa të ketë ndikuar në besueshmërinë e ulët ndaj figurës së shtetit dhe figurave politike në përgjithësi.



Me fjalë të tjera, një vështrim më nga afër i praktikave informale dhe atyre formale në ekonominë dhe politikën e sotme në Shqipëri na detyrojnë të jemi më të kujdesshëm ndaj ndarjes absolute midis formales dhe informales, gjë që ngre një pikëpyetje mbi ekuivalencën korrupsion – informalitet. Përkundrazi, vëmë re se veprimtaritë informale sot janë jo gjithmonë në kundërshtim me logjikën dhe parimet formale, ndërkohë që hapësirat formale të qeverisë, parlamentit etj, e kanë bërë informalen pjesë të imazhit të tyre publik. Por, konstatimi se informalja dhe formalja në Shqipëri nuk janë aq të ndara, por herë herë shfaqin shenja simbioze nuk mjafton për të shpjeguar mospërputhjen midis informalitetit dhe korrupsionit. Këto të dyja në rradhë të parë janë të ndryshme në koncept: informalja përcakton diçka jashtë ligjeve formale, ndërsa korrupsioni është mbi të gjitha një gjykim etik. Në vijim i kthehem atëhere terrenit të etikës së shkëmbimeve për të parë sesi trajtimi i korrupsionit në ligjëratat zyrtare (qofshin këto kombëtare ose ndërkombëtare apo jo-qeveritare) dallon nga gjykimet e përditshme të njerëzve të përfshirë në këto transaksione.

#### *Vlerësimet e përditshme të korrupsionit: multiplicitet etikash*

Përveç luftës kundër informalitetit, dora e komunitetit ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm sot në formatin dhe logjikën e matjes së perceptimeve të korrupsionit në Shqipëri. Po a përputhen këto mënyra vlerësimi me etikën e njerëzve që përfshihen në këto transaksione në jetës e tyre të përditshme? Akuzimet e korrupsionit kanë të bëjnë shpesh edhe me një gjykim etik të shkëmbimeve. Një artikull i fundit spikat këtë mospërputhje gjykimesh mbi informalitetin në ligjëratat zyrtare me ato të përditshme:

Dëgjojmë shpesh të thuhet: "Sa i mirë është ai bir k... Më ndihmoi që ta regjistroja djalin në shkollë, se ai ishte jashtë liste." Apo: "Ajo është shumë e mirë, sepse më ndihmoi që ta shmanjia pagesat e taksave vitin që shkoi. Unë do i flas për ty dhe ajo do të më ndihmojë. Është rrufjane ajo që..." Ose: "Sa i mirë është ai profesori. Nuk më pyeti fare në provim. E takova më pas shejtanin." Dhe: "Shefi, edhe pse më kapi duke pirë raki në orarin e punës, nuk më tha gjë fare, edhe pse kam nja një javë që vij me vonesë. Ku do me ia dit ai për ministrin. E ka në kllapa qerratai." Apo: Ai gjykatësi do e mbyllë çështjen në favorin tonë. Sa i mirë që është. Mjeshtër."<sup>13</sup>

Pa dyshim që këto komente nuk duhen përgjithësuar, megjithatë ato na përballin me një realitet të kohës ku fjalët me kuptimin e parë negativ si "rrufjane", "shejtan", "qerratai" në fakt përdoren në biseda të përditshme në formën e lavdërimit, madje edhe të zilisë. Po ashtu, këto komente na vënë përpara një sistemi dytësor gjykimesh mbi transaksionet që anashkalojnë qëllimisht shtetin, ligjin, rregullin. Ky realitet kërkon një vështrim antropologjik të etikës (apo etikave) së shkëmbimit: Kur dhe pse konsiderohet një transaksion — qoftë ky formal apo informal — i korruptuar ose jo nga njerëzit që janë të përfshirë në këto transaksione? Në vijim sugjeroj se në kontekstin e një tranzicioni të stërgjatur nuk ka mungesë morali apo etike, por një multiplicitet etikash — shpeshherë kontradiktore — të kryerjes së një veprimi të paligjshëm. Kjo shumëllojshmëri karakterizohet nga gjykime të lëkundshme të këtyre veprimeve si "nder" apo "shkelje."

Sondazhi i fundit i organizatës IDRA, "Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe

Përvojë",<sup>14</sup> konstaton se 92% e publikut të gjerë mendon se korrupsioni në Shqipëri është "shumë i përhapur" dhe "deri diku i përhapur" dhe një përqindje e mirë pohojnë se kanë dhënë rryshfet për të marrë shërbime publike sidomos në institucionet shëndetësore dhe në gjykata. Megjithatë, kjo shifër fsheh një realitet shumë kompleks shkëmbimesh të njerëzve të thjeshtë me nënpunësit publik, një kompleksitet që pohohet edhe nga vetë autorët e këtij sondazhi. Një nga vështirësitë më të mëdha të formulimit të pyetësorit ka qenë bërja e dallimit që ekziston në kulturën tonë midis bakshishit, peshqeshit dhe rryshfetit. Bakshishi dhe peshqeshi presupozojnë një dhuratë që konsiderohet nga vetë dhënësi si e moralshme ndërsa rryshfeti përmban një nënkuptim negativ dhe detyruet. Por si mund të bëhet dallimi midis njëres dhe tjetrës? Kur konsiderohet një shumë parash e dhënë një doktori apo mësuesi si rryshfet, si bakshish, apo si peshqesh?

Për të theksuar nuancat gri të gjykimeve të korrupsionit pyetsori i përdorur në këtë sondazh përmban një seksion të veçantë ku zberthehen disa situata tipike transaksionesh të paligjshme. Midis të tjerash, të intervistuarit pyeten nëse e quajnë të "korruptuar", "të korruptuar, por të justifikuar" apo "të ndershëm" një nënpunës publik që pranon një pagesë të tepërt për një certifikatë, nënën që e jep këtë pagesë, një student që i jep një këmishë një mësuesi për një notë më të mirë dhe mësuesin që e pranon atë, një ndërrmarrje që paguan rryshfet për të marrë një tender dhe ministri që e pranon atë. Qëllimi këtu është të përcaktohen nuancat e gjykimit të aktit apo personit si të korruptuar apo të ndershëm. Gjithashtu, këtu bëhet dallimi midis aktit të korruptuar sipas ligjit, por edhe sipas kodeve morale të pashkruara. Përfundimet e këtij sondazhi në këto pyetje vë në pah disa paradokse interesante.

Shumica e njerëzve mendojnë se nënpunësi që *pranon* një "bakshish" të nënës për një certifikatë, mësuesi që *pranon* këmishën e dhënë si "dhuratë", dhe ministri që *pranon* rryshfet konsiderohen si "të korruptuar dhe duhen ndëshkuar" (respektivisht 84.8%, 70.8 % dhe 93.1 %). Kurse nëna dhe nxënësi që japin diçka konsiderohen në shumicën e rasteve si "të korruptuar, por të justifikuar" (56.1 % dhe 41.9 %). Kjo tregon në rradhë të parë që marrësi i një pagese apo dhurate kundrejt një shërbimi publik gjykohet si më e pandershme sesa dhënia. Ky gjykim dallon nga ai i ligjit, i cili i ndëshkon të dyja palët për korrupsion, edhe pse dhënësin më pak se marrësin. Ky dallim përputhet edhe me studime të tjera të antropologjisë së favoreve ku dhënësi dhe marrësi vlerësohen ndryshe pasi i pari mendohet të jetë i detyruar të japë. Bën dallim në këtë gjykim vlerësimi i biznesit që jep rryshfet në tender. Shumica e të intervistuarve (80.6 %) mendojnë që ky veprim është "i korruptuar dhe duhet ndëshkuar".

Pra, mund të themi se koncepti bashkëkohor i korrupsionit, parë nga i ashtuquajtimi "publiku i gjerë", paraqet një etikë shumë komplekse. Në rradhë të parë, nuk është thjesht lloji i transaksionit që vendos mbi natyrën e korruptuar apo jo të veprimit. Roli i personit në këtë transaksion (dhënia/marrja në rastin e nënës dhe nxënësit) si dhe pozita sociale e palëve të përfshira (në rastin e biznesmenit) përbëjnë një aspekt të rëndësishëm në këto gjykime. Mund të themi më tej se kemi të bëjmë me një etikë në fluks që varet nga koordinatat sociale si dhe nga pozicionimi i individit në një situatë transaksioni.

Por këtu vërejmë gjithashtu një fenomen tjetër më të veçantë. Ndryshe nga dallimet që bën teoria antropologjike e shkëmbimit, të intervistuarit në fjalë nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh në mënyrën sesi e konsiderojnë domethënien sociale të peshqeshit, bakshishit dhe rryshfetit. Peshqeshi (këmisha), i cili, tradicionalisht, ndryshe nga shkëmbimi me para,

përmban një element më social dhe personal, trajtohet njësoj si rryshfeti (dhjetë përqindshi i biznesmenit) apo bakshishi (pesëmishja e nënës). Në antropologjinë e shkëmbimit dhe reciprocitetit, institucioni i shkëmbimit të dhuratave konsiderohet si konceptualisht në kundërshtim me etikën e shkëmbimit me para. Dhurata, sipas Marcel Mauss-it, forcon dhe bën të dukshme marrëdhëniet sociale midis palëve dhe transporton një pjesë të shpirtit të personit dhënës në duart e marrësit.<sup>15</sup> Vlera e këtij shkëmbimi është pikërisht lloji i marrëdhënies sociale që formëzohet. Në të kundërt, paraja mundëson shkëmbime ndërmjet palëve që nuk kanë asnjë lidhje apo njohje sociale me njëri-tjetrin dhe që për këtë arsye e largojnë akoma më tej realitetin social nga akti i shkëmbimit. Me fjalë të tjera, dhurata konsiderohet si një shkëmbim më njerëzor dhe personal kurse paraja (në rastin tonë rryshfeti) si një shkëmbim materialist dhe çnjerëzor.

Mungesa në përgjigjet e sondazhit të dallimit midis dhuratës dhe rryshfetit është shumë intrigues. Pse anashkalohet komplet ky detaj? Çfarë mund të thuhet për domethënien e dhuratës dhe parasë në shkëmbimet e sotme me personat publikë? Këtu mund të kemi të bëjmë me komodifikimin e dhuratës dhe të shkëmbimeve në përgjithësi. Pra, në vend të një dhurate të dhënë nga dashamirësia apo me përmbajtje personale kemi një rritje të përdorimit të dhuratës "për interes". Individët e përfshirë në këto raste — qoftë dhurate, qoftë rryshfeti — kanë të përbashkët faktin se ata nuk bëjnë pjesë e një shkëmbimi reciprok, por janë pjesëtarë të një hierarkie të caktuar.

Por ndodh shpesh edhe fenomeni i kundërt: paraja vetë ka hyrë sa vjen e më shumë në repertorin e dhuratave. Siç thotë edhe një banor në Tiranë në një bisedë nga puna ime në terren, "paraja është dhurata më e çmuar". Ky reifikim i parasë vërehet edhe në sfera të tjera transaksionesh ku tradicionalisht shkëmbeheshin vetëm dhurata jo-monetare dhe ku paraja konsiderohej si një fyerje. Kam parasysh sidomos rastet e dhënies së kafes apo cigareve në raste vdekjesh apo të dhuratave simbolike në raste dasmash. Me fjalë të tjera, në këto situata dhurata nuk ishte e konvertueshme në pará. Sot, mund të themi se kjo traditë ka ndryshuar jashtë mase duke e vendosur paranë në qendër të sendeve që jepen (ose, në rastin e dasmave, që "hidhen") në këto evenimente të rëndësishme shoqërore. Leku sot konsiderohet me të vërtetë si një dhuratë e çmuar dhe jo më si një fyerje.

Një rast që dëshmon për këtë vlerë të parasë është ai kirurgut të K.D., i cili akuzohet për mitmarrje. Është me interes mënyra e justifikimit të doktorit për kapjen 'me pará në dorë':

"Në deklaratimet e para, sipas policisë, mjeku D. ka pranuar se 50 mijë lekët ia kishte ofruar I. H., për operacionin e të bijës. D. ka mohuar t'ia ketë kërkuar këtë shumë para operacionit, por se H. ia kishte dhënë në formë dhurate pasi kishte mbetur i kënaqur me punën e kryer."<sup>16</sup>

Pavarësisht nëse u besojmë apo jo qëllimeve të doktorit apo vërtetësisë së fjalëve të tij, këtu kemi të bëjmë me një situatë shumë të zakonshme në marrëdhëniet tona me institucionet e shëndetësisë. Po nga bisedat e mia me banorë të thjeshtë në Tiranë mbi gjykimet e tyre për korrupsionin në Shqipëri, kam hasur disa herë gjykime të ngjashme ku paraja e dhënë doktorit konsiderohet si një dhuratë, si "shpërblim për jetën."

Megjithatë, në disa përgjigje të tjera të të njëjtit pyetsor spikat një tendencë

mosbesuese dhe gjykyese ndaj parasë. Një nga pyetjet më interesante hedh një dritë komplet tjetër mbi kuptimin e "korrupsionit" për publikun shqiptar. Pyetësi i pyet të intervistuarit sesi e vlerësojnë ata një pronar lulesh që rrit çmimet gjatë festave. Këtu sipas përkufizimeve zyrtare nuk kemi të bëjmë me korrupsion, por thjesht me ligjin e kërkesës/prodhimit. Çuditërisht, shumica e të intervistuarve e konsiderojnë shitësin ose si "të korruptuar dhe duhet ndëshkuar" (52.2 %) ose si "të korruptuar, por të justifikuar" (27.6 %). IDRA e interpreton këtë përgjigje si një konfuzion. Unë do të doja të propozoja një shpjegim tjetër.

Rritja e çmimeve në këtë rast konsiderohet si korrupsion pasi ai përbën një ndryshim të paparashikuar të vlerës së luleve. Këtë mund ta vëmë re edhe në periudhën e rritjes së çmimit të bukës në fillim të këtij viti. Nga pikëpamja ekonomike kjo mund të konsiderohet si e pranueshme brenda rregullave të tregut. Megjithatë ne na intereson më shumë në këtë rast gjykimi i njerëzve pavarësisht rregullave të tregut. Konkretisht ky ndryshim i menjëhershëm jo vetëm vlerësohet si abuzim, por edhe *përrjetohet* si i tillë. Me fjalë të tjera, egërsia apo paqëndrueshmëria e vlerës në parë e sendeve si dhe akumulimi i menjëhershëm konceptohet, si një lloj abuzimi i disa të drejtave apo të mirave publike.

Me pak fjalë, përgjigjet e këtij sondazhi ashtu si edhe bisedat e përditshme në lidhje me shkëmbimin e peshqesheve, bakshisheve apo ryshfeteve na ofrojnë një terren shumë kompleks të etikës së transaksioneve me autoritetet publike dhe me tregun. Gjykimet jo-zyrtare të këtyre transaksioneve flasin për një ndryshim jo vetëm në konceptimin e korrupsionit *per se*, por edhe për një kuptim kompleks të domethënies së parasë dhe dhuratës në shoqërinë shqiptare. Kjo analizë paraprake e gjykimeve të publikut shqiptar tregon nga njëra anë një transformim të formës së dhuratës që përfshin edhe elemente monetare. Nga ana tjetër, vërejmë dy tendenca kontradiktore në marrëdhënien tonë me paranë. Ndërkohë që paraja sa vjen e zëvendëson funksionet sociale të dhuratës në rritjet kulturore, në kontekstin e tregut — pra, pikërisht aty ku paraja pritet të mbizotërojë me logjikën e dorës së fshehtë — ndeshim një kundërvënje etike ndaj akumulimit të saj të tepruar apo të paparashikuar.

### **Konkluzion: kundrejt një vështrimit lokal të korrupsionit**

Në këtë artikull tentova një ballafaqim të koncepteve zyrtare (qoftë ndërkombëtare qoftë ato të qeverisë shqiptare) me ato praktikat e jetës së përditshme mbi a) ekuivalencën informalitet = korrupsion dhe b) vlerësimin e etikës së transaksioneve si bakshishi, ryshfeti, peshqeshi. Ky ballafaqim nuk synon të hedh poshtë komplet konceptin e korrupsionit apo të thotë se nuk ka korrupsion në Shqipëri, apo që ky është thjesht një ligjërim i imponuar nga jashtë. Artikulli pozicionohet historikisht, duke marrë parasysh momentin kur korrupsioni si një prioritet politik hyri në të folurën zyrtare nëpërmjet një fushate ndërkombëtare. Në linja të përgjithshme, këtu argumentova se elementet që lidhen në këtë ligjëratë me korrupsionin (si informaliteti, ryshfeti, bakshish etj) nuk janë as diçka e re, por as edhe plotësisht të përputhshme me të.

Një shqyrtim i politikave praktike shtetërore të sotme që e njehsojnë informalitetin me korrupsionin sugjeron se, përkundër ligjëratës zyrtare, informalja sot nuk është e prerë me thikë nga formalja, dhe se shpeshherë njëra katalizon ose mishëron tjetrën. Më tej, duke u nisur nga "fakti social" i përhapjes së informalitetit, lind pyetja e besueshmërisë dhe përfundimi se në praktikë, imazhi banal dhe informal i shteti sot luan një rol të rëndësishëm në lulëzimin e informalitetit ekonomik. Rrjedhimisht, nëse informaliteti sot përbën një problem shqetësues

për vetë faktin se inkurajon mungesën e respektit apo seriozitetit ndaj ligjit, trajtimi i tij duhet të fillojë aty ku prezupozohet të jetë fusha kundërshtarë: politika zyrtare dhe kontrata e saj e domosdoshme e besueshmërisë me subjektet e saj.

Mospërputhshmëria e vlerësimeve zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare të korrupsionit ekziston gjithashtu edhe në vetë gjykimin e një sërë transaksionesh si "të korruptuara" ose "të ndershme". Për t'i kuptuar më thellë perceptimet lokale të etikës së këtyre transaksioneve nga njerëzit që marrin pjesë në këto, u diskutuan disa nga përfundimet e një nga sondazheve të fundit mbi korrupsionin në Shqipëri. Vihet re një multiplicitet etikash që karakterizojnë gjykimin etik në përgjithësi në kontekstin e tranzicionit. Ky multiplicitet sinjalizon një ndryshim më të përgjithshëm të perceptimit të parasë dhe ekonomisë së tregut në përgjithësi. Ndër të tjera, konstatojmë një ndryshim rrenjësor të konvertueshmërisë së dhuratës në pará dhe anasjelltas. Ky ndryshim gjithashtu reflektohet në mënyrën e gjyimit lokal të ryshfeteve, bakshisheve dhe peshqesheve ku lloji i shkëmbimit nuk është aq i rëndësishëm. Ajo që ndikon më tepër në gjykimin se një transaksion është i korruptuar apo jo është konfigurimi social midis aktorëve në fjalë. Me tej, përkundër parimit zyrtar se shkëmbimet që ndjekin rregullat e ekonomisë së tregut janë të pakorruptuara, përgjigjet e sondazhit sugjerojnë se një shumicë aktorësh lokalë në fakt e gjykojnë akumulimin e tepërt apo të menjëhershëm si të korruptuar.

Gjithsesi, zbrëthimi i ekuivalencës korrupsion = informalitet dhe i vetë përkufizimit zyrtar të korrupsionit nuk ka për qëllim eliminim e këtyre koncepteve apo të kësaj problematike. Përkundrazi, këto pikëpyetje antropologjike ndaj fushatës anti-korrupsion synojnë të përfshijnë një perspektivë lokale të gjyimit mbi informalitetin dhe etikën e shkëmbimeve. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një komunikim dhe bashkëpunim në përpjekjet për të ndërmarrë politika të drejta ekonomike dhe politike.

## Referenca

- <sup>1</sup> Heidenheimer, Arnold 1989 "Terms, Concepts and Definitions: An Introduction." In A. Heidenheimer, M. Johnston and V. le Vine (eds) *Political Corruption: a Handbook* (New Brunswick, NJ: Transaction.
- <sup>2</sup> Tanzi, Vito. 1999 "Uses and Abuses of Estimates of the Underground Economy" In *The Economic Journal* 109/456. Pp.338-340.
- <sup>3</sup> Aliaj, Besnik. 2008 *Misteri i Gjashtë: Cili është Kurthi që Mban Peng Zhvillimin dhe Integrimin e Ekonomisë Shqiptare më Botën Moderne?* Tiranë: Botimet Afrojdit, fq. 98.
- <sup>4</sup> De Soto, Hernando. 1989 *The Other Path: Invisible Revolution in the third World*. New York: Harper and Row.
- <sup>5</sup> Hart, Keith. 1973 "Informal Income Opportunities and Urban Employment in Ghana." In *Journal of Modern African Studies*. Vol. 11, No. 1, pp. 61-89.
- <sup>6</sup> Ndër të tjera, shiko Ledeneva, Alena 1998 *Russia's Economy of Favours: Blat, Networking and Informal Exchange*. Cambridge and Neë York: Cambridge University Press.; Wedel, Janine. 1986 *The Private Poland*. New York: Facts on File Publications; Sampson, Steven, 1987 "The Second Economy of the Soviet Union and Eastern Europe." In *Annals of the American Academy of Political and Social Science*, Vol. 493, *The Informal Economy* (Sep., 1987), pp. 120-136.
- <sup>7</sup> "Diagnosis of Extralegality in Albania, Final Report" *Program for the Transition to The Rule of Law and an Inclusive Market Economy in Albania*. UNDP & ILD, November, 2007, fq. ii.
- <sup>8</sup> Ibid, iv-v.
- <sup>9</sup> Durkheim, Émile, 1982. *The Rules of the Sociological Method*, (Edited by Steven Lukes; translated by W.D. Halls). New York: Free Press, 1982, pp. 50-59.
- <sup>10</sup> Bayart, Jean-François, Etephen Ellis & Beatrice Hibou, 1999. *The Criminalization of the State in Africa*

Trans. Etephen Ellis. Bloomington & Indianapolis: Indiana University Press.

<sup>11</sup> *Fiks Fare*, 17 Mars 2008.

<sup>12</sup> Kika, Mentor. "Shteti Ynë Informal, i Maskuar me Flamurin e NATOs" *Gazeta Shqip*. 1 korrik 2008.

<sup>13</sup> Ceko, Enriko. "Deformimi i së Mirës dhe të Keqes" *Gazeta Tema*. 4 Korrik 2008.

<sup>14</sup> "Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2008, Përmbledhje e Rezultatit" Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi dhe DPK Consulting. Tiranë, 2008.

<sup>15</sup> Mauss, Marcel 1990 [1954] *The Gift: the Form and Reason for Exchange in Archaic Societies*. Trans. w.D. Halls. Foreword by Mary Douglas. London: Routledge.

<sup>16</sup> Xhaja, Gerti "Pranga Kirurgut dhe Babait të Pacientes" *Gazeta Shqiptare*, 8 korrik 2008. (Italiket e shtuara nga autori).

## KONCEPTET LIGJORE BAZË TË ANTI-KORRUPSIONIT: PËRCAKTIMI I JURIDIKSIONIT, ZGJIDHJET CIVILE DHE DËMSHPËRBLIMET - RASTI I SHQIPËRISË \*

Bryane MICHAEL \*\*

Maurizio VARANESE \*\*\*

**Abstrakt.** Ndonëse për më shumë se 10 vjet organizatat ndërkombëtare, të tilla si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Këshilli i Evropës (KE) dhe Kombet e Bashkuara (OKB) e kanë ndihmuar Shqipërinë në mënyrë të tillë që ajo të adoptojë masa ligjore për të luftuar korrupsionin, fushatat antikorrupsion shpesh nuk kanë pasur rezultatet e dëshiruara për reduktimin e korrupsionit. Ky artikull shqyrton konceptet ligjore bazë të antikorrupsionit në përgjithësi duke i aplikuar më pas këto koncepte në rastin e Shqipërisë në vecanti. Qëllimi është ofrimi i një guide praktike, të frymëzuar nga literatura akademike në fushën e antikorrupsionit, për zyrtarët shqiptarë të cilët synojnë të zbatojnë në agjensitë dhe institucionet e tyre konventat ndërkombëtare anti-korrupsion.

### Hyrje

Për më shumë se 10 vjet organizatat ndërkombëtare, të tilla si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Këshilli i Evropës (KE) dhe Kombet e Bashkuara (OKB) kanë ndihmuar Shqipërinë në mënyrë të tillë që ajo të adoptojë masa ligjore për të luftuar korrupsionin. Megjithatë një punë e tillë shpesh nuk ka pasur rezultatet e dëshiruara për reduktimin e korrupsionit. Konventat kundër korrupsionit të Kombeve të Bashkuara, OECD-së dhe Këshillit të Evropës nuk kanë rezultuar efektive, pasi edhe pse janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ato nuk janë zbatuar në institucionet shqiptare për çështjet e korrupsionit, institucione të tilla si Drejtoria e Policisë kundër Trafikimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ky artikull i shkurtër përpiqet që të ofrojë një guidë praktike (të frymëzuar nga literatura akademike për këtë çështje) për zyrtarët shqiptarë, të cilët synojnë të zbatojnë në agjensitë dhe institucionet e tyre konventat ndërkombëtare anti-korrupsion.

*[Tabela 1(a) dhe (b) tregojnë masat e ndryshme ligjore që mund të adoptohen nga ekonomitë tranzitore për të luftuar korrupsionin si dhe paraqesin argumentat kryesorë të punimit origjinal.]*

\*Përktheu Blerjana Bino, Universiteti European i Tiranës. Ky artikull është një përmbledhje e një punimi më të plotë që mund të gjendet në: <http://www.qeh.ox.ac.uk/RePEc/qeh/qehwps/qehwps150.pdf>

\*\*Bryane Michael është profesor në Kolegjin Linacre në Universitetin e Oxfordit (Linacre College Oxford) dhe njëkohësisht është edhe këshilltar i BE-së për anti-korrupsionin në Evropën Lindore.

\*\*\*Dr Varese është pjesëtar i Komisionit Italian Kundër Shantazhit dhe gjithashtu këshilltar i lartë pranë Këshillit të Evropës dhe Komisionit European. Ai ka pasur pozicione të rëndësishme si në Europol ashtu edhe tek xhandarmaria Italiane (Karinierët). Dr. Varese ka kryer studimet pasuniversitare në Unicersitetin e Sienës.

Figura 1a: Masat e ndryshme ligjore për ekonomitë tranzitore për të luftuar korrupsionin





Figura 1b: Reduktimi i marrjes së ryshfeteve përmes gjobave





## Shkaqet e korrupsionit

Korrupsioni shkaktohet nga *rregullime*<sup>2</sup> të cilat i pengojnë aktorët ekonomik të përfshihen në aktivitete në të cilat ata do të kishin dashur të përfshiheshin. Shqipëria e provon më së miri këtë rregull, pasi Shqipëria renditet në vendin e 135-të në bazën e të dhënave të Bankës Botërore në studimin "Të bësh Biznes" (*Doing Business*) të vitit 2007. Madje në të njëjtin vit renditet e 105-ta në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (*Corruption Perceptions Index*) të Organizatës për Transparencë Ndërkombëtare (*Transparency International*). Këto rregullime shkaktojnë racionim dhe tipe të tjera të *shtrembërimeve ekonomike*<sup>3</sup>, të cilat çojnë më pas në krijimin e atyre që mund t'i cilësojmë si "renta (qera) ekonomike"<sup>4</sup>. Këto renta ekonomike shërbejnë më pas si burim të ardhurash që mund të përdoren për të paguar nënpunësit civil (të cilët supozohet se zbatojnë një grup rregullash të caktuara) për të kryer ose për të mos e kryer detyrën e tyre<sup>5</sup>. Në disa raste më shumë rregulla për nënpunësit civil mund të reduktojnë korrupsionin, sidomos kur këto rregulla ndihmojnë në rritjen e produktivitetit dhe në uljen e fshehtësisë. Ndërkohë që legjislacioni shtesë mund të sjellë ulje të korrupsionit, ai shkakton edhe dëme ekonomike. Legjislacioni kërkon burime të ardhurash në mënyrë të tillë që të zbatohet, pra kërkon edhe mbledhje taksash, të cilat nga ana e tyre shkaktojnë demoralizim të klimës së biznesit. Edhe pse në Shqipëri legjislacioni për nënpunësit civil është një përgjigje shumë e mirë ndaj korrupsionit, një qasje e tillë mund të shkaktojë shpesh kosto më të larta se sa përfitime.

*[Tabla 1(a) dhe Tabela 1(b) paraqesin kuadrin e përgjithshëm të argumentave të këtij artikulli dhe një hartë të dobishme të koncepteve ligjore, të cilët përdoren në reformën legjislative anti-korrupsion.]*

## Transaksionet korruptive

Sipas shumicës së studimeve ndërkombëtare në lidhje me perceptimin për korrupsionin, në Shqipëri, sikurse në shumicën e vendeve në zhvillim, ryshfeti shpesh ngatërrohet me dhuratën<sup>6</sup>. Tre kushte do të mund të ndihmonin nënpunësit e zbatimit të ligjit në Shqipëri (si dhe prokurorët që duhet të vendosin për dallimin mes ryshfetit dhe dhuratës) të kuptojnë dallimin mes ryshfetit dhe dhuratës në kazuset jo penale. Një "pagesë" (një shishe konjak ose një pako me çokollata) nuk konsiderohet si praktikë korruptive sa kohë që:

- dhurata nuk lidhet me kryerjen e një shërbimi të caktuar nga ana e nënpunësit civil,
- ky shërbim është një e drejtë e qytetarit apo e përdoruesit të shërbimeve publike,
- nënpunësi civil nuk mund të parashikonte përpara se të kryente shërbimin se do t'i ofrohej një dhuratë në shkëmbim.

Nëse plotësohen këto kushte atëherë "pagesa" nuk konsiderohet si një praktikë korruptive për kryerjen e një shërbimi të caktuar. Natyrisht që një rregull i fiksuar kundër pranimit të dhuratave do të ishte më i lehtë për tu zbatuar sepse kushtet e më sipërme do të kërkonin konsiderata të veçanta. Legjislacioni ekzistues kundër korrupsionit në Shqipëri nuk përfshin dallimin në konceptet e ryshfetit (mit marrje) dhe të dhuratës: ryshfeti si marrje dhe dhurata si ofrim.

Në Shqipëri shpesh korrupsioni nuk ndëshkohet pasi në shumicën e rasteve, prokurorët nuk bëjnë dallimin mes iniciuesit dhe pjesëmarrësit pasiv në praktikat korruptive. Drejtësia kërkon që pjesëmarrësit pasiv ose të pavullnetshëm duhet të marrin një ndëshkim të lehtë të përfshirjes në korrupsion. Për të përcaktuar përgjegjësinë duhen identifikuar pjesëmarrësit që kanë pasur qëllime krimale. *Përgjegjësia për korrupsionin duhet të bjerë më shumë në palën që ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme metoda të përfshirjes në korrupsion dhe përgjegjësia duhet të bjerë më pak në palën që kishte një nevojë të qartë, aktuale të përfshirjes në praktikë korruptive*<sup>9</sup>. Studimet ndalen në mënyrë të veçantë në zbatjen administrative, në kuptimin që 30% e përdoruesve të shërbimeve publike duhet të paguajnë para më shumë sesa kuota normale e kryerjes së një shërbimi të caktuar, si psh marrja e një dokumenti<sup>10</sup>.

Korrupsioni ndodh në Shqipëri sepse drejtuesit/titullarët e nënpunësve civil nuk ushtrjnë kontrollin e duhur mbi vartësit e tyre. Transferimi i përgjegjësisë shtesë lidhur me korrupsionin në sektorin publik përmes përgjegjësisë së drejtuesit (*përgjigjet shefi për këtë*)<sup>11</sup> në Shqipëri, mund të sillte një rritje të iniciativës së drejtuesve/titullarëve për të kontrolluar nënpunësit si dhe të reduktonte përfitimet nga korrupsioni (sidomos në ato raste ku përfshihet edhe drejtuesi/titullari). Një përgjegjësi e tillë e drejtuesve/titullarëve do të mund të shihej si një mekanizëm i transferimit të rrezikut, duke ia kaluar përgjegjshmërinë drejtuesve në mënyrë të tillë që të bëhen më kërkues ndaj nënpunësve të tyre. Dispozita të tilla do të kishin lehtësuar ndjekjen penale të individëve të tillë si Nikolin Jaka (Zv. Ministër i Transporteve) dhe Bashkim Kamberi (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve) në vitin 2007. Në këto raste nënpunës civil të Ministrisë së Transportit kanë përfituar nga zhvillimi i tenderave.

Në vendet në zhvillim shpesh korrupsioni është i lidhur me klientelizmin dhe shpesh fitimet që burojnë nga praktika korruptive përdoren për të financuar fushatat elektorale. Në Shqipëri, politikanët konsiderohen gjerësisht si të korruptuar, ata renditen në pozicionin e 7.1-të në shkallën nga 1 deri në 10 për mundësinë e përfshirjes në praktika korruptive (në këtë renditje 10 është niveli maksimal i perceptimit si i korruptuar). Një formë e *respondeat politicae* (e ngjashme me konceptin e sipër përmendur të titullarit të përgjegjshëm për veprimet e nënpunësve të tij) mund të ndihmonte në uljen e nivelit të marrjes së rryshfeteve, të cilat përdoren më pas në proceset politike. Sipas parimit të *respondeat politicae*, politikani është ligjërisht i detyruar që të japë dorëheqjen nga funksioni që kryen nëse provohet që fondet që ka përdorur për të financuar fushatën elektorale e kanë burimin nga rryshfetet dhe/ose praktikat e tjera korruptive. Ekuivalenti në politikë i parimit të *titullarit të përgjegjshëm* është i tillë që kërkon që politikani të përgjigjet ligjërisht për përfshirjen e stafit të tij elektorale në praktikat korruptive. Në Shqipëri, është e vështirë që gjyqtarët apo prokurorët të pranojnë një parim të tillë të transferimit apo delegimit të përgjegjësisë, pra të pranojnë që politikanët të mbajnë përgjegjësi për stafin e tyre elektorale. Megjithatë në legjisllacionin shqiptar për proceset zgjedhore dhe fushatat elektorale të partive politike janë parashikuar çështjet e financimit të partive politike, edhe pse Shqipëria mbetet shumë pas në këtë drejtim krahasuar me vendet e tjera<sup>13</sup>.

Të dy parimet, si të titullarit të përgjegjshëm (*respondeat superior*) dhe të politikantit të përgjegjshëm (*respondeat politicae*), e vënë theksin në zgjerimin e përcaktimit ligjor të bashkëfajësisë në praktikat korruptive. Në shumicën e rasteve të korrupsionit, kolegët e zyrtarëve të korruptuar ose merrnin pjesë në mënyrë pasive në këto praktika korruptive ose

të paktën kishin njohuri për to. Në jurisprudencë parashikohen ndëshkime për të dy rastet e përfshirjes në praktikat korruptive, si për shkeljen e ligjit (*delict*) edhe për tentativën për të shkelur ligjin (*inchoate offences*<sup>14</sup>). Në rastet e korrupsionit të mbetur në tentativë përgjegjësia duhet të bjerë mbi nënpunësit civil që kanë dijeni për ose që kanë të ngjarë të kenë dijeni për praktikat korruptive të kryera nga kolegët e tyre. Në Shqipëri nuk kemi asnjë rast të ndjekjes penale të këtij lloji, pra të ndëshkimit të nënpunësve që kishin dijeni për praktikat korruptive të kolegëve të tyre. Raste të tilla mund të gjykohen në të njëjtin gjyq me të akuzuarin kryesor për përfshirje dikert në praktika korruptive, pa pasur nevojë për shpenzime shtesë, të cilat mund të konsiderohen si pengesë.

### **Si ta bëjmë qeverinë një fqinjë të mirë? Zbatimi i parimit të detyrimit për përkujdesje në sektorin publik**

Neni 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar më 1998-n, sanksionon autoritetin e qeverisjes, i cili buron nga një marrëveshje shoqërore (kontratë sociale) mes individëve të lirë. Një marrëveshje e tillë i cakton qeverisë detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtat e qytetarit dhe për të promovuar interesat e tij. Qeveria shqiptare si një organizatë mund të sjellë rreziqe të mëdha për individin dhe hapësirën e tij private. Në bazë të kushtetutës qeveria duhet të ushtrojë detyrimin e saj për përkujdesje ndaj qytetarëve përmes sektorit publik dhe nënpunësve të administratës civile. Ndërkohë që kundrejt qytetarëve institucionet qeveritare kanë detyrimin e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të tyre, kundrejt nënpunësve civil, insitucionet e qeverisë shqiptare kanë detyrimin pozitiv që të sigurohen se këta nënpunës civil nuk kanë stimuj brenda departamentit ku punojnë që i nxisin të përfshihen në praktika korruptive. Nëse një nënpunës civil është i përfshirë në korrupsion për shkak të stimujve të shumtë nga departamenti i tij/saj, atëherë qeveria, si një organizatë, duhet të mbahet përgjegjëse për papërgjegjshmëri në kryerjen e funksioneve të saj, gjë e cila ka çuar më pas në dëmtimin e të tretëve. P.sh në rastin e gjykimit të Nikolin Jakës (në Ministrinë e Transporteve) për marrje ryshfeti, edhe Ministria e Transporteve duhet të ishte konsideruar si përgjegjëse nga gjyqtarët në gjyq. Institucionet qeveritare në përgjithësi krijohen për të marrë përsipër detyrime publike dhe funksionojnë në bazë të parimit të detyrimit për përkujdesje ndaj qytetarëve. Jo vetëm kaq, por këto institucione qeveritare duhet të sigurohen që të mos krijojnë mundësi apo nxitës për nënpunësit e tyre për tu përfshirë në praktika korruptive. Nisur nga këto premisa ndryshon edhe mënyra e paraqitjes së provave në gjyq në rastin e përfshirjes së nënpunësve civil në praktika korruptive. Kështu provat e papërgjegjshmërisë së një departamenti apo agjensie qeveritare mund të konsiderohen si prova në mbrojtje të nënpunësit civil të akuzuar për korrupsion.

Për më tepër qeveria shqiptare duhet të kujdeset edhe për përdoruesit e shërbimeve publike, në kuptimin e parimit të detyrimit për përkujdesje<sup>15</sup>. Pra, nënpunësi civil kur merr ryshfet kryen dy shkelje ligjore: (i) thyerja ligjore personale e kryer nga vetë nënpunësi (*ultra vires*) dhe (ii) thyerja ligjore profesionale, pasi nënpunësi civil ndjek termat e kontratës së tij të punës dhe përfiton nga stimujt apo hapësirat e krijuara nga agjensia qeveritare apo institucioni ku punon. Ndërkohë që në rastet e përfshirjes në praktika korruptive ka procedim administrativ, civil apo penal ndaj nënpunësit civil, duhet të ngarkohet me përgjegjësi edhe departamenti, agjensia apo institucioni ku punon ky nënpunës civil. Kjo përgjegjësi ndaj in-

stitucionit mund të jetë morale nëse nuk mund të jetë ligjore, në rastet kur përdoruesit e shërbimeve publike janë të detyruar të japin ryshfet për kryerjen e një shërbimi. Sikurse do ta shohim edhe më poshtë, një përgjegjësi e tillë duhet të ngarkohet kundrejt individit dhe/ose institucionet në formën e pagesës së gjobave apo tarifave, si dhe dëmi i paguar nga qeveria duhet të jetë i barabartë më dëmin social që kanë sjellë praktikat korruptive të nënpunësve.

Nënpunësit civil në Shqipëri duhet që të kenë një farë detyrimi për të raportuar rastet e mundshme të korrupsionit, nisur nga parimi i "detyrimit për të shpëtuar"<sup>16</sup> përdoruesit e shërbimeve publike nga dëmtimi i tyre nga praktikat korruptive. Është e qartë pra, se mos kallëzimi apo mosraportimi i rasteve të korrupsionit i bën nënpunësit civil shqiptar bashkëpunëtorë të heshtur, por në dijeni të praktikave korruptive. Një zgjidhje e tillë, pra detyrimi për të raportuar, do të ishte shumë efektive, pasi edhe të dhënat nga kërkimet tregojnë se 35% e nënpunësve civil e kanë fituar vendin e tyre të punës në shkëmbim të një favori tjetër<sup>17</sup>. Nëse një nënpunës civil ka të ngjarë të ketë njohuri për korrupsionin e kolegëve të tij të punës, ai duhet të ndiqet dhe të gjykohet sipas standardeve të së drejtës civile apo administrative.

Meqënëse, sikurse argumentuam edhe më lart, drejtuesit e institucioneve qeveritare shqiptare kanë detyrimin e kujdesit që nënpunësit civil mos të kenë stimuj në punën e tyre për tu përfshirë në praktika korruptive si dhe meqë këta drejtues mbajnë përgjegjësi për praktikat korruptive në bazë të parimit të *respondeat superior*, atëherë ata duhet të lejohen të zhvillojnë "kontrolle të ndershmërisë"<sup>18</sup> për stafin e tyre. Një situatë kontrolli e ndershmërisë do të ishte e tillë: drejtuesi cakton një individ, i cili kontakton me nënpunësit civil të departamentit përkatës në rrethana të tilla që të masi sesa shpesh këta nënpunës marrin ryshfete. Meqë kjo është një praktikë shumë e re, qëllimi i këtij kontrolli shpesh është i paqartë. Për më tepër në Shqipëri nuk ka as bazë ligjore për të bërë prova të tilla me nënpunësit civil.

Edhe pse në Shqipëri këto lloj kontrolle të ndershmërisë janë antikushitetuese dhe joligjore, ato mund të zhvillohen në mënyrë të tillë që të shmangin "rënien në kurth"<sup>19</sup> të nënpunësit dhe të mos çënojnë sferën e tij private. Këto kontrolle mund të zhvillohen vetëm me qëllimin e mbledhjes së të dhënave për prirjen e nënpunësve për marrjen e ryshfeteve apo për të matur shpeshësinë e marrjes së ryshfeteve. Natyrisht që kjo praktikë duhet të jetë ligjore dhe të mos marrë parasysh tundimin e mundshëm të nënpunësve për të marrë ryshfete. Nëse këto kushte nuk plotësohen gjatë zhvillimit të këtij kontrolli, atëherë gjykata nuk mund t'i marrë ato parasysh si prova të përfshirjes në afëra korruptive të nënpunësve civil.


## Financimi i anti-korrupsionit

Buxheti shqiptar është shumë i vogël për të përballuar një shkallë të lartë të aktiviteteve anti-korrupsion, të cilat në shumicën e rasteve duhet të jenë të bazuara në vetëfinansim<sup>20</sup>. Një mundësi do të ishte që agjensitë apo institucionet e luftës kundër korrupsionit të merrnin në mënyrë përpjestimore një pjesë nga vlera e korrupsionit të evidentuar. Një veprim i tillë do të sillte jo vetëm një shtim të stimujve për të luftuar korrupsionin, por do të bënte që përpjekjet për të luftuar korrupsionin të lidheshin me nivelin e korrupsionit që mund të preki një agjensi apo institucion të caktuar. Për më tepër këto pagesa do t'i alokonin burimet tek ata individë dhe tek ato agjensi, të cilat mund të luftojnë më mirë korrupsionin. Ndërkohë që disa vende kanë arritur të kenë një përvojë të mirë me këtë skemë (p.sh agjencia anti-korrupsion shet makinat e konfiskuara nga kriminelët dhe ripërdor këto të ardhura financiare), alokimi i buxhetit për

agjensitë apo institucionet anti-korrupsion në varësi të nivelit të korrupsionit të evidentuar mund të sjelli një “zhvatje” të përdoruesve të të mirave publike dhe më shumë inspektime sesa janë të dëshirueshme nga pikëpamja ekonomike, shoqërore apo ligjore. Megjithatë në Shqipëri, shpërblimet për nënpunësit civil (në formën e perspektivës për tu ngritur në detyrë ose në formën e subvencionimit nga qeveria për sektorin publik) mund të shërbejnë si një mënyrë për të ulur stimujt për “zhvatjen” e përdoruesve të të mirave publike.

Një mënyrë tjetër për të financuar aktivitetet anti-korrupsion në Shqipëri është edhe ajo e shpërblimeve të njohura si *qui tam*<sup>21</sup> (dispozitë ligjore që i mundëson një “denoncuesi” të fitojë një sasi të hollash nëse ankesa dhe denoncimi i bërë nga ana e tij kursejnë paratë e qeverisë). Jo vetëm kaq, por *qui tam* ndihmon edhe në parandalimin e korrupsionit me tepër sesa mënyrat e tjera të transferimit të përgjegjësisë që përshkruam më lart. *Shprehja qui tam rrjedh nga qui tam pro domino rege quam pro se ipso in hac parte sequitur*, që do të thotë “ai që bën një veprim për veten dhe për mbretin” ose “ai që padit dikë për mbretin edhe për veten e tij”. *Qui tam* si dispozitë ligjore i mundëson individëve që të padisin një individ tjetër, i cili përmes thyerjes së ligjit ka dëmtuar shtetin, dhe të kërkojnë një pjesë të dëmshpërblimit që paguan ai që ka thyer ligjin. P.sh nëse persona privatë (në vend të hetuesve zyrtarë) do të kishin denoncuar korrupsionin e zyrtarëve të Albpetrol-it (Kompania shtetërore e Naftës në Shqipëri), këta persona do të kishin përfituar një shumë të hollash si shpërblim. Në kuadrin e korrupsionit, shpërblimet në formën e *qui tam* përfshijnë rastet e denoncimit për të ardhurat e humbura nga doganat apo deklarimi i taksave si dhe, me ndryshimet që mund të pësojë legjislacioni shqiptar, mund eventualisht të përfshijë edhe dëmet e shkaktuara nga kufizimet në tregti, dëmet ndaj palëve të treta dhe koston e zbatimit.

Shpërblimi *qui tam* optimal duhet të balancojë nevojën për të shpërblyer denoncuesin, paditësin (whistle-blower) me nevojën për të kompesuar viktimat dhe për të financuar praktikatat e ardhshme anti-korrupsion. Pra, në rastin e aplikimit të shpërblimit *qui tam* duhen mbajtur parasysh këto elementë: shpërblim për denoncuesin, kompesimi i viktimave dhe financimi i ardhshëm anti-korrupsion. Figura 2(a) tregon vlerën ekonomike të dëmit nga korrupsioni si lineare (dhe nuk përfshin dëmet që vijnë nga zhvatjet e përdoruesve të sektorit publik, të cilët përpiqen të kërcënojnë ose të manipulojnë nënpunësit civil!). Ryshtet që marrin nënpunësit civil janë dëme si në formën e parave të paguara në mënyrë jo të vullnetshme (në rastet e detyrimit) ose në formën e humbjes së efikasitetit (si trajtim preferencial i disa individëve ose subjekteve të caktuara). Megjithatë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë korrupsioni dëmton edhe disa palë të treta – kompanitë që konkurrojnë si rryshfëdhënëse (si në rastin e Albpetrol-it të përshkruar më sipër), si dhe konsumatorët që janë në konkurrencë për shërbimet publike të pakta. Korrupsioni për më tepër mund të sjelli rritje të çmimeve, pra si rrjedhojë ulje të nivelit të pagave. Këto dëme shoqërore të korrupsionit tregohen me një vijë lineare në tabelën 2(a).

**Figura 2: Shpërblimi optimal “qui tam” në rastet e korrupsionit**

**Shënim:** *bribe level* – niveli i ryshfetit

*Social harm* – dëmi social

Çdo shpërblim *qui tam*, që është më i madh se kostoja e hetimit dhe evidentimit të korrupsionit, sjell përfitime për disa palë. Figura 2(b) ilustron rastin kur niveli i shpërblimit është më i vogël sesa ryshfeti i paguar. Paratë e tjera i kthehen thesarit shqiptar ose viktimës fillestare dhe palët e treta përfitojnë ngase shpëtojnë nga dëmi që do tu shkaktohej nga praktika korruptive. Figura 2(c) tregon rastin kur denoncuesi paguhet më shumë sesa vlera e ryshfetit dhe një pjesë e fitimit kalon tek palët e treta. Qeveria është ende e interesuar për të kompenzuar denoncuesin për pjesën që u kalon palëve të treta, pasi shoqëria në tërësi përfiton nga ky veprim. Figura 2(d) tregon dëmet në rastet e një shpërblimi shumë të madh. Për ato shpërblime që e tejkalojnë vlerën e të gjitha dëmeve që i shkaktohen shoqërisë, denoncuesit i duhet të gjej një mënyrë për të marrë shpërblimin. Shpërblimi optimal është ai që balancon nevojën për të shpërblyer denoncuesin me nevojën për të përdorur këto burime në aktivitete të tjera produktive anti-korrupsion.

### Kush duhet të merret me hetimin e praktikave korruptive?

Një besim i tepruar në trajtimin si vepra penale të praktikave korruptive nuk është praktik për administratën publike në Shqipëri. P.sh hetimi i Prokurorit të Përgjithshëm, Theodhori Sol-

laku, i cili në vitin 2007 u akuzua për përfshirje në korrupsion, ishte i kufizuar nga legjislacioni shqiptar që parashikonte zgjidhje vetëm për ato veprime të kualifikuara si kriminale. Katër nivele juridiksioni mund të përcaktohen për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht praktikat korruptive, sikurse tregohen më poshtë në Figurën 3.

### Figura 3: Katër nivelet e juridiksionit të mundshme për praktikat korruptive

**Juridiksioni menaxhues:** menaxheri (drejtuesi) i nënpunësit civil të dyshuar për përfshirje në praktika korruptive, merr një ankesë dhe shqyrton provat paraprake. Menaxheri merr masa disiplinore (sikurse janë sanksionet me shkrim) nëse është i bindur për fajësinë e nënpunësit civil. Menaxherët ose drejtuesit mund të merren personalisht me raste të tilla të praktikave korruptive ku bëhet fjalë për shkelje të lehta të ligjit, ku nënpunësi civil është i përfshirë personalisht, nuk e ka përsëritur një veprim të tillë dhe kur bëhet fjalë për shuma të vogla parash.

**Juridiksion administrativ:** nënpunësi civil i dyshuar për përfshirje në praktika korruptive del përpara një trupi gjykues (sikurse mund të jetë edhe një gjykatë administrative). Kjo instancë administrative ka zgjeruar kompetencat e saj të hetimit (duke përfshirë edhe paraqitjen e provave, dëshmitarëve dhe dokumentave) dhe të ndjekjes penale (aftësia për të vendosur gjoba). Juridiksioni administrativ vlen në ato raste kur bëhet fjalë për një marrëveshje të fshehtë mes shumë të dyshuarve, ku përfshihen edhe disa drejtues të niveleve të ulta ose kur menaxheri apo drejtuesi i përgjithshëm nuk mund të gjykojë vetë. Madje kjo instancë administrative mund të marrë në shqyrtim edhe vendimet e juridiksionit menaxhues.

**Juridiksioni civil:** nënpunësi civil i dyshuar për përfshirje në praktika korruptive mund të thirret për të kompesuar viktimat e korrupsionit për dëmin që iu është shkaktuar. Procedura civile është e mirë përcaktuar dhe kërkon një numër më të paktë provash sesa kur trajtohen raste kriminale. Sikurse e analizuam edhe më lart institucionet apo agjensitë qeveritare duhet të lejohen të veprojnë si akuzues ose si mbrojtës në një rast civil të gjykimit të korrupsionit.

**Juridiksioni penal (kriminal):** përdoret në ato raste kur provat janë të mjaftueshme për të bindur gjykatësin ose jurinë se nënpunësi civil është përfshirë në praktika korruptive, pra nuk është thjesht një dyshim i arsyeshëm. Dënimet nën përgjegjësinë penale për një veprim të kryer janë relativisht të ashpra (gjoba që kapin shuma të mëdha ose burgim). Organizatat ndërkombëtare promovojnë penalizimin e praktikave korruptive, pra trajtimin e tyre nën juridiksionin penal, për shkak të efekteve të pritshme të sanksioneve penale në uljen e nivelit të korrupsionit (mbetet që të provohen empirikisht këto efekte të uljes së korrupsionit).

Hetimi i praktikave korruptive duhet të bëhet nga individë ose organizata në mënyrë të tillë që të ketë koston marxhinale më të ulët dhe me fitimin marxhinal më të madh<sup>23</sup>. Prokuroria me siguri që mund të ketë një listë të gjatë (*docket*)<sup>24</sup> me rastet e korrupsionit që presin për tu shqyrtuar. Përzgjedhja e rastit për tu marrë në shqyrtim mund të bëhet në bazë të fondeve të përfshira në një rast të caktuar të korrupsionit (kjo duke pranuar se në raste të rralla ka prova të mjaftueshme për të provuar me siguri shumën e ryshfetit të marrë nga zyrtarë të

korruptuar). Prokurorët mund të hetojnë dhe të ndjekin penalisht ato raste që kanë një vlerë të madhe ose që sjellin dëmin më të madh në tregti. Orët shtesë që shpenzon një prokuror për të hetuar dhe për të mbledhur prova për një rast korrupsioni kanë ndikim të ndryshëm në raste të ndryshme. Megjithatë, përzgjedhja e rastit për tu shqyrtuar nga lista e gjatë mund të bëhet edhe në bazë të gjasave për të mbledhur prova të mjaftueshme për të bindur gjykatësin apo jurinë për fajësinë e zyrtarit apo nënpunësit civil të dyshuar. Pra, ka dy arsye për të vendosur radhën e rasteve të korrupsionit që do të merren në shqyrtim: sasia e të ardhurave të përfshira në korrupsion dhe gjasat për të mbledhur mjaftueshëm prova për të fajësuar një të dyshuar. Në disa raste këto prova mund të mblidhen mjaft mirë edhe nga organet e policisë së shtetit ashtu sikurse edhe nga prokurorët.

Gjithmonë e më tepër korrupsioni po i kalon kufijtë kombëtar. Përfshirja e hamendësuar e Lulëzim Bashës në praktika korruptive me një sërë kompanish ndërkombëtare (duke përfshirë në korrupsion edhe konsorciumin Bechtel-Enka për projektin e ndërtimit të rrugës për në Kosovë), thekson këtë dimension ndërkombëtar të tij<sup>25</sup>. Nisur nga një pikëpamje e tillë Basha ka kryer shkelje në Shqipëri, në Turqi dhe në SHBA. Meqë ekziston parimi themelor se i njëjti rast nuk mund të gjykohet në më shumë se një vend dhe se gjykimi është res judicata (rastet kur jepet një vendim përfundimtar nga gjykata i formës së prerë dhe nuk mund të rigjykohet), del në pah çështja e *forum selection*<sup>26</sup>, pra e zgjedhjes së vendit dhe të gjykatës ku do të shqyrohet çështja. Nëse është e mundur asistenca ligjore ndërkombëtare ose lejohet ekstradimi, atëherë rastet e korrupsionit duhet të gjykojnë nga gjykatat me cilësinë më të lartë. Në këtë rast gjykatat më të mira janë në SHBA (megjithëse gjykata e preferuar do të ndryshonte nga një rast në tjetrin).

A duhet institucionet e zbatimit të ligjit (gjykatat dhe zyrat e përmbartimit) në Shqipëri të pranojnë rregullat dhe ligjet e gjykatave të SHBA-ve si në rastin e Bashës apo në raste të tjera korrupsioni? Meqë korrupsioni dhe procedurat e gjykimit dhe ndëshkimit të tij tejkalojnë kufijtë kombëtar, atëherë gjykatat kombëtare dhe zyrat e përmbartimit duhet të vendosin nëse do të pranojnë vendimet e gjykatave të huaja dhe nëse po, deri në çfarë mase. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për Anti-korrupsionin, vendet, të cilat marrin kërkesa për kthim të fitimeve nga korrupsioni, mund të aplikojnë katër standarde – juridiksioni i jashtëm<sup>27</sup> (pranimi i kërkesave nga jashtë), gjykimet e përkthyer (rigjykimi i çështjes nga standardet ligjore të vendit), gjykimi i përbashkët (pjesëmarrje në hetimin dhe gjykimin e jashtëm), mos pranimi i juridiksionit të jashtëm. Vendimi se cili nga këto standarde do të përdoret varet nga besueshmëria e gjykatës së huaj që shqyrton çështjen dhe nga analiza kosto-përfitim e zgjedhjes së një standardi të caktuar.

Fondet nga kapja dhe gjykimi i rasteve të korrupsionit mund të përdoren për të shpërblyer disa palë dhe zgjedhja e palës përfituese duhet të bëhet në bazë të kriterëve të efikasitetit dhe të paanshmërisë. Një pjesë e këtyre fondeve mund tu alokohet institucioneve të zbatimit të ligjit (gjykata, prokuroria, zyrat e përmbartimit), duke ndihmuar kështu në mbulimin e shpenzimeve për rrogat, për shpërblimet morale dhe materiale për nënpunësit, të cilat nxisin hetimet e mëtejshme të rasteve të korrupsionit ndërkombëtar. Shpërblimi për viktimat e korrupsionit (ose paditësit në një gjyq) inkurajon aktivizimin e qytetarëve kundër korrupsionit dhe bën një kompesim të dëmit të shkaktuar nga praktikat korruptive. Dëmet shoqërore të korrupsionit mund të kompesohen edhe përmes shpërblimeve për grupe individësh të prekur në mënyrë indirekte nga praktikat korruptive. Së fundi, nëse këto fonde të ardhura nga kapja



e rasteve të korrupsionit kalohen në buxhetin e shtetit, mund të ndihmojnë, të paktën teorikisht, në prodhimin e të mirave sociale nga qeveria në sektorin publik si ndërtimi i linjave hekurudhore ose ndërtimi i rrugëve, të cilat i shërbejnë më së mirë shoqërisë shqiptare.

### **Përpjekjet për të zbatuar Konventën e OECD-së kundër dhënies së rryshfeteve**

Konventa e OECD-së penalizon dhënien e rryshfeteve nga businessmen-ët e vendeve anëtare të OECD-së për zyrtarët shqiptarë. Kështu zyrtarët e Bechtel dhe Enka mund të dhe duhet të ndiqen penalisht për rryshfetet që u kanë dhënë zyrtarëve shqiptarë. Suksesi relativ që kanë pasur rastet e ndjekjeve penale sipas Konventës në fjalë na lë të kuptojmë se standardet penale (provimi i fajësisë përtej një dyshimi të arsyeshëm) dhe problemet me hetimin ndërkombëtar janë arsytet e mos suksesit në zbatimin e Konventës së OECD-së. Konventa mund të amendohet në mënyrë të tillë që të ndihmojë në promovimin e zbatimit të ligjit pa kufizuar liritë dhe pa penguar zhvillimin e tregtisë. Përgjegjësia organizative, e cila lidhet me përgjegjësinë e korporatës pavarësisht drejtuesve të saj, mund të përdoret në rastet e korrupsionit. Një përgjegjësi e tillë civile më tepër sesa penale mund të vlejë kur: a) përfaqësuesit e kompanisë (si p.sh Bechtel) mund të dyshojnë se nëpunësit e kompanisë kanë stimul për tu përfshirë në korrupsion dhe kur b) kompania nuk mund të sigurojë dokumentacionin e duhur për të përgënjeshtuar përfundimisht akuzat për korrupsion. Një veprim i tillë mund të ndryshojë paraqitjen e provave për korporatën si një person juridik, por jo për drejtuesit apo anëtarët e stafit të saj. Ky ndryshim i mënyrës sesi përdoren provat justifikohet nga detyrimi i përkujdesjes së korporatës për punonjësit e saj. Kështu që korporata nuk do të akuzohet për korrupsion, por për neglizhencë, pra dështim në kryerjen e detyrës duke dëmtuar kështu edhe të tjerët<sup>28</sup>.

*Përgjegjësia organizative e korporatave*, punonjësit e të cilave dyshohen për përfshirje në praktika korruptive, mund të shërbejë si një mënyrë për të vendosur gjoba ndaj korporatave për neglizhencë në kryerjen e detyrës. Pra, në këtë mënyrë ulen gjasat për korrupsion dhe sigurohen të ardhura për aktivitetet e ardhshme anti-korrupsion. Këto gjoba për neglizhencë ndaj kompanive që nuk tregojnë dot se nuk janë të përfshira në korrupsion, janë një nxitje për vetë monitorimin e kompanive. Nëse niveli i gjobave të vendosura është i ulët, atëherë kompanisë i leverdis më shumë që ta paguaj këtë gjobë dhe të vazhdoj të përfitoj nga korrupsioni. Gjobat që janë shumë të mëdha e "mbysin" tregtinë, pasi bizneset do të shpenzojnë shuma të mëdha parash për të mbrojtur veten e tyre nga korrupsioni i mundshëm. Niveli optimal i vendosjes së gjobave balancon këto dy efekte të sipërpërmendura, ndërkohë që siguron të ardhura edhe për aktivitete të ardhshme anti-korrupsion.

### **Përfundime**

Koventat ndërkombëtare anti-korrupsion do të detyrojnë parlamentin shqiptar dhe Këshillin e Ministrave që të nxjerrin më tepër ligje anti-korrupsion për administratën dhe të shpenzojnë paratë e taksapaguesve në kontrolle, pa mundur të gjejnë mënyra të tjera të financimit të aktiviteteve anti-korrupsion. Megjithatë ka edhe mënyra të tjera për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit krahas zgjidhjeve ligjore. Zgjidhjet më të mira ligjore në rastin e Shqipërisë, shmangin shtrembërimet e shumta ekonomike<sup>30</sup>. Zgjidhjet e tjera ligjore - sikurse

zgjërimi i përgjegjësive për korrupsion përmes ndëshkimit të bashkëpunimit, *respondeat superior*, *respondeat politicae*, dhe zbatimi i parimit të detyrimit për kujdes – ndihmojnë në zgjerimin e përgjegjësive tek më shumë njerëz të përfshirë në një transaksion korruptiv. Zgjidhjet e tjera më të mira janë ato që kanë të bëjnë me shpërblimet për denoncuesit e korrupsionit, hetuesit dhe zyrtarët e tjerë, duke u përpjekur për kompesimin e dëmeve sociale të korrupsionit. Zgjidhja tjetër më e mirë është vetë financimi i aktiviteteve anti-korrupsion, duke i nxitur qytetarët shqiptar që të luftojnë korrupsionin në vend të përfshirjes në të.

### Aneks I: Termat që përdoren në këtë artikull

**OECD** - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, shpesh e njohur edhe si "klubi i vendeve të pasura", është një forum për të negociuar rreth konventave ndërkombëtare mes 30 vendeve më të pasura. Gjithashtu OESD-ja merret edhe me mbledhje dhe përpunim të dhënash ekonomike.

**Këshilli i Evropës** – organizata për të drejtat e njeriut me bazë në Strasbourg dhe formalisht nuk është pjesë e Bashkimit Evropian.

**Konventë** (*convention*) - një marrëveshje mes vendeve për harmonizimin e legjislacionit.

**Legjislacion** (*legislation*) – ligjet që miraton parlamenti ose dega legjislative e qeverisjes.

**Rregullime** (*regulations*)- rregullat që nxjerrin agjensitë ekzekutive, të cilat janë më specifike sesa legjislacioni.

**Renta** (*Rents*) - një pagesë ose e ardhur që një person ka, por jo në sajë të punës apo produktivitetit të tij.

**Shtrembërim** (*distortion*)– një shtrembërim në ekonomi i referohet në mënyrë të veçantë disa kufizimeve të tregut të lirë (çmimet e fiksuar, fuqia e tregut), të cilat shkaktojnë një përdorim jo eficient ose më pak eficient të burimeve të tilla si puna apo kapitali.

**Përfitim** (*consideration*)– një e mirë që i jepet dikujt tjetër, shpesh pagesa në para.

**Sukses/dështim** (*success/failure*)– një test është i suksesshëm ose dështon në varësi të pjesëve të ndryshme të tij që plotësohen ose nuk plotësohen.

**Përgjegjësi** (*liability*)– përgjegjësi ligjore për dëmtimet.

Përmbajtja ndaj detyrimeve kontraktuale (*performance*) – plotësimi apo përmbushja e premtimeve në një kontratë.

**Titullar i përgjegjshëm** (*respondeat superior*)– "përgjigjet shefi për këtë" – koncepti ligjor që i referohet titullarëve, drejtuesve, të cilët mbajnë përgjegjësi për veprimet e nënpunësve të tyre.

**Agjent** (*agent*) – një individ që vepron në emër të dhe për hir të dikujt tjetër. Ky i fundit njihet si "the principal".

**Klientelizm** (*clientelism*) – sistem organizimi ku "shefat" kërkojnë shërbime për vartësit ose agjentët e tyre.

**Përgjegjësi e transferueshme** (*imputed liability*) – përgjegjësi e cila i transferohet ose i ngarkohet dikujt tjetër.

**Bashkëfajsi** (*complicity*)– pjesëmarrje në një krim ose dhunim të dikujt tjetër.

**Keqbërje, shkelje, dhunim** (*offence*)– thyrje e ligjit

**Delict** – veprë penale

**Shkelje e ligjit në tentativë** (*inchoate offences*) - tipe të krimit ku individët bëhen gati ose përgatiten të kryejnë një krim.

**Detyrime pozitive (positive obligation)**– nevoja për të bërë diçka si e kundërta e detyrimit negativ ose pengimi për të bërë diçka.

**Përgjegjësi e deleguar** (*vicarious liability*) – përgjegjësi që i është deleguar, kaluar dikujt tjetër.

**Detyrimi për përkujdes** (*duty of care*) – koncepti anglo-sakson sipas të cilit individët duhet të mos i bëjnë keq të tjerëve ose të parandaloj dëmin ndaj të tjerëve.

**Parimi i fqinjësisë së mirë** (*good neighbour principle*)– lidhet me detyrimin për kujdes, çdo person ka detyrë për të vepruar ndaj të tjerëve si një fqinj i mirë.

**Neglizhencë** (*contributory negligence*) - dështimi në kryerjen e një detyre ose papërgjegjshmëri, e cila çon në dëmtimin e të tjerëve.

**Kujdestari** (*trusteeship*) – marrja ligjore e një organizate nga një tjetër me vendim të gjykatës.

**Detyrim për paraqitje provash** (*burden of proof*) – sasia e provave e kërkuar nga një gjykatës ose juri për të marrë një vendim të caktuar, psh për të provuar fajësinë e një personi.

**Mbrojtje** (*defence*)– një pretendim i përdorur për të mbrojtur një të pandehur apo për të bindur jurinë apo gjykatësit se një person nuk është fajtor.

**Standardet e së drejtës civile** (*civil law standards*)– bindja e arsyeshme e gjykatësit ose e jurisë se një person është i pafajshëm.

**Kundravajtje, shkelje** (*infraction*)– i referohet shkeljes së ligjit (shkelje jo shumë serioze në krahasim me një dhunim).

**Ultra vires** - të veprosh përtej fuqive apo pushtetit personal

**Terma kontraktuale të pashkruarë** (*implied terms*) – termat apo kushtet që merren përsipër nga punëdhënësi, por që nuk shkruhen formalisht në një kontratë të shkruar pune.

**Detyrimi për të shpëtuar** (*duty to rescue*)– detyrimi i qytetarit për të shpëtuar, nëse mundet, një individ nga dëmtimi, mund të ndodhë që ky të jetë edhe një detyrim ligjor.

**Zgjidhje** (*remedy*) - një vendim që zgjidh apo rregullon një dëm të shkaktuar nga një shkelje ligjore. Gjykatësit përshtijnë në sentencat e tyre gjyqësore këto "zgjidhje" (remedies), të cilat i shërbejnë interesit të drejtësisë.

**Kontrolli i ndershmërisë** (*integrity test*) (*integrity probe*)– një test që i bëhet një nënpunësi civil në të cilin ai vendoset në pozicionin ku mund të merrte një rryshfet. Pra, testim i ndershmërisë së tij.

**Dhunim i procedurave** (*procedural violation*)– dhunim apo shkelje e procedurave gjatë zbatimit të një ligji. Në kundërshtim kjo me një dhunim substantiv, ku shkelet përmbajtja e ligjit dhe jo procedura e zbatimit të tij.

**Kurth** (*entrapment*) – proces në të cilin një nënpunës i zbatimit të ligjit e inkurajon një individ që të thyej ligjin.

**E drejta administrative** (*administrative law*)– në SHBA i referohet rregullave dhe legjisla-cionit për funksionimin e qeverisë.

**E drejta civile** (*civil law*) – e drejta që mbulon çështjet e individëve kundër individëve.

**E drejta penale** (*criminal law*)– e drejta që mbulon çështjet e dëmeve kundra të gjithë shoqërisë.

**Qui tam** – dispozitë ligjore që i mundëson një "denoncuesi" të fitojë një sasi të hollash nëse

ankesa dhe denoncimi i bërë nga ana e tij kursejnë paratë e qeverisë.

**“Denoncuesi”** (*whistle-blower*) – personi që denoncon një veprim joetik apo jolligjor të një personi tjetër. Me një konotacion negativ do të përdorej termi “spion”.

**Dëmshpërblim** (*damages*) – i referohet parave që duhet të paguajë pala humbëse ndaj palës fituese në një gjyq.

**Eksternalitete** (*externality*) – një kosto ose një përfitim që veprimi i një individi i shkakton individëve të tjerë. P.sh duhanpirësit shkaktojnë një eksternalitet negativ tek personat që i rrethojnë.

**Përbrendësimi i eksternaliteteve** (*internalization of an externality*) – kur një individ merr përsipër kostot ose përfitimet që shkakton veprimi i tij tek të tjerët. P.sh kur duhanpirësi paguan recetat e mia mjeksore meqë ka shkaktuar eksternalitet negativ përmes pirjes së duhanit.

**Juridiksion** (*jurisdiction*) – hapësira në të cilën një gjykatë ka të drejtë të marrë vendime dhe të japi sentenca gjyqësore.

**Detyrimi për paraqitje** (*subpoena*) – një urdhër i gjykatës që i kërkon një personi të paraqitet në gjykatë.

**Kthim** (*restitution*) – kthimi i parave tek i zoti i tyre.

**Kosto marxhinale** (*marginal cost*) – koncept i huazuar nga ekonomia që i referohet koston së muajve të fundit ose ndryshimeve në kosto. Kosto shtesë për njësi shtesë.

**Përfitime marxhinale** (*marginal benefit*) – koncept nga ekonomia: fitimi shtesë për njësi shtesë. Për më tepër shpjegon edhe ndryshimin në mirqënien sociale.

**Docket** – lista e rasteve që presin për tu shqyrtuar nga një gjykatës.

**Prima facie** – në pamje të parë, i referohet përshtypjes së parë.

**Njohje reciproke** (*comity*) – njohje ose respekt reciprok, parime themelore të së ndrejtës ndërkombëtare.

**Ekstradim** (*extradition*) – procesi i kalimit të një të dyshuari nga një vend në një vend tjetër.

**Akuzues** (*plaintiff*) – personi që bën një padi gjyqësore kundër një personi tjetër.

**Dëme shoqërore** (*social harms*) – humbjet financiare të shoqërisë si një e tërë. Ekonomistët i çaktojnë edhe një vlerë në dollarë këtyre humbjeve me synim që të lehtësojnë krahasimin, edhe pse është vështirë të vlerësosh në sasi parash jetën e një njeriu.

**Të mira shoqërore** (*social goods*) – të mira që konsumohen nga grupe shoqërore (psh edukimi, mbrojtja kombëtare). Këto të mira shoqërore ose të mira publike ofrohen për të gjithë dhe përdorimi i personave të tjerë nuk ndikon në vlefshmërinë e tyre për të gjithë shoqërinë.

**Person juridik** (*legal person*) – person i parashikuar në ligj si një kompani ose firmë, por jo domosdoshmërisht një qenie njërëzore: mashkull apo femër.

**Korporatë** (*corporation*) – bashkim organizatash të cilat ndajnë fitimet dhe rreziqet.

**Forum selection** – përzgjedhja që bëhet nga pjesëmarrësit në një çështje ligjore për vendin ose gjykatën ku do të gjykohet kjo çështje.

## Referenca

<sup>1</sup> Për kritikën ndaj asistencës së donatorëve në Shqipëri shih Harald W. Mathisen, *Donor roles in face of*

*endemic corruption – Albania in the policy debate*, CMI.

<sup>2</sup> **Regullime** (*regulations*)- rregullat që nxjerrin agjensitë ekzekutive, të cilat janë më specifike sesa legjislativi.

<sup>3</sup> **Shtrembërim** (*distortion*)- një shtrembërim në ekonomi i referohet në mënyrë të veçantë disa kufizimeve të tregut të lirë (çmimet e fiksuar, fuqia e tregut), të cilat shkaktojnë një përdorim jo eficient ose më pak eficient të burimeve të tilla si puna apo kapitali.

<sup>4</sup> **Renta** (*Rents*) - një pagesë ose e ardhur që një person ka, por jo në sajë të punës apo produktivitetit të tij.

<sup>5</sup> Për një përblehje të shkelqyer të kësaj çështjeje shih Ilir Gjoni, *Cleansing the Augean Stables: Corruption in Albania Disrupts Democratic Development and Undermines Quality of Life*, *MEDITERRANEAN QUARTERLY* - VOLUME 13, NUMBER 3, SUMMER 2002, pp. 33-39

<sup>6</sup> Vian dhe Burak në studimin e tyre për korrupsionin në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri nënvizojnë se respondentët ngatërrojnë korrupsionin (rryshfetin) me dhuratat në një masë të tillë që lind nevoja e identifikimit dhe ndarjes së qartë të këtyre dy koncepteve gjatë realizimit të një pune kërkimore. Shih Taryn Vian and Lydia Burak, *Beliefs about informal payments in Albania*, 21 *HEALTH POL. & PLANNING* 5, (2006): 392-401.

<sup>7</sup> Kodi Penal Shqiptar ka përfshirë edhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare. Ligji i vitit 2005 për "Parandalimin e konfliktit të interesave në kryerjen e një funksioni publik" (Nr. 9367/7, prill 2005) ka prekur vetëm në mënyrë tangente çështjen e dhuratave dhe ndryshimit me rryshfetin.

<sup>8</sup> Shih Mitchell A. Seligson and Siddhartha Baviskar, *CORRUPTION IN ALBANIA: REPORT OF COMPARISONS BETWEEN 2004 AND 2005 Surveys*, available at: <http://sitemason.vanderbilt.edu/files/hANU6Q/Good%20Governance%20in%20Albania%20v82r.pdf>

Sipas këtij studimi politikanët gjykojnë më ashpër sesa nëpunësit civil për pranimin e rryshfetit. Ndërkohë që ligjërisht parashikohet një ndëshkim i njëjtë.

<sup>9</sup> Për më tepër në lidhje me këto mënyra të mbrojtjes shih Daniela Irrera, *The Balkanisation of Politics: Crime and Corruption in Albania*, RSCAS WORKING PAPERS.

<sup>10</sup> *ibid*

<sup>11</sup> **Titullar i përgjegjshëm** (*respondeat superior*)- "përgjigjet shefi për këtë" - koncepti ligjor që i referohet titullarëve, drejtuesve, të cilët mbajnë përgjegjësi për veprimet e nëpunësve të tyre.

<sup>12</sup> Për më tepër në lidhje me këto mënyra të mbrojtjes shih Daniela Irrera, *The Balkanisation of Politics: Crime and Corruption in Albania*, RSCAS WORKING PAPERS.

<sup>13</sup> *ibid*

<sup>14</sup> **Shkelje e ligjit në tentativë** (*inchoate offences*) - tipe të krimit ku individët bëhen gati ose përgatiten të kryejnë një krim.

<sup>15</sup> **Detyrimi për përkujdes** (*duty of care*) - koncepti anglo-sakson sipas të cilit individët duhet të mos i bëjnë keq të tjerëve ose të parandalojnë dëmin ndaj të tjerëve.

<sup>16</sup> **Detyrimi për të shpëtuar** (*duty to rescue*)- detyrimi i qytetarit për të shpëtuar, nëse mundet, një individ nga dëmtimi, mund të ndodhë që ky të jetë edhe një detyrim ligjor.

<sup>17</sup> *New frontiers in diagnosing and combating corruption*, PREM Notes, October 1998.

<sup>18</sup> **Kontrolli i ndershmerisë (integritetit)** (*integrity probe*)- një test që i bëhet një nëpunësi civil në të cilin ai vendoset në pozicionin ku mund të merret një rryshfet. Pra, testim i ndershmerisë së tij.

<sup>19</sup> **Kurth** (*entrapment*) - proces në të cilin një nëpunës i zbatimit të ligjit e inkurajon një individ që të thyejë ligjin.

<sup>20</sup> Shumica e shqiptarëve nuk mendojnë se sistemi gjyqësor do të ndëshkojë kriminelët (nota vlerësuese është 3 nga 10, ku 10-a tregon gjasat më të mëdha të ndëshkimit). Një arsye për këtë mungesë efektiviteti është edhe buxheti i vogël i sektorit gjyqësor.

<sup>21</sup> **Qui tam** - dispozitë ligjore që i mundëson një "denoncuesi" të fitojë një sasi të hollash nëse ankesa dhe denoncimi i bërë nga ana e tij kursejnë paratë e qeverisë.

<sup>22</sup> **"Denoncuesi"** (*whistle-blower*) - personi që denoncon një veprim joetik apo joligjor të një personi tjetër. Me një konotacion negativ do të përdorej termi "spion".

<sup>23</sup> Për më shumë lidhur me këto koncepte nga ekonomia të përdorura në një kuadër ligjor shih William Aceves, *The Economic Analysis of International Law: Transaction Cost Economics and State Practice*, 17 *U. PENN. J. INT'L ECON. L.* (1996): 995, 1005.

<sup>24</sup> **Docket** - lista e rasteve që presin për tu shqyrtuar nga një gjykatës.

<sup>25</sup> Ministri i Jashtëm, Lulzim Basha, të cilit iu hoq imuniteti, përballet me akuza për korrupsion. *INT'L HERALD*

TRÍBUNE, December 27, 2007.

<sup>26</sup> Parimi i zgjedhjes së vendit dhe të gjykatës ku do të shqyrohet çështja.

<sup>27</sup> Trevor Millington and Mark Sutherland Williams, *THE PROCEEDS OF CRIME: LAW AND PRACTICE OF RESTRAINT, CONFISCATION AND FORFEITURE*, (2003).

<sup>28</sup> Neglizhencë (contributory negligence) - dështimi në kryerjen e një detyre ose përgjegjshmëri, e cila çon në dëmtimin e të tjerëve.

<sup>29</sup> Për një përmbledhje për këto gjoba dhe logjikën e tyre shih Robert Innes, *Enforcement costs, optimal sanctions, and the choice between ex-post liability and ex-ante regulation*, 24 INT'L REV. L. & ECON. 1, (2004): 29-48.

<sup>30</sup> Për më tepër shih Laszlo Csaba, *Regulation and Public Sector Development: A Post-Transition Perspective*, 17 POST-COMMUNIST ECONOMIES 2, (2005): 137-152.

## RRETH SHKAQEVE DHE FAKTORËVE QË LIDHEN ME KORRUPSIONIN: RASTI I SHQIPËRISË \*

Dorian JANO\*\*

**Abstrakt:** Korrupsion është një problem fort i njohur i tranzicionit shqiptar, por kur ai shndërrohet në një konstante të përhershme rrezikon të bëhet pengesa kryesore për konsolidimin e vetë demokracisë shqiptare. Pavarësisht rëndësisë së këtij fenomeni ka çuditërisht akoma një mungesë konsensusi rreth shkaqeve të cilat çojnë drejt korrupsionit. Dy përjasje mund të identifikohen në literaturë. Një pjesë e studiuesve argumenton rreth shkaqeve të korrupsionit nga këndvështrimi i individit (*actor-centred approach*), kurse pjesa tjetër e sheh korrupsionin nga këndvështrimi i institucioneve (*agency-centred approach*). Ky punim do ta analizojë rastin e Shqipërisë në të dyja këto nivele më qëllim që të identifikojë nëse korrupsioni është një rezultat i dështimit të institucioneve (*agency-centred approach*) apo i individit (*actor-centred approach*). Nga ana tjetër ky punim vetë pohon se është e vështirë të flasim për shkaqe (*causal relations*) në rastin e korrupsionit. Prandaj, siç sugjerohet këtu, është më bindëse që debatin ta zhvendosim në nivel faktorësh të cilët janë të lidhur (*correlations*) me korrupsionin sesa të flasim për shkaqe të korrupsionit. Në përfundim të këtij analizimi dy përfundime thelbësore mund të nxirren. Së pari, faktori kryesor i korrupsionit është sistemi problematik i qeverisjes dhe jo predispozitat individualiste apo kulturore. Dhe së dyti, duke konsideruar lidhjen dhe influencën reciproke institucion-individ, një tejzgjatje e këtij fenomeni në sistem ka tendenca për të korruptuar edhe vetë individin duke krijuar kështu atë që quhet 'kleptokraci'.

### Hyrje: Kush ka ndezur 'dritën e kuqe' për korrupsionin në Shqipëri

**S**tudimet e ndryshme mbi korrupsionin, raportet e institucioneve ndërkombëtare, anketimet dhe klasifikimet e organizatave të ndryshme të shoqërisë civile; të gjitha së bashku paraqesin një panoramë tronditëse të korrupsionit në Shqipëri. Le të

\* Një version i këtij punimi në gjuhën angleze është prezantuar në konferencën vjetore të British Association for Slavonic and East European Studies (BASEES), Cambridge - UK, 1 Prill 2006. Autori dëshiron të falenderojë në rradhë të parë organizatorët dhe pjesëmarrësit e panelit (*Unique Transformations: Different Scenarios of Social and Political Change in Central and Eastern Europe*) si dhe Mirela Bogdanin, Stephanie Schwandner-Sievers dhe Leslie Holmes për komentet, kritikën dhe sugjerimet e tyre konstruktive në versionet (anglisht) e mëparshme të këtij punimi. Një falenderim i veçantë edhe për recensues(in/en) e këtij artikulli, komentet e të cilit/ës ndihmuan në sqarimin dhe thellimin e mëtejshëm të disa prej argumenteve si dhe në informimin mbi disa të dhëna më të fundit për korrupsionin në Shqipëri.

\*\* Autori është duke kryer doktoraturën për Shkencat Politike pranë Universitetit të Milanos, Italy. Ai është diplomuar në Universitetin e Aristotelit (Selanik) si dhe ka kryer një Master mbi Studimet e Europës Lindore (MIREES) në Universitetin e Boloniës.

përmendim më konkretisht disa prej tyre për ta ilustruar më mirë këtë konstatim. Banka Botërore e radhit Shqipërinë ndër vendet me nivel korrupsioni më të lartë në Evropë ku në vitin 1998 Shqipëria do të konsiderohet si vendi më i korruptuar i saj.<sup>1</sup> Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit (CPI) nga Transparency International si dhe renditjes së Freedom House, korrupsioni në Shqipëri do të qëndrojë akoma në nivele shumë të larta.<sup>2</sup> Të njëjtin problem nxjerrin në pah edhe anketimet e bëra nga SELDI (Southeast European Legal Development Initiative), ku shumica e të anketuarve (60.8%) e shohin korrupsionin si problemin më të madh që përballet vendi<sup>3</sup>. Edhe studimet më të fundit të kryera nga Instituti Shqiptar për Studimet Ndërkombëtare (Albanian Institute for International Studies – AIIS) konfirmojnë që korrupsioni në Shqipëri ende shihet si problem kyç për Zhvillimin dhe Integrimin e vendit (94,9% e të anketuarve e vlerësojnë si shumë të rëndësishëm ose të rëndësishëm).<sup>4</sup> Në një tjetër anketim drejtuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (United Nations Development Program), 82% e të anketuarve e shohin korrupsionin si arsye kryesore pse Shqipëria ka qënë më e varfra ndër vendet e tjera.<sup>5</sup> Në raportin e 2003-shit të Grupit për Krizat Ndërkombëtare (International Crisis Group) vlerësohet se 50% e GDP-së në Shqipëri vjen nga aktivitetet ilegale duke filluar që nga trafikimi i qenieve njerëzore deri tek kontrabanda e makinave dhe cigareve.<sup>6</sup> Sipas të dhënave të Bankës Botërore, 77% e kompanive shqiptare u kanë dhënë ryshfete zyrtarëve,<sup>7</sup> kjo shumë përlogaritet të jetë rreth US\$ 1.4 billion.<sup>8</sup> Korrupsioni bëhet edhe më problematik kur përkrah ryshfeteve (*bribes*) të marra nga zyrtarë të administratës publike (korrupsioni në administratë) ndeshim atë që shpesh quhet 'kapja e shtetit' (*state capture* – veprime ilegale, nëpërmjet ryshfeteve, për të influencuar në ligj-bërjen dhe në politikat shtetërore). Në një studim për 'kapjen e shtetit', Shqipëria do të radhitet e katërta nga fundi në të 26 vendet në tranzicion të vrojtuar.<sup>9</sup> Në qoftë se do t'i konsiderojmë këto të dhëna në harkun kohor që pas '97-s, fare mirë mund të argumentohet se korrupsioni në Shqipëri është (të paktën) në nivele të pandryshuara.<sup>10</sup> Duke pasur një situatë të tillë fare mirë mund të argumentohet se korrupsioni në Shqipëri po kthehet në një fenomen sistematik, i cili për më shumë po tenton të 'institucionalizohet', duke u infiltruar në jetën ekonomike, në administratën publike, në strukturat qeverisëse të vendit dhe me keq akoma në vetë sistemin politik. Megjithëse "Shqipëria ka një kornizë legjislative dhe institucionale anti-korrupsion impresionuese"<sup>11</sup>, të gjitha argumentet e sjella më lartë të çojnë në përfundimin se çdo masa që mund të jenë marrë për të luftuar korrupsionin në vend nuk kanë pasuar rezultate konkrete.

### *Atëherë lind pyetja: ku qëndron problemi?*

Përpara se të diskutojmë rreth çdolloj mase konkrete apo grup politikash të përpikta planifikuar për të luftuar apo së paku për të zvogëluar korrupsionin, është mëse e nevojshme që në radhë të parë të ekzaminojmë shkaqet që shkaktajnë korrupsionin si dhe të përpiqemi të kuptojmë cilët janë faktorët që ndikojnë në shfaqjen, zhvillimin dhe 'konservimin' e korrupsionit në një shoqëri të dhënë.

Korrupsioni si term i referohet një grupi të madh sjelljesh dhe praktikash që kanë të bëjnë jo vetëm me individin, por edhe me institucionet. Ky konceptim kaq i gjerë në vetvete ka hapur një debat të tërë lidhur me pyetjen nëse korrupsioni shkaktohet për më tepër nga dështimi i institucioneve apo i individit. Me *dështim të institucioneve* duhet të kemi parasysh demokracinë



(në rastin konkret të Shqipërisë), qeverisjen, politikat, administratën dhe ligjet, çdonjëra nga të cilat mund të mos mirë-funksionojë (d.m.th të mund të jetë respektivisht e pakonsoliduar, e gabuar, e pamjaftueshme, e mangët dhe ambigue) ose thjesht të jetë joekzistente. Me *dështim të individit* do të nënkuptojmë specifikat kulturore dhe/ose predispozitat psikologjike të të qenit në thelb 'i keq'. Këto tipare individualiste mendohen të influencojnë moralin dhe etikën e individit dhe si rrjedhojë në këtë mënyrë mund të shpjegojmë dhe sjelljen e tyre të 'korruptuar'. Një tjetër përjasje është ajo e analizimit të një sërë faktorësh 'institucionalë', duke filluar që nga mosfunksionimi i institucioneve të veçantë - si për shembull administrata lokale, gjykatat apo doganat - e deri tek mosfunksionimi i shtetit në tërësi, si shkaqet kryesore të korrupsionit. Por rreziku me çdonjërin nga këto dy përjasje është se shkaqet dhe efektet e korrupsionit që ato pretendojnë nuk janë gjithmonë qartësisht të dallueshme. Për shembull, disa studime kanë treguar që në shumicën e rasteve argumentet e sipërpërmendura janë simptoma më shumë sesa shkaqe të korrupsionit.<sup>12</sup>

Duke konsideruar argumentet e shtjelluara më lart, dy çështje janë thelbësore dhe kërkojnë një trajtim delikat në analizimin e shkaqeve të korrupsionit. Së pari, cilën përjasje duhet të marrim parasysh gjatë ekzaminimit të shkaqeve të korrupsionit? E thënë ndryshe, a duhen analizuar shkaqet e korrupsionit nga një këndvështrim i individëve (*actor-centred approach*) apo nga një këndvështrim i institucioneve (*agency-centred approach*)? Dhe së dyti, a mund të jemi të sigurt që flasim për shkaqet dhe jo për efektet e korrupsionit? Për të trajtuar kompleksitetin dhe natyrën e vështirë të problemit nga njëra anë, si dhe për të shmangur problemin shkak-efekt nga ana tjetër ky punim sugjeron që: së pari, të shqyrtohen të dy dimensionet, si ai i *dështimit të institucioneve* dhe ai i *dështimit të individit*, ku përkrah argumenteve respektiv teorikë të ilustrohet dhe me disa të dhëna empirike, në rastin tonë mbi korrupsionin në Shqipëri; dhe së dyti, shkaqet të trajtohen më shumë si faktorë që kanë lidhje (korrelacion) me korrupsionin. Në këtë mënyrë kjo ese do të përpikët të tregojë se cila nga të dyja, dështimi i institucioneve apo i individit, ka lidhje me korrupsionin. Nëse të dyja, meqenëse nuk mund të ketë thjesht vetëm një faktor, në çfarë niveli këto dy dimensione mund të shpjegojnë korrupsionin shqiptar, sepse në të kundërt termi 'korrupsion' mund t'i atribuohet pothuajse gjithçkaje dhe gjithkujt. Duke e shtruar debatin mbi shkaqet e korrupsionit në dy nivele kryesore si dhe duke i konsideruar ato si faktorë që lidhen me korrupsionin mund të shpjegojmë nëse korrupsioni në rastin e Shqipërisë është për faj të institucioneve apo për faj të individit ose cili nga të dy është më dominues apo faktori i drejtpërdrejtë që ka lidhje me korrupsionin.

### Faktorët që lidhen me individin dhe kulturën

Shpjegimet e para të korrupsionit janë po aq të vjetra sa dhe vetë korrupsioni. Duke cituar një filozof kinez të shekullit të X-të, midis të tjerash korrupsioni mund të shihet si rezultat i "njerëzve të ligj".<sup>13</sup> Edhe sot, shumë studiues e perceptojnë korrupsionin kryesisht si shkak të individit dhe faktorëve të tij psikologjikë ose disa tipareve specifike kulturore të tij. Argumentimi i tyre është se përcaktuesit kryesorë të korrupsionit variojnë në mënyrë të ndjeshme nga shteti në shtet dhe nga rajoni në rajon. Fokusi i këtyre studimeve është tek shkaqet kulturore apo etnike. Sipas këtij këndvështrimi, janë pikërisht formimi (background-i) dhe motivet kulturore shkaqet kryesore të një sjellje korruptive. Në të njëjtat linja disa teori të ndryshme

kriminologjike nxjerrin 'delikuencën' si burim të një sjellje të mundshme korruptive.

Problemi kryesor me çdonjërin nga këto përjasje moraliste-kulturaliste është se ato parapëlqejnë një koncept statik të kulturës apo psikikës së individit dhe si të tilla nuk mund të shpjegojnë ndryshimet në sjelljen individuale përmes ndryshimeve të rrethanave. Tendencat e kësaj përjasje është të shohë korrupsionin sikur të ishte një 'sëmundje' që kërkon 'trajtim mjekësor'.<sup>14</sup> Pra, n.q.s besojmë se individit e ka korrupsionin pothuajse 'në gjak' ose pjesë të kulturës, atëherë është e kotë të flasim për politika anti-korrupsioni sepse një individ 'i keq' në thelb nuk do të ndryshojë sjelljen e tij në çfarëdo situatë.

*Por a është korrupsioni një fenomen i kulturës dhe individit shqiptar?*

Le të konsiderojmë rastin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë si shoqëri me të njëjtat tradita kulturore dhe rrënjë të përbashkëta. Po të shohim treguesit mbi korrupsionin të këtyre dy vendeve, në përgjithësi Kosova prezantohet më mirë në krahasim me Shqipërinë. Sipas një studimi të përbashkët MSI (Management System International) dhe SELDI (shih tabelën 1) treguesi i tolerancës kundrejt fenomenit të korrupsionit që ekziston në shoqërinë shqiptare [2,4] është, në nivel krahasues, më i vogël për Kosovën [2,1]. Tolerimi i shqiptarëve kundrejt korrupsionit është i njëjtë me atë të maqedonasve [2,4] dhe më i afërt me atë të kroatëve [2,2] sesa me shqiptarët e Kosovës. Pjesëmarrja individuale në një aferë korruptive në Shqipëri [2,0] është 286% më shumë se sa në Kosovë [0,7], gjithashtu përhapja e praktikave korruptive ndër nënpunësit e sektorit publik në Shqipëri është 7,0 kurse në Kosovë vetëm 4,9. Nëse do tu referohemi këtyre të dhënave mund të vërejmë ndryshime të mëdha sjelljesh midis qytetarëve shqiptarë dhe atyre kosovarë dhe në të njëjtën kohë ngjashmëri në sjellje midis qytetarëve shqiptarë dhe atyre të vendeve me tradita kulturore të ndryshme. Ky krahasim midis dy vendeve me kulturë të njëjtë, por me sjellje të ndryshme ndaj korrupsionit e bën pra, të vështirë pranimin e argumentit 'kulturë/individ' si faktor që mund të lidhet me korrupsioni (së paku në mënyrë direkte).<sup>15</sup>

**Tabela 1. Sjellja ndaj korrupsionit dhe pjesëmarrja në aferat korruptive në Evropën Jug-Lindore<sup>16</sup>**

	Pranimi në parim (tolerimi) i korrupsionit	Ndjeshmëria ndaj korrupsionit	Pjesëmarrja individuale në afere korruptive	Përhapja e praktikave korruptive
Shqipëria	2.4	4.5	2.0	7.0
Kosova	2.1	2.8	0.7	4.9
Maqedonia	2.4	3.0	1.6	6.8
Mali i Zi	1.5	2.6	1.0	6.0
Kroacia	2.2	2.6	0.6	5.3
BosniaHerzegovina	2.0	2.9	1.5	6.0
Serbia	2.0	2.7	1.4	6.0
Rumania	1.9	3.7	1.1	6.9
Bullgaria	1.3	2.7	0.3	6.4

Burimi: Anketimi për korrupsionin i MSI, Maj 2003 dhe Raporti mbi Indeksën e Korrupsionit i SELDI, Prill 2002. Shih Spector, B., Winbourne, S. dhe Beck, L. (2003) *Corruption in Kosovo: Observations and Implications for USAID*, fq.12

Le të shohim argumentin nga një këndvështrim tjetër. Në gusht të vitit 2001 një skandal plasi lidhur me tenderat e pasaportave të fituara nga një kompani gjermane. Ambasada Amerikane

në Tiranë reagoi duke i dërguar një notë proteste qeverisë së atëhershme duke i kërkuar të shqyrtojë zyrtarisht rastin në fjalë.<sup>17</sup> Në nëntor të vitit 2004, një tjetër skandal i madh doli në shesh ku përsëri implikonte ambasadën gjermane në të ashtuquajturin 'afërën e vizave'. Jo vetëm punonjës shqiptarë, por edhe disa diplomatë gjermanë të ambasadës në Tiranë ishin përfshirë në të, ndaj dhe qeveria gjermane ngriti një grup për të hetuar lidhur me çështjen.<sup>18</sup> Ky u zgjodh si shembull për tu trajtuar sepse gjermanët zakonisht nuk identifikohen si të korruptuar. Gjermani është ndër vendet e para në renditjen e Transparency International, si një nga shembujt e vendeve më pak të korruptuar.<sup>19</sup> Pra, n.q.s përçasja kulturore e sjelljes kurruptive nuk mund të shpjegojë pse vlerat e korrupsionit ndryshojnë në vende me formim kulturor të njëjtë, si në rastin e Kosovës dhe Shqipërisë; ajo shpjegon akoma më pak pse disa individë të cilësuar si të imunizuar ndaj korrupsionit mund të përfshihen në afëra skandaloze kurruptive në një kontekst tjetër. Analizat e SELDI-it sugjerojnë që nën presionin e rrethanave të caktuara është e mundur që qytetarët të kenë tendencë të mëdha për të kompromentuar vlerat e tyre. Të dy rastet e trajtuara në shembujt më lart, si ndryshimi në vlera i sjelljes kurruptive në shtete me të njëjtën kulturë (por me 'institucione' të ndryshme) ashtu edhe përfshirja e individëve të huaj në afëra kurruptive në Shqipëri, të çojnë në konkluzionin se faktori individ/kulturë në vetvet nuk është burim korrupsioni, por janë hapësirat 'institucionale' për afëra kurruptive (n.q.s ekzistojnë) atje ku duhen kërkuar shkaqet e korrupsionit dhe jo tek formimi kulturor apo etika individuale. Kur organizimi i një komuniteti nuk mirë-funksionon ose funksionon dobët atëherë ai lë gjithnjë hapësira për sjellje të tilla kurruptive pavarësisht kombësisë, fesë apo edukimit të individëve që ai përfshin.

### *Korrupsion i 'justifikuar'*

Megjithëse faktori individ, si 'gjenerues' i drejtpërdrejtë i korrupsionit, është i dobët në shpjegimin e korrupsionit mund të kemi akoma disa motivime personale, të cilat indirekt nxitin që korrupsioni në Shqipëri të jetë në nivele të larta. Nën kushtet aktuale të transicionit shqiptar, individit mund të ndihet i 'detyruar' të kërkojnë ryshfete, për shembull n.q.s pagat janë të ulëta. Në të njëjtën kohë ai mund të ofrojë ryshfete për shembull n.q.s do t'i nevojitet të kryejë një punë apo për të shmangur le të themi një gjobë. Në këtë mënyrë mund të 'justifikohet' pse korrupsioni vërtet bën pjesë në jetën e përditshme të një pjese të mirë të shqiptarëve. Si i tillë korrupsioni vazhdon e bëhet gjithnjë e më shumë i pranueshëm në shoqëri duke u transformuar në një pashmangshmëri për mënyrën e menaxhimit të jetës private deri sa në fund mund dhe të bëhet një formë jetese e përbashkët.

Megjithatë ka dhe një anë tjetër të medaljes. Po t'i referohemi anketimeve, shqiptarët e refuzojnë pranueshmërinë e korrupsionit në parim.<sup>20</sup> Për më tepër në Shqipëri tendencat për pjesëmarrje individuale në afëra kurruptive është zvogëluar shumë në krahasim me vendet e tjera të rajonit megjithëse shqiptarët e kanë kuptuar efikasitetin social të aferave kurruptive.<sup>21</sup> Atëherë si mund të shpjegohet një kontradiksion i tillë, kur nga një anë pjesëmarrja në afëra kurruptive është ulur, ndërkohë që perceptimi i korrupsionit qëndron akoma i lartë. Një mënyrë të interpretuari të bën të mendosh se korrupsioni është 'tkurur' drejt një grupi individësh të kufizuar në numër, por me një ekspozim publik të madh, të cilët me efikasitet mbështesin korrupsionin. Nga kjo pikëpamje korrupsioni në Shqipëri nuk duhet të shihet si një çështje e 'sasisë' së individëve të përfshirë në të, por në fakt e 'kualitetit' të atij grupi individësh të

korruptuar, të cilët mund të kenë postet më të larta në shoqërinë dhe qeverisjen shqiptare.

*Nga korrupsioni i 'justifikuar' në korrupsionin 'elitar' ...apo anasjelltas? Po të konsiderojmë motivet personale si faktor indirektë në nxitjen e korrupsionit është me interes të ekzaminojmë cilët individë kanë më tendencë drejt korrupsionit dhe a është më i predispozuar individ i kur bëhet më i rëndësishëm në shoqëri? E thënë me fjalë të tjera, a është sfera e lidërshiptit atje ku korrupsioni përhapet më shumë dhe atje ku duhet kontrolluar? Kjo për vetë faktin se në Shqipëri shpesh herë edhe vetë institucionet identifikohen me lidërshiptin në krye. Po të kemi parasysh rastin me të fundit kur i gjithë debati politik u përqëndrua tek kryeprokurori si emër dhe jo tek reformat apo masat për të reformuar institucionin e prokurorisë.*

Gjatë qeverisjes së parë të Partisë Demokratike shumë prej zyrtarëve qeveritarë, punonjës të lartë të administratës dhe ligjvënës u akuzuan për përfshirje në afëra korruptive. Edhe pas ndryshimeve në 1997-n me socialistët në pushtet, ky 'korrupsion elitar' do të vazhdojë. Deri më sot, një numër i madh i zyrtarëve të lartë, si shefa policie, drejtorë ministrie apo edhe zëvendësministra janë akuzuar për përfshirje në skandale të ndryshme korrupsioni. Kjo situatë lë të kuptosh se korrupsioni është përfshirë brenda institucioneve shqiptare politike dhe shtetërore. Ata që supozohet të luftojnë korrupsionin janë po ata që e praktikojnë atë. Në kushte të tilla, individ i nuk mund të kundërveprojë pasi 'fuqia' e tij për të luftuar kundër korrupsionit mund të krahasohet me luftën e Don Kishotit kundër mullinjve të erës. Shqiptarët tek vërejnë politikanët, doganierët dhe gjykatësit që e injorojnë korrupsionin si problem apo më keq akoma e praktikojnë vetë atë, thjesht do të ndjekin shembullin e liderëve të tyre. Pasi siç argumenton edhe Machiaveli, qytetarët si njerëz të thjeshtë janë të dobët dhe jo shumë të virtutshëm prandaj ata duhet të udhëhiqen drejt nga një lider i madh, i cili mund të injektojë të tjerët me virtutet e tij.<sup>22</sup> Pra, një sjellje ideale elitare mund të sigurojë nxitjen më të mirë të mundshme të individëve drejt ndershmërisë. Pa një lider ose grup elitare të tillë korrupsioni rritet dhe përhapet në të gjithë dimensionet e tij. Në varësi të reputacionit të autoriteteve dhe liderëve në shoqëri, d.m.th të korruptuar ose jo, do të varet jo vetëm niveli i korrupsionit, por gjithashtu dhe shtrirja e tij brenda një shoqërie. Argumentime të tilla e shohin korrupsioni si 'infektues'<sup>23</sup> d.m.th njëherë që një organizëm (në rastin konkret shteti) është i korruptuar atëherë çdo person që vjen në kontakt me të ka një risk të madh për tu korruptuar. Pra, në këtë rast lidërshipti është pikë referimi ndaj e vetmja mënyrë për të kontrolluar korrupsionin është duke siguruar që shoqëria ka liderin e duhur. E parë në kontekstin shqiptar, ku ekziston një vakum institucional apo mënyrë jo e drejtë e perceptimit të institucioneve (institucionet nuk janë thjesht lidërshiptet) argumenti për të pasur një lidërshipt të ndershëm mund të duket një alternativë. Por pyetja qëndron, a është kjo një zgjidhje e qëndrueshme e problemit duke konsideruar që demokracia në vetvete nënkupton rrotacion? Një alternativë më e pranueshme dhe më e qëndrueshme e problemit është analizimi i faktorëve që lidhen me institucionet.

### **Faktorët që lidhen me institucionet**

Nga sa u analizua më sipër duket qartë se ekzistojnë motive personale të atyre që japin dhe marrin ryshfete, por këto gjithsesi janë pasojë e kontekstit ku individ i vepron dhe jo thjesht një problem moralo-kulturor i tij. Për shëmbull, lidërshipti shqiptar është më i predispozuar për vetë faktin se konteksti në të cilin ai vepron (institucioni) i lë atij hapësira për afëra

korruptive. Si rrjedhojë korrupsioni duhet kërkuar më shumë tek shtrembërimi i strukturave dhe institucioneve politike, sociale dhe ekonomike të një vendi të cilat më pas mund të shkaktojnë dhe shpërfytyrimin e individit. Në këtë këndvështrim, po citojmë Rousseau-in, i cili argumenton se nuk është korrupsioni i individit ai që rrënon sistemin politik, por është sistemi politik ai që korrupton dhe rrënon individin.<sup>24</sup> Një shembull i tillë është edhe rasti i Shqipërisë ku mënyra e funksionimit të sistemit politik është çka gjeneron dhe mban gjallë korrupsionin. Kjo së pari sepse, legjislativi (deputetetë) ekzekutivi (ministrat) dhe gjyqësori (prokurorë dhe gjykatës), tre shtyllat kryesore nga mund të kontrollohet korrupsioni, janë vetë ndër më të korruptuarat<sup>25</sup>. Dhe për më tepër, sistemi i qeverisjes në Shqipëri vuan nga e ashtëquajtura sindroma e 'qeverizimit të shoqërisë' ('governmentalization of society') ku qeveria gradualisht po shkon drejt kontrollit të institucioneve të pavarura<sup>26</sup>. Një sistem i tillë i korruptuar dhe i 'pavarur' jo vetëm nuk ka garantuar dhe nuk do të garantojë kontrollin e korrupsionit, por në të kundërt është i predispozuar për ta 'promovuar' atë. Monopolizimi i institucioneve shtetërore me militantë të devotshëm për t'i shërbyer interesave të lidershit dhe jo institucioneve që ata përfaqësojnë do të bëjë jo vetëm që institucionet të mos kryejnë funksionin e tyre të mirëfilltë (në rastin konkret atë të luftimit të korrupsionit), por për më tepër (në rastin më ekstrem) mund të stimulojnë tek qytetarët ndjesinë se një sjellje korruptive nuk ndëshkohet, pra është normë dhe pjesë e shoqërisë. Ekzistenca e klaneve politike, të cilat në të kaluarën jo rrallë herë kanë qënë të lidhura ngushtë me krimin e organizuar, si dhe mungesa e respektit ndaj ligjit nga zyrtarë të rangut të lartë janë tiparet kryesore të një sistemi politik të deformuar. Këto tipare kanë gjeneruar dhe bërë të mundur shtrirjen e korrupsionit në një shkallë kaq të gjerë. Një sistem i tillë i deformuar dobëson së tepërmi shtetin dhe për më tepër krijon një rreth vicioz ku shteti i dobët vepron njëkohësisht si shkak dhe konsekuencë e korrupsionit gjithpërfshirës.<sup>27</sup>

### *Ku qëndrojnë argumentet për një sistem të korruptuar në Shqipëri?*

Është për tu theksuar se në Shqipëri gjithë vëmendja është përkushtuar vetëm tek korrupsioni në administratë ndërsa korrupsioni i partive politike as që përmendet fare. Kjo sepse është e pamundur të gjesh evidenca zyrtare mbi korrupsionin politik, ato thjesht nuk ekzistojnë. Një fakt i tillë duket mëse i besueshëm po të konsiderojmë se në Shqipëri edhe sistemi juridik është konsideruar ndër më të korruptuarit<sup>28</sup>. Megjithatë ka një sërë argumentesh të cilat ngrenë dyshimet që partitë politike kanë lidhje me korrupsionin në Shqipëri. Së pari, origjina e dyshimeve vjen nga mungesa e transparencës në mënyrën e financimit të tyre. Në Shqipëri askush nuk e di vërtet përmes çfarë burimesh financohen partitë politike sepse "këto kontribute nuk janë të hapura".<sup>29</sup> Nga ana tjetër, financimet për fushatat elektorale ndërmerren kryesisht nga kontribute private. Këto transferime bëhen direkt tek partitë dhe ndonjëherë kanë lidhje të dyshimta me bizneset dhe krimin e organizuar.<sup>30</sup> Kjo tendencë e financimit dhe e sponsorizimit nga 'biznese jo të pastra' gjendet në pothuajse gjithë klasën politike shqiptare duke sjellë si rezultat dobësimin e institucioneve demokratike.<sup>31</sup> Problemi i dhurimeve nga biznesi dhe individë, kryesisht në demokracitë e reja, vë në pikëpyetje ekzistencën e një qeverisje përfaqësuese të elektoratit. Rekomandimet e ODIHR-it tregojnë nevojën e menjëhershme për të rregulluar financimin e partive gjatë zgjedhjeve dhe për të bërë publike si shpenzimet ashtu edhe kontributet që derdhen në parti.<sup>32</sup> Megjithëse ligji formalisht ekziston,<sup>33</sup> ky duket të këtë mbetur thjesht në letër pasi në të vërtetë nuk ka kontroll real mbi

financimin e partive në Shqipëri. Kjo vjen si rezultat i një vakumi për shkak se, ndonëse ligji ekziston dhe partitë politike janë të detyruara të deklarojnë burimet e tyre financiare nuk ka asnjë mekanizëm që të lehtësojë Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve t'i hetojë ato. E vetmja mënyrë është nëpërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe ky i fundit në dispozitat ligjore ka për detyrë të kontrollojë vetëm financimet publike të partive politike, por jo të ardhurat nga burime të tjera private.<sup>34</sup>

Një burim tjetër, i cili ka aluduar mbi korrupsionin politik në Shqipëri, është edhe media. Akuza të shumta janë ngritur në publik edhe nga vetë politikanët drejtuar njëri-tjetrit. Një pjesë e mirë e studiuesve i sheh këto argumente më shumë si një mjet hakmarrjeje politike dhe si rrjedhojë pak të besueshme. Megjithatë po të përdorim një përqasje si ajo e 'dilemës së të burgosurve' (*prisoners' dilemma*) mund të argumentohet që kjo kulturë mediatike ka bërë që të humbin të gjithë politikanët pasi secili prej tyre ka vënë në dukje aferat korruptive të tjetrit.

#### *Drejt vendosjes së një 'kleptokracie'*<sup>35</sup>

Në ekzaminimin e korrupsionit në përgjithësi mund të thuhet se problemi më madhor është 'kapja e shtetit' (nga interesat e biznesit) që nënkupton ligjëbërjen në interes të një grupi të caktuar biznesi duke influencuar qeveritarë apo ligjvënës nëpërmjet lidhjeve biznes-politike. Një studim i Bankës Botërore tregon se institucionet më të kapura prej interesave të biznesit janë partitë politike dhe gjykatat (krahasuar me vlera më të larta se vendet e Evropës Lindore apo ish-Bashimit Sovjetik) ndërkohë përlllogaritja e "kapjes së shtetit" (nga interesat e biznesit) në përgjithësi është në nivele mesatare (diçka më pak sesa mesatarja e vendeve të Evropës Lindore)<sup>36</sup>. Një rezultat i tillë është mëse i pranueshëm po të konsiderojmë që biznesi shqiptar (sidomos në vitet kur është kryer studimi) nuk ka qënë tepër i organizuar. Problemi në rastin e Shqipërisë nuk qëndronte tek fakti që shteti ishte kapur peng nga elita e biznesit, por tek fakti që shteti ishte kapur peng nga vetë elita politike për interesa personale. Një numër studimesh dhe analiza kanë pohuar se "disa ministra, zyrtarë qeverie dhe parlamentarë kanë qënë thellësisht të implikuar në afëra korruptive"<sup>37</sup>. Për më tepër grupe kriminale kanë pasur shpesh marrëdhënie personale (ndonjëherë edhe marrëdhënie familjare) me parti të caktuara politike.<sup>38</sup> Personat e implikuar në trafikim kanë qënë shpesh me përkrahje politike<sup>39</sup> ose më keq akoma, sipas fjalëve të një ish-ministri, ka pasur dhe vetë politikanë midis kontrabandistëve<sup>40</sup>. Kjo situatë e tillë e akumuluar gjatë periudhës së tranzicionit ka sjellë dobësimin e institucioneve legjitime përkundrejt krijimit të "strukturave paralele në qeverisje"<sup>41</sup> duke kapur kështu nga brenda peng shtetin. Në rastin e Shqipërisë, shteti jo vetëm që ishte kapur nga interesa të forta dhe të mirë-organizuar, por akoma më keq ai ishte kapur nga krimi i organizuar dhe elementë brenda politikës dhe strukturave qeverisëse të cilat drejtpërdrejt ose me marrëveshje të fshehta me kriminelët ishin përzierë në një varg aferash korruptive.<sup>42</sup> Nëse problemi i kapjes së shtetit nga brenda do të vazhdojë të jetë present në institucionet shqiptare atëherë ka rrezik të kthehet në një fenomen. Për rrjedhojë jo vetëm që nuk do të ketë ndërhyrje reale nga shteti për të ndaluar korrupsionin pasi ai është përfshirë vetë në të, por në të kundërt do të krijojë një ambient të tillë ku gjithë format e korrupsionit mund të lulëzojnë më së miri. Dështimi i institucioneve në Shqipëri, të cilat janë kapur nga sindroma e korrupsionit, mund të infektojnë gjithë institucionet me rrezikun e vendosjes së një sistemi 'kleptokratik'.

## Përfundime

Ky diskutim u përpoq të argumentojë se shqiptarët si individë nuk janë më të predispozuar për korrupsion sesa gjithë njerëzit e tjerë në këtë planet. Sidoqoftë ata po përballen me një sistem qeverisje të dobët dhe një elitë politike të korruptuar. Ky dështim i institucioneve ka ndihmuar në riprodhimin e korrupsionit deri në atë masë sa që individ i është dorëzuar korrupsionit si pjesë e normalitetit. Pra, mund të thuhet se: së pari, në linjë dhe me rezultatet e Paldam-it, "kultura është një shpjegim inferior për nivelin e korrupsionit"<sup>43</sup> dhe së dyti, vendosur në fjalët e Karl Friedrich-ut, korrupsioni është "një sëmundje kryesisht e sistemit politik"<sup>44</sup>. Por rreziku më i madh qëndron tek fakti se me kalimin e kohës shqiptarët gjithnjë e më shumë po ambientohen dhe po e pranojnë korrupsionin. Ata jo vetëm që ndihen shumë të dobët për të luftuar korrupsionin, por në një mënyrë apo në një tjetër janë bërë bashkëfajtorë me të. Kjo e bën rastin akoma më të vështirë dhe gjithnjë e më të pamundur për tu zgjidhur. Rreziku i vërtetë i demokracive të reja, si në rastin e Shqipërisë nuk vjen nga individët e shoqërisë, në të vërtetë ajo vjen nga fakti se sistemi politik i saj është tërësisht i korruptuar. Korrupsioni, ndonëse një e metë e tranzicionit shqiptar, ka rrezik të kthehet në normë duke konsideruar përmasat dhe shtrirjen e saj. Ndaj kërkohet një ndërhyrje jo vetëm e shpejtë, por për më tepër një ndërhyrje e duhur, e cila të luftojë faktorët që lidhen me korrupsionin ('shkaqet') dhe jo efektet e tij.

## Referencat

- <sup>1</sup> Referencë Peza, A. (2001) "Albania: Metastases of Corruption" në *Corruption in the Countries of South-Eastern Europe*, Alternative Information Network, I disponueshëm në <<http://www.southeasturope.org>>
- <sup>2</sup> Prej 2003 deri 2006 Shqipëria do të variojë në vlerat 2.4 - 2.6 në një shkallë nga 0 shumë e korruptuar (highly corrupt) në 10 shumë e pakorruptuar (highly clean). Këto shifra e radhitin Shqipërinë një ndër vendet më të korruptuara, psh në 2003 Shqipëria radhitej e 92 nga 133 vende, kurse në 2006 radhitej e 111 nga 163 vende duke bërë vetëm një progres minimal. Shih Transparency International CPI në <<http://www.transparency.org>>. Shih edhe Freedom House në <<http://www.freedomhouse.org>>, ku renditja për periudhën 2002, 2004 dhe 2005 do të jetë 5.25 në një shkallë nga 1 deri 7, ku 7 është vlera më e lartë e korrupsionit.
- <sup>3</sup> Shih SELDI, 2002, "Corruption Indexes. Regional Corruption Monitorino in Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Macedonia, Romania, and Yugoslavia", fq.6. I disponosh në <[http://www.seldi.net/SELDI\\_fin\\_e2.PDF](http://www.seldi.net/SELDI_fin_e2.PDF)>.
- <sup>4</sup> Me hollësi Albanian Institute for International Studies - AIIS, (2007) "Rethinking European Integration – Perceptions and Realities", Tiranë, këtu fq.37-39
- <sup>5</sup> Referencë Freedom House (2004) "Albania," në A. Motyl and A. Schnitzer (eds.), *Nations in Transit: Democratization in East Central Europe and Eurasia*, (New York: Rowman & Littlefield)
- <sup>6</sup> Shih ICG (International Crisis Group) (2003) *Albania: State of the Nation*, Balkans Report N°140, Tirana/Brussels, fq.5
- <sup>7</sup> Shih Heritage Foundation (2006) "Albania" në *Index of Economic Freedom*, Washington, DC
- <sup>8</sup> Shih World Bank (2004) *Albania Sustaining Growth Beyond the Transition*, A World Bank Country Economic Memorandum, fq. 110
- <sup>9</sup> Gray, C. Hellman, J. dhe Ryterman R.S.. (2004) *Anticorruption in Transition 2: Corruption in Enterprise-State Interactions 1999-2002*, The World Bank, fq.32
- <sup>10</sup> Shih "Governance Matters 2007: worldwide governance Indicators", 1996-2006, Albania në <[http://info.worldbank.org/governance/wgi2007/sc\\_country.asp](http://info.worldbank.org/governance/wgi2007/sc_country.asp)>, ku vlerat e kontrollit mbi korrupsionin për periudhën 2000-2006 mbetën pothuajse konstante.
- <sup>11</sup> Shih Freedom House (2005) "Albania," në J. Goehring and A. Schnitzer (eds.), *Nations in Transit*:

*Democratization from Central Europe to Eurasia*, (New York: Rowman & Littlefield)

- <sup>12</sup> Shih UNODC "Corruption. What Causes Corruption?"; Shih edhe Graaf, G. (2004) "Portraits of Corruption: Towards a Contextual Theory of Corruption", Paper presented at European Group of Public Administration Conference, Ljubljana, fq.5
- <sup>13</sup> Referuar në Carvajal, R. (1999) "Large-scale Corruption: Definition, Causes, and Cures", Paper presented at Russell L. Ackoff and The Advent of Systems Thinking conference, fq. 138-153, këtu fq.141
- <sup>14</sup> Shih Graaf, G. (2004) "Portraits of Corruption: Towards a Contextual Theory of Corruption" (Si shënimi 12), fq.7
- <sup>15</sup> Është fakt që në periudhën kur është kryer studimi Kosova ka qënë nën administrimin e UNMIK-ut, (falenderoj recensues(in/en) e këtij artikulli që e solli këtë argument). Ky fakt forcon argumentin se sjellje korruptive të ndryshme nuk mund ti atribuohen elementeve të cilët janë të njëjtë në të dy rastet. Përkundrazi shkaqet duhen parë tek elementët e ndryshëm që kanë këto dy raste. Në shembullin konkret, qeverisje të ndryshme.
- <sup>16</sup> Shkalla e vlerësimit varion nga 1 në 10, situata e korrupsionit është më keq sa më afër vlerës 10 dhe më e mire nis është vlerë e vogël (afër 0-s)
- <sup>17</sup> Me hollësi Semini, L. (2002) "Skandali i pasaportave dhe lufta kundër korrupsionit", AIM
- <sup>18</sup> Me hollësi Shuka, A. "Ministria e Jashtme Gjermane e qetë ndaj ngritjes së komisionit hetimor për aferën e vizave", Deutsche Welle, Berlin, 10.11.2004
- <sup>19</sup> Shih Indeks in e perceptimit të korrupsionit (CPI) në Transparency International
- <sup>20</sup> SELDI (2002) "Corruption Indexes...", (Si shënimi 3), fq.8.
- <sup>21</sup> Shënimi i mësipërm, fq.13
- <sup>22</sup> Referuar në Carvajal (1999) "Large-scale Corruption: Definition, Causes, and Cures" (Si shënimi 13), fq.141
- <sup>23</sup> Me hollësi Graaf, G. (2004) "Portraits of Corruption: Towards a Contextual Theory of Corruption" (Si shënimi 12), fq.7-8
- <sup>24</sup> Referuar në Carvajal (1999) "Large-scale Corruption: Definition, Causes, and Cures" (Si shënimi 13), fq.142
- <sup>25</sup> Për një studim më të fundit mbi perceptimet e korrupsionit në Shqipëri shih IDRA (2008) "*Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja*", Tiranë
- <sup>26</sup> Referencë Freedom House (2008) "Albania," në A. Motyl and A. Schnitzer (eds.), *Nations in Transit: Democratization in East Central Europe and Eurasia*, (New York: Rowman & Littlefield), fq. 61
- <sup>27</sup> Për një argumentim të njëjtë mbi vendet e Evropës shih Della Porta, D. (2000) "Social Capital, Beliefs in Government, and Political Corruption.", në *Disaffected Democracies: What's Troubling the Trilateral Countries?* S.J. Pharr and R.D. Putnam (eds.), (Princeton: Princeton University Press), fq.205
- <sup>28</sup> Shih SELDI (2002) "Corruption Indexes...", (Si shënimi 3), fq.19-20
- <sup>29</sup> Shih IFES (International Foundation for Election Systems) Albania (2004) "Tackling Corruption World Wide", The British Council seminar Oxford, England, fq.4; Me hollësi Ikstens, J., Smilov, D. dhe Walecki, M. (2002) *Campaign Finance in Central and Eastern Europe: Lessons Learned and Challenges Ahead*, IFES; Shih edhe Pinto-Duschinsky, M. (2002) "Financing Politics: A Global View", *Journal of Democracy* 13:4, fq.76
- <sup>30</sup> Shih Ruli, G. (2003) "Albania: the Weakness of the State" në W. van Meurs (ed.) *SouthEastern Europe: Weak States and Strong International Support, Prospects and Risks Beyond EU Enlargement*, Vol. 2, (Opladen: Leske and Budrich/ Bertelsmann Foundation)
- <sup>31</sup> Shih Gjoni, I. (2002) "Cleansing the Augean Stables: Corruption in Albania Disrupts Democratic Development and Undermines Quality of Life", *Mediterranean Quarterly* 13:3, fq.33-39, këtu fq.38
- <sup>32</sup> Shih IFES Albania (2004) "Tackling Corruption World Wide", (Si shënimi 30), fq.4
- <sup>33</sup> Me hollësi Tjernström, M. (2003) "Matrix on Political Finance Laws and Regulations," në R. Austin and M. Tjernström (Eds.), *Funding of Political Parties and Election Campaigns*, IDEA Handbook Series, fq.181-237, këtu fq.185
- <sup>34</sup> Falenderoj recensues(in/en) e këtij artikulli që e solli këtë argument. Funkzionet dhe detyrat e KLSH janë përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin organik nr. 8270, datë 23.12.19997, plotësuar me amendimet përkatëse me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". Ku thuhet shprehimisht se: "KLSH ka për detyrë të kontrollojë: ... Përdorimin e fondeve që iu janë dhënë nga buxheti i shtetit partive politike dhe shoqatave". I disponosh në <<http://www.klsh.org.al>>
- <sup>35</sup> Këtu termi lë të kuptojë korrupsionin (high level) nga zyrtarë të lartë brenda institucioneve shtetore



<sup>36</sup> Shih World Bank (2001) "State Capture and Governance in Transition (BEEPS) Dataset". Për një analizë më të zgjeruar Shih raportin "Seize the State, Seize the Day: State Capture, Corruption, and Influence in Transition" (PRWP 2444, <http://www.worldbank.org/wbi/governance/>).

<sup>37</sup> Shih Mathisen, H. (2003) "Donor roles in face of endemic corruption – Albania in the policy debate", Bergen: Chr. Michelsen Institute (U4 Report)

<sup>38</sup> Shih Myrtaj F. (2003) "Albania: Temporary and permanent organized crime", në *Corruption and Organized Crime*, Alternative Information Network, I disponueshëm në <<http://www.southeasteurope.org>>

<sup>39</sup> Shih Veliqaj, E. (2004) "Hearing: advancing democracy in Albania", July 20<sup>th</sup>, 2004 - 334 Cannon House Office Building.

<sup>40</sup> Shih Myrtaj F. (2003) "Albania: Temporary and permanent organized crime", (Si shënimi 39)

<sup>41</sup> Shih Freedom House, (2004) "Albania", (Si shënimi 5)

<sup>42</sup> Shih Mathisen, H. (2003) "Donor roles in face of endemic corruption..." (Si shënimi 38)

<sup>43</sup> Shih Paldam, M. (2002) "The cross-country pattern of corruption: economics, culture and the seesaw dynamics", *European Journal of Political Economy* 18, fq.215–240, këtu fq.238

<sup>44</sup> Referencë Bratsis, P. (2003) *Corrupt Compared to What? Greece, Capitalist Interests, and the Specular Purity of the State*, Discussion Paper No. 8. The Hellenic Observatory of The European Institute. London School of Economics and Political Science, fq.9

## NË RRËNOJAT E NJË UTOPIE: PËRSE DËSHTOI ANTI-KORRUPSIONI SHQIPTAR

Blendi KAJSIU \*

**Abstrakt.** Argumenti parësor që do të parashtrohet në këtë punim është se arsyeja kryesore se përse fushatat anti-korrupsion dështojnë në Shqipëri është si pasojë e idesë së gabuar se korrupsioni është burim i mungesës së zhvillimit dhe demokracisë. Rrjedhimisht anti-korrupsioni në Shqipëri, edhe si pasojë e ndikimit dhe presionit të organizmave ndërkombëtare, është kthyer në një prioritet absolut me idenë se duke eliminuar korrupsionin i hapet rrugë zhvillimit dhe demokracisë. Ndërsa zhvillimi në vetvete është konceptuar sipas paradigmës neoliberale ku një shtet i vogël dhe eficient lehtëson funksionimin e një tregu të madh dhe kompetitiv. Në këtë artikull argumentohet se korrupsioni, pavarësisht formave në të cilat shfaqet, është pasojë direkte e mungesës së zhvillimit dhe jo shkak i tij. Në mungesë të zhvillimit eliminimi i korrupsionit është jo vetëm i pamundur, por përkundrazi fushatat anti-korrupsion mund të shërbejnë në shtimin dhe jo eliminimin e nivelit të korrupsionit për të paktën dy arsye. Së pari, anti-korrupsioni shpesh eliminon zhvillimin si prioritet, me idenë se zhvillimi do të pasojë eliminimin e korrupsionit. Së dyti, fushatat anti-korrupsion imponojnë një model të gabuar dhe të perealizueshëm zhvillimi të një shteti të vogël, indiferent dhe eficient përball një tregu të madh dhe konkurses. Edhe nëse diçka e tillë është e mundur praktikisht, një model i tillë mund të jetë pikëmbërritja, por jo pikënisja e zhvillimit.

### Hyrje

**P**rej kohësh korrupsioni është bërë një nga temat kyç të tranzicionit shqiptar. Ai është bashkëshoqërues i pothuajse të gjitha proceseve demokratizuese në Shqipëri, si dhe shqetësim konstant si i faktorit ndërkombëtar ashtu edhe atij lokal. Korrupsioni është bërë ndoshta tipari më dallues i sistemit politik shqiptar si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në nivelin lokal politikanë të të dyja krahëve si dhe qytetarë të të gjitha ngjyrave ankohen dhe vazhdimisht denoncojnë korrupsionin. Në nivelin ndërkombëtar një sërë institucionesh si Banka Botërore dhe organizma si Bashkimi Evropian jo vetëm ofrojnë asistencë në fushën e anti-korrupsionit, por edhe i bëjnë thirrje vazhdimisht qeverisë shqiptare të luftojë korrupsionin.

\* Blendi Kajsiu është pedagog në Universitetin Europian të Tiranës (UET) si dhe doktorant dhe asistent pedagog në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Esekstit, në Britaninë e Madhe. Ai është diplomuar në Ekonomi dhe në Shkenca Politike nga Universiteti Amerikan në Bullgari (AUBG). Më pas ka kryer një Master në Studimet Ndërkombëtare të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin Notre Dame, SHBA, si dhe një Master në Analizën e Ideologjisë dhe Diskurit nga Universiteti i Esekstit, në Britaninë e Madhe.

Si pasojë e presionit të jashtëm dhe atij të brendshëm qeveritë shqiptare kanë ndërmarrë një sërë nismash anti-korrupsion, veçanërisht duke filluar nga viti 1998 kur me financimin dhe inkurajimin e Bankës Botërore u krye edhe sondazhi i parë në lidhje me korrupsionin. Në nivelin qeveritar janë prodhuar ligje për informimin, transparencën dhe konfliktin e interesave, komisione ndërministrare, task force, grupe pune pranë kryemnistrit, kontrole të brendshme dhe të jashtëme për administratën dhe kështu pafund. Po kështu në sferën e shoqërisë civile edhe me ndihmën dhe financimin e donatorëve të huaj janë ndërmarrë një sërë fushatash anti-korrupsion. Në vitin 2001 me financimin e USAID-it u ngrit Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit, një ombrellë e madhe organizatash që si qëllim të përbashkët kishin luftën anti-korrupsion. Për të paktën dhjetë vitë, nga viti 1998 – 2008, janë ndërmarrë fushata, janë hartuar dhe miratuar ligje, janë ndërtuar një sërë institucionesh anti-korrupsion dhe është bërë një luftë e pandërprerë kundër korrupsionit.

E megjithatë pas dhjetë vitesh luftë të hapur kundër korrupsionit, sot në vitin 2008, mund të thuhet se lufta është humbur. Qeveria aktuale erdhi në pushtet në vitin 2005 me premtimin se do të çrrënjosë korrupsionin. Megjithatë fillimisht pati disa arritje, sot qeveria aktuale nuk gëzon aspak besimin e qytetarëve në luftën anti-korrupsion, të cilët mendojnë se korrupsioni është rritur dhe nuk ka rënë. Sipas sondazhit më të fundit të IDRA-s, 57% e të intervistuarve në vitin 2008, krahasuar me 53% në vitin 2005, mendojnë se korrupsioni mes zyrtarëve publik është shumë i përhapur. Kjo shifër është më e vogël se ajo e vitit 2005 kur 66% e të intervistuarve kishin këtë opinion.<sup>1</sup> Pra ajo tregon se pas një përmirësimi të ndjeshëm nga viti 2005 në vitin 2006 ka një përkeqësim gradual në nivelet e korrupsionit nga viti 2006 në vitin 2008.<sup>2</sup> Kjo reflektohet edhe tek vlerësimet e *Freedom House* në lidhje me korrupsionin, që tregon një përmirësim të lehtë nga viti 2005 në vitin 2006 (shifrat në tabelë i referohen vitit paraardhës).

**Tabela 1. Vlerësimi i *Freedom House* për korrupsionin në Shqipëri<sup>3</sup>**

Viti	1997	1998	1999	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Niveli Korrupsionit	N/A	N/A	6.00	5.50	5.25	5.00	5.25	5.25	5.25	5.00

Megjithatë sikurse tregon qartë edhe tabela e mësipërme, pas një rënie të ndjeshme të korrupsionit nga viti 1998 në vitin 1999 niveli i korrupsionit më pas në Shqipëri ka mbetur pak a shumë në të njëjtat nivele të larta. Po të kemi parasysh se fushata anti-korrupsion fillon në vitin 1998 dhe arrin kulmin e saj në periudhën 2001 – 2005, vërejmë se një fushatë e tillë ka qenë pak e suksesshme. Në këtë periudhë korrupsioni ka mbetur në të njëjtat nivele pas një përmirësimi të lehtë fillestar. Sikurse vëren edhe Banka Botërore në këtë periudhë Shqipëria "ka kryer shumë reforma dhe ka ndërtuar disa nga institucionet publike më të mira në rajon. Megjithatë nga pikëpamja e firmave private nivelet e korrupsionit për periudhën 2002 – 2005 [ishin] të pandryshuara ose të përkeqësuar".<sup>4</sup> Është pak a shumë e njëjta panoramë që po shohim të ravijëzohet sot, kur pas një përmirësimi të lehtë nga viti 2005 në vitin 2006, nivelet e korrupsionit apo perceptimi i publikut në lidhje me nivelin e korrupsionit është në rritje pas vitit 2006.

Natyrisht pyetja që shtrohet në këto kushte është përse ndodh diçka e tillë? Përse pavarësisht luftës anti-korrupsion, korrupsioni në Shqipëri ose nuk ulet ose rritet? E thënë ndryshe shqetësim kryesor mbeten arsytet përse anti-korrupsioni në Shqipëri nuk ka pasur sukses. Ky artikull synon t'i japë përgjigje pikërisht këtij shqetësimi. Qëllimi i tij kryesor është të shpjegojë përse antikorrupsioni vazhdimisht dështon në Shqipëri, edhe atëherë kur nuk mungon vullneti politik. Është e vështirë të mohosh faktin që qeveria që erdhi në pushtet në vitin 2005 dhe lideri saj kishin një vullnet të qartë politik anti-korrupsion, e megjithatë fushata anti-korrupsion e qeverisë dështoi.

Argumenti kryesor që do të parashtrohet në këtë punim është se arsyeja kryesore se përse fushatat anti-korrupsion dështojnë në Shqipëri është si pasojë e idesë së gabuar se korrupsioni është burim i mungesës së zhvillimit dhe demokracisë. Rrjedhimisht anti-korrupsioni në Shqipëri edhe si pasojë e ndikimit dhe presionit të organizmave ndërkombëtare është kthyer në një prioritet absolut me idenë se duke eliminuar korrupsionin i hapet rrugë zhvillimit dhe demokracisë. Ndërsa zhvillimi në vetvete është konceptuar sipas paradigmës neoliberale ku një shtet i vogël dhe eficient lehtëson funksionimin e një tregu të madh dhe kompetitiv.

Në këtë artikull argumentohet se korrupsioni, pavarësisht formave në të cilat shfaqet, është pasojë direkte e mungesës së zhvillimit dhe jo shkak i tij. Në mungesë të zhvillimit eliminimi i korrupsionit është jo vetëm i pamundur, por përkundrazi fushatat anti-korrupsion mund të shërbejnë në shtimin dhe jo eliminimin e nivelit të korrupsionit për të paktën dy arsye. Së par, i anti-korrupsioni shpesh eliminon zhvillimin si prioritet, me idenë se zhvillimi do të pasojë eliminimin e korrupsionit. Së dyti, fushatat anti-korrupsion imponojnë një model të gabuar dhe të parealizueshëm zhvillimi të një shteti të vogël, indiferent dhe eficient përball një tregu të madh dhe konkurrues. Edhe nëse diçka e tillë është e mundur praktikisht, një model i tillë mund të jetë pikëmbërritja, por jo pikënisja e zhvillimit.

Për të argumentuar diçka të tillë ky artikull do të ndahet në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë do të parashtrohet një historik i shkurtër i konceptit të korrupsionit për të treguar se si korrupsioni është transformuar nga pasojë në shkak të moszhvillimit. Në pjesën e dytë do të parashtrohet mënyra sesi korrupsioni përdoret për të implementuar një model të caktuar neoliberal zhvillimi. Për këtë qëllim do të përqendrohemi tek mënyra se si korrupsioni përdoret nga Banka Botërore. Në pjesën e tretë do të argumentohet se përse ky model është jo i saktë dhe se përse anti-korrupsioni pengon zhvillimin duke prodhuar më shumë dhe jo më pak korrupsion, gjithmonë duke u fokusuar tek rasti i Shqipërisë.

### **Transformimi i korrupsionit: korrupsioni nga pasojë në shkak**

Korrupsioni ka qenë një shqetësim i hershëm në literaturën politike të paktën që nga koha e antikitetit grek, por edhe më herët. Megjithatë shqetësimi modern me korrupsionin në shkencat politike fillon në vitet 1950-të bashkë edhe me procesin e dekolonizimit të shumë vendeve të Botës së Tretë.<sup>5</sup> Fillimisht kërkuesit e panë korrupsionin si një "devijim imoral nga sjellja normale me pasoja përkeqësuese në një sërë aktivitetesh politike dhe ekonomike."<sup>6</sup> Korrupsioni në këtë periudhë shikohej si një nga pengesat në rrugën për modernizim të Botës së Tretë. Ndonëse ai konsiderohej si një pengesë në zhvillimin politik dhe ekonomik, mbi të gjitha korrupsioni shihej si një problem moral.<sup>7</sup> Pra në thelb korrupsioni nuk ishte

një problem sistematik, por një problem i degradimit moral. Pikërisht për këtë arsye qasja e kësaj periudhe ndaj korrupsionit u quajt qasja moraliste.

Kjo qasje u kritikua sepse injoronte kontekstin social dhe ekonomik në të cilin korrupsioni zhvillohej si fenomen, si dhe për mungesën e të dhënave empirike.<sup>8</sup> Në kritikën e tyre ndaj qasjes moraliste shumë kërkues argumentonin se në vend të gjykimit të korrupsionit si një fenomen moral duhet që të shyrtohet mënyra se si "korrupsioni kontribuon në mbajtjen dhe balancimin e cilitdo sistem social, politik apo administrativ që është zgjedhur për tu studiuar."<sup>9</sup> Theksi, pra, u zhvendos nga gjykimi normativ i korrupsionit tek analizimi i funksionit që korrupsioni kryen në shoqëri. Pra, shqyrtimi i korrupsionit filloi tashmë të dominohej nga qasja funksionaliste. Në qasjen funksionaliste korrupsioni filloi të shihej në një dritë më pozitive sesa në qasjen moraliste. Sipas funksionalistëve korrupsioni ishte pozitiv pasi forconte tregun "duke zgjeruar mundësitë ekonomike, duke tërhequr investitorët e huaj dhe duke forcuar sektorin privat përballë atij publik".<sup>10</sup> Gjithashtu korrupsioni inkurajonte institucionalizimin dhe forcimin e partive politike pasi forconte partitë politike përballë një burokracie që pëmdryshe do të pengonte formësimin e lidërshpilit politik.<sup>11</sup> Së fundi, për funksionalistët korrupsioni ishte pozitiv edhe sepse krijonte më shumë akses për qytetarët tek burokracia duke mundësuar kështu edhe integrimin e grupeve të skajuar (margjinalizuara).<sup>12</sup>

Qasja funksionaliste filloi të kritikohet ashpër me shfaqjen e korrupsionit në vendet e zhvilluara perëndimore, veçanërisht gjatë viteve 1970-të. Fakti që korrupsioni plasi në perëndimin e zhvilluar hidhte poshtë idenë funksionaliste se korrupsioni ishte një fenomen kalimtar që ndihmonte procesin e modernizimit dhe zhdukej bashkë me konsolidimin e zhvillimit dhe të modernizimit. Për pasojë një qasje e re filloi të dominonte analizën e korrupsionit, një qasje sipas së cilës korrupsioni duhej parë si një variant i zgjedhjes ekonomike (economic choice).<sup>13</sup> E njëjta logjikë ekonomike që përdorej për të shpjeguar funksionimin e tregut dhe të çmimeve u vu në zbatim për të shpjeguar edhe korrupsionin. Kështu korrupsioni qeveritar filloi të shikohej si procesi në të cilin "zyrtarët e qeverisë shesin pronën qeveritare për interesa personale."<sup>14</sup> Ashtu sikurse një operator i zakonshëm në treg edhe zyrtarët publik shikohen si individë që synojnë maksimizimin e të ardhurave nga pozicioni i tij/saj në administratë, duke peshuar nga njëra anë koston e përfshirjes në korrupsion dhe nga ana tjetër përfitimet. Për këtë arsye sipas Klitgaard-it korrupsioni rritet sa më shumë që zyrtarët kanë një pozicion monopol me shumë hapësirë vendimmarrje dhe me pak mbikëqyrje. Në këto kushte një nënpunës civil mund të maksimizojë lehtë sasinë e rryshfetit që merr.<sup>15</sup> Pra, në thelb sipas kësaj qasje korrupsioni ka të bëjë me deformimin e tregut. Nga njëra anë korrupsioni buron nga deformimi i tregut si pasojë e pozicionit monopolist të shtetit në treg. Nga ana tjetër, korrupsioni me përfitimin që prodhon për punonjësit publik përbën një arsye se përse ata i mbajnë dhe i riprodhojnë deformimet që prodhojnë korrupsionin. Kjo qasje ndaj korrupsionit quhet 'perspektiva e tregut mbi korrupsionin'.

Në këtë pikë është e nevojshme që të ndalemi për një çast për të parë se si perspektiva e tregut ndryshon nga qasja funksionaliste rreth korrupsionit. Sikurse pamë, qasja funksionaliste argumentonte se në disa fusha të ekonomisë korrupsioni është i dobishëm pasi shkurton burokracitë, stimulon akumulimin e kapitalit dhe investimin.<sup>16</sup> Perspektiva e tregut e hodhi poshtë këtë arsyetim duke argumentuar se punonjësit publik kanë interes që të prodhojnë burokracira nga ku përfitojnë nëpërmjet korrupsionit. Pra, korrupsioni nuk i eliminon, por është burim i burokracive. "Kështu, ndërhyrja arbitrare në

ekonomi, ... ngadalësimi i procedurave burokratike ... pjesërisht duhen parë si sajesa të elitave të korruptuara."<sup>17</sup> Në këtë rast, ndryshe nga qasja funksionaliste, ku korrupsioni ishte pasojë e një burokracie ineficente, në perspektivën e tregut korrupsioni nuk është thjesht pasojë, por edhe burim i ineficencës së burokracisë. Nëpërmjet ineficencës apo zvarritjeve nëpunësit civil përfitojnë ryshfete. Për pasojë korrupsioni është një presion që shteti ushtron ndaj individit apo grupeve të caktuara. Kjo është e kundërta e logjikës funksionaliste ku, sikurse argumentonte Huntington-i, korrupsioni "është një mënyrë alternative nëpërmjet të cilës individët realizojnë kërkesat e tyre ndaj sistemit."<sup>18</sup>

Pra, në perspektivën e tregut korrupsioni është një fenomen tejet negativ. Ai shkakton mungesën e zhvillimit dhe të efikasitetit. Korrupsioni jo vetëm që nuk shërben në integrimin e grupeve të marginalizuara, por përkundrazi prodhon marginalizim, gjithmonë sipas perspektivës së tregut. Kështu duke përdorur një analizë kosto – përfitim, Shahid Alam-i arrin në konkluzionin se "korrupsioni ekziston për të pasuruar një elitë dominuese."<sup>19</sup> Në fakt në vitet 1980 një sërë autorësh kishin arritur në konkluzionin se përfitimi nga korrupsioni tenton të mbetet brenda grupeve hegjemonike duke lënë jashtë popullatën në përgjithësi.<sup>20</sup> Me fjalë të tjera, në perspektivën e tregut, ndryshe nga qasja funksionaliste, korrupsioni kritikohet jo thjesht si pasojë, por edhe si shkak i mungesës së zhvillimit.

Ndonëse në vitet 1980 perspektiva e tregut filloi të dominonte literaturën rreth korrupsionit, ajo kishte një të metë të madhe: mungesën e të dhënave empirike. Konkluzionet e perspektivës së tregut nuk buronin nga të dhëna empirike, por ishin thjesht deduktime logjike nisur nga një model i caktuar i vendimmarrjes racionale mbi të cilën bazohet edhe analiza ekonomike neoliberales. Në fakt edhe në vitin 2000 disa kërkues vërejnë se: "gjëja e parë që të bie në sy rreth literaturës empirike mbi korrupsionin është se ajo është shumë e vogël sesa literatura teorike."<sup>21</sup> Megjithatë pati një rritje të literaturës empirike kur korrupsioni filloi të bëhej një shqetësim qëndror në politikë, veçanërisht pas rënies së komunizmit. Perspektiva e tregut mbi korrupsionin, e cila kritikonte ndërhyrjen e shtetit në treg, ishte mjaft relevante për vendet e ish bllokut komunist ku shteti kishte pasur një ndërhyrje të ekzagjeruar në ekonomi dhe shoqëri. Pasi utopia neoliberales nuk prodhoi mrekullinë që pritej nga terapitë e shokut dhe privatizimet e thella, një vëmendje gjithnjë e më e madhe filloi t'i kushtohej korrupsionit për të shpjeguar mungesën e mrekullisë së tregut. Kjo ishte e lehtë pasi rekomandimet që dilnin nga perspektiva e tregut për luftën anti-korrupsion theksonin domosdoshmërinë e derregullimit, turrjen e shtetit dhe funksionimin e tregut. Pra, ato ishin pak a shumë të njëjta me politikën zhvillimore neoliberales. Në këtë mënyrë lufta anti-korrupsion u bë sinonim me zhvillimin ekonomik. Për pasojë institucione të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e zhvillimit, si Banka Botërore, FMN, OECD apo OBT, filluan të financojnë raporte dhe studime empirike rreth korrupsionit mbi të cilat ato do të ngrinin politikën e tyre zhvillimore.<sup>22</sup>

Në këtë pikë ndodh një tjetër transformim me shumë sasi sesa cilësor i korrupsionit. Tashmë korrupsioni bëhet një fenomen i matshëm, çka vetëm një dekadë më parë konsiderohej diçka e pamundur për të paktën dy arsye. Së pari, sepse korrupsioni ishte një aktivitet i fshehtë dhe për pasojë nuk mund të zbulohej dot kurrë tërësisht dhe të matej. Së dyti, akoma më i rëndësishëm ishte fakti se nuk ekzistonte një përkufizim i gjithëpranuar në lidhje me korrupsionin. Ekzistonin po aq perspektiva rreth korrupsionit sa edhe kërkues apo qasje të ndryshme, prandaj matja e korrupsionit presupozonte paraprakisht një përkufizim që parashtronte qartë se çfarë është korrupsioni në mënyrë që ai më pas të matej. Megjithatë

empiricistët iu futën punës për matjen e korrupsionit edhe pse “çështja e përkufizimit nuk është zgjidhur më shumë sesa është anashkaluar – me të drejtë në shumicën e rasteve – për tu përqendruar në ato procese që cilësohen si të korruptuara në çdo përkufizim.”<sup>23</sup> Praktikisht kjo prodhoi një reduktim të korrupsionit tek fenomeni i ryshfetit që është sa i matshëm po aq edhe i pranueshëm gjerësisht si korrupsion. Kjo është mëse e qartë në studimin e parë empirik që mat korrupsionin në vitin 1995 nga Paolo Mauro. Në studimin e tij Mauro e përkufizon korrupsionin si pagesat e dyshimta që përfshihen në transaksionet e bizneseve.<sup>24</sup> Në përfundim të studimit të tij Mauro arrin në konkluzionin empirik se korrupsioni shoqërohet me ulje në investimes dhe rritje ekonomike.<sup>25</sup>

Ky në fakt është edhe kontributi themelor i qasjes empirike rreth korrupsionit. Ajo ‘provon’ empirikisht atë që perspektiva e tregut e vërtetoi logjikisht: korrupsioni është burim i mungesës së zhvillimit. Themi ‘provon’ pasi qasjet empirike nuk vërtetojnë shkakësinë, por tregojnë vetëm korrelacionin mes variablave, çka do të thotë se është po aq e mundur që mungesa e zhvillimit prodhon korrupsion sa dhe anasjelltas. Megjithatë në literaturën empirike shumë shpejt korrupsioni filloi të trajtohej si shkak i mungesës së zhvillimit. Kështu nga njëra anë korrupsioni buronte nga ndëryrja e shtetit në treg dhe nga vetë pozicioni monopolist i shtetit në ekonomi. Nga ana tjetër korrupsioni shkaktonte mungesë zhvillimi. Me fjalë të tjera, për të eliminuar korrupsionin dhe për të çliruar zhvillimin duhej reduktuar dhe forcuar shteti në funksion të zgjerimit të tregut. Pikërisht në këtë pikë lufta kundër korrupsionit fillon të përqafohet nga organizmat kryesorë të zhvillimit si Banka Botërore.

### **Banka Botërore dhe korrupsioni**

Së pari, duhet theksuar se përdorimi i korrupsionit dhe anti-korrupsionit nga Banka Botërore ka një rëndësi të veçantë për të kuptuar fenomenin e korrupsionit dhe anti-korrupsionit në Shqipëri për dy arsye. Së pari, Banka Botërore është insitucioni më i rëndësishëm ndërkombëtar në lidhje me politikën e zhvillimit dhe që ka prodhuar edhe literaturën më të gjerë dhe popullore, ndonëse jo më cilësore, në lidhje me korrupsionin dhe zhvillimin. Mbi kërkimet, konceptet dhe politikën e Bankës Botërore bazohen strategjitë e shumë qeverive të vendeve në zhvillim si Shqipëria. Së dyti, Banka Botërore ishte iniciatorja e sondazhit të parë rreth korrupsionit që u zhvillua në Shqipëri në vitin 1998. Ajo është një nga organizatat pionere në udhëheqjen e së cilës qeveritë dhe partitë politike shqiptare kanë brendësuar ligjërimin rreth korrupsionit dhe kanë ndërtuar strategjitë anti-korrupsion. Prandaj duke kuptuar konceptimin dhe përdorimin e korrupsionit nga Banka Botërore në fakt ne shikojmë se si janë konceptuar edhe fushatat anti-korrupsion në Shqipëri, nga ku mund të kuptojmë më pas edhe përse ato kanë dështuar me kaq sukses.

#### *Korrupsioni si shkak*

Banka Botërore bazohet tek një konceptim i dyfishtë i korrupsionit herë si shkak dhe herë si pasojë. Banka Botërore (BB) e shikon korrupsionin si shkak të mungesës së zhvillimit, të pabarazisë, të margjinalizimit dhe të pothuajse çdo problemi me të cilin përballen vendet në zhvillim. Sipas BB-së, nivelet e larta të korrupsionit janë barrierë për “investimet, ngadalësojnë rritjen ekonomike dhe pengojnë përpjekjet për reduktimin e varfërisë.”<sup>26</sup> Për

më tepër korrupsioni prodhon edhe pabarazi sociale dhe varfëri pasi transferon të ardhurat "nga të varfërit tek të pasurit, rrit koston e bërjes së biznesit, deformon investimet publike dhe për pasojë pengon investimet e huaja."<sup>27</sup> Kjo në fakt është logjika standarde që dominon sot edhe në Shqipëri në raport me pasojat që ka korrupsioni. Të gjitha palët politike akuzojnë qeveritë në pushtet për vjedhje, abuzim dhe deformim të fondeve publike, për presionin që i ushtrojnë biznesit privat duke i marrë parà dhe duke e varfëruar atë dhe Shqipërinë në përgjithësi. Nga kjo pikëpamje korrupsioni si në nivel mikro ashtu edhe në nivel makro është burimi themelor i mungesës së zhvillimit, deformimit të qeverisjes dhe mungesës së investimeve të huaja.

Në dimensionin e tij si shkak korrupsioni është një kategori sa e mjegullt aq edhe e papërcaktuar. Korrupsioni si shkak shikohet si burim i pothuajse çdo dështimi politik, ekonomik dhe social. Ai kthehet në një kategori që zgjerohet vazhdimisht duke përfshirë jo vetëm ryshfetin që merr nëpunësi civil, por edhe abuzimin me pushtetin, mashtrimin elektoral apo keq-qeverisjen. Sikurse e përmbledh një aktivist anti-korrupsion i Bankës Botërore:

Kur flas për korrupsionin e kam fjalën për keqmenaxhimin, paaftësinë, abuzimin me postin, mosbërja e gjërave siç duhet dhe në mënyrë korrekte, mungesa e drejtësisë ...- dhe kjo është e vetmja diferencë mes vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim.<sup>28</sup>

Sikurse tregon qartë edhe përmbledhja e mësipërme në dimensionin e tij si shkak, korrupsioni është pothuajse çdofarë dështimi. Në këtë pikë korrupsioni del jashtë përkufizimit tradicional si 'përdorim i postit publik për interesa personale' pasi ai përfshin edhe dështime të paqëllimshme që mund të burojnë nga keqmenaxhimi apo paaftësia.

### *Korrupsioni si pasojë*

Ndërsa korrupsioni si shkak konceptohet mjaft gjerë dhe mjegullt, korrupsioni si pasojë lidhet më qartë dhe fort me perspektivën e tregut. Sipas kësaj perspektive korrupsioni buron natyrshëm nga pozicioni monopolist i shtetit në ekonomi, çka prodhon edhe renta ekonomike (*economic rents*).<sup>29</sup> E thënë thjesht, nëpunësit civil shfrytëzojnë pozicionin e tyre monopol në dhënien e licencave, thithjen e taksave, vënien e gjobave apo ofrimin e shërbimeve dhe në mungesë të kontrollit dhe penalizimit marrin ryshfete nga klientët, qofshin këta qytetarë apo biznese. Pra, korrupsioni është pasojë direkte e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi dhe shoqëri. Për pasojë hapi i parë në eliminimin e korrupsionit është reduktimi i shtetit dhe kufizimi më i madh i mundshëm i kompetencave të tij. Pra, implementimi i një shteti neoliberal. Kjo del qartë edhe tek politikat bazë ekonomike që Banka Botërore rekomandon për eliminimin e korrupsionit. Këto janë politika që synojnë "thjeshtëzimin e rregullave, eliminimin e pushteteve monopol, reduktimin e hapësirës vendimmarrëse të zyrtarëve."<sup>30</sup> Këto janë gjithashtu politika që synojnë "uljen e kontrollit mbi tregtinë e jashtme, eliminimin e pengesave për futjen në treg të industrisë private, dhe privatizimin e firmave shtetërore në mënyrë që të krijohet konkurrencë".<sup>31</sup> Këto janë pak a shumë edhe një sërë politikash që janë ndjekur nga qeveritë shqiptare dje dhe sot. Dje u kryen privatizimet kryesore në ekonominë shqiptare, sot qeveria Berisha ka implementuar masa të tipit 'one stop shop' që



redukojnë burokracinë dhe për pasojë korrupsionin. Në këtë aspekt korrupsioni është pasojë e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

Megjithatë kjo nuk do të thotë që për Bankën Botërore thjesht reduktimi i shtetit mjafton për të luftuar korrupsionin. Megjithëse kjo ndodhi në fillim të viteve 1990, korrupsioni jo vetëm që nuk u reduktua, por edhe u rrit. Për këtë arsye politikat e BB-së u pasuruan me një theksim të ri të forcimit dhe ndërtimit të institucioneve nëpërmjet të cilave do të mund të implementohet modeli neoliberal. Rëndësia primare e tregut mbetet, ndërsa roli i shtetit është "esencial për të garantuar institucionet bazë të tregut".<sup>32</sup> Për të luftuar korrupsionin nuk mjafton vetëm zgjerimi i tregut dhe zvogëlimi i shtetit, natyrisht që kjo është e nevojshme, por duhet edhe që shteti të funksionojë mirë, të garantojë zbatimin e kontratave, të ligjeve dhe mirëfunksionimin e gjyqësorit.<sup>33</sup> Kjo për faktin e thjeshtë se disa funksione bazë të shtetit si policia apo gjyqësori nuk mund të eliminohen nëpërmjet tregut, prandaj ato duhet të funksionojnë mirë në mënyrë që të eliminohen korrupsionin.

Funksionimi i mirë në këtë rast do të thotë kontrollim dhe penalizim i zyrtarëve të korruptuar. Penalizimi rrit koston e përfshirjes në korrupsion, pasi sipas perspektivës së tregut që bazohet tek qasja e vendimmarrjes racionale individit përfshihet në korrupsion kur kosto është me e ulët sesa përfitimi. Funksionimi i institucioneve si policia dhe gjyqësori do të thotë që kosto e përfshirjes në korrupsion rritet dhe për pasojë korrupsioni ulet. Sipas kësaj logjike institucionet ndërkombëtare si BB-ja apo organizma si BE-ja i bëjnë vazhdimisht thirrje Shqipërisë të dënojë zyrtarët e korruptuar apo tërheqin vëmendjen se korrupsioni nuk po dënohet. Ideja është se mungesa e dënimeve për korrupsionin reflekton luftën e dobët ndaj korrupsionit më shumë sesa mirëfunksionimin e gjyqësorit, që dënimet i jep mbi fakte dhe jo thejsh mbi akuza.

Duke parë këto dy dimensionet të konceptit të korrupsionit të Bankës Botërore, mund të themi se në vetvete korrupsioni është distanca mes utopisë neoliberale në teori dhe materializmit të saj në praktikë. Nëse utopia neoliberale do të realizohej tërësisht, atëherë do të kishim një shtet të vogël, por të fortë dhe eficient, një treg të madh dhe funksional, një sistem politik kompetitiv dhe transparent si dhe një shoqëri civile aktive dhe që ushtron presion pozitiv mbi sistemin politik. Nëse një model i tillë do të realizohej në praktikë atëherë nuk do të kishte aspak korrupsion. Në fakt korrupsioni është distanca mes realitetit shqiptar dhe utopisë neoliberale. Në realitet ne kemi një shtet jo dhe aq të vogël, aspak eficient, një shoqëri civile të dobët dhe një sistem politik jo transparent dhe jo kompetitiv. Për pasojë Shqipëria është një vend me shumë korrupsion. Prandaj edhe anti-korrupsioni synon në tërësinë e tij implementimin e utopisë neoliberale. Anti-korrupsion do të thotë një shtet i vogël, një administratë e reduktuar dhe meritokratike, një sistem funksional drejtësie, eliminimin e klientelizmit politik dhe ekonomik.

Edhe nëse pranojmë se diçka e tillë është e mundshme në parim, përsëri kjo utopi mbetet një stacion ku duhet mbërritur, por kurrësesi një pikënisje. Pikërisht këtu duhet kërkuar edhe dështimi i anti-korrupsionit në Shqipëri. Ai nisët nga implementimi i një utopie neoliberale, e cila është e pamundur për kushtet ku ndodhet Shqipëria sot. Duke synuar të paarritshmen anti-korrupsioni nuk realizon as të bëshmen. Një histori e përsëritur kjo që nga koha kur Shqipëria synonte materializmin e utopisë komuniste. Le të shohim konkretisht se përse anti-korrupsioni shqiptar dështon në realizimin e utopisë neoliberale.

## Utopia neoliberale dhe dështimi i anti-korrupsionit shqiptar

Në përputhje me modelin e Bankës Botërore dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtar anti-korrupsioni në Shqipëri më shumë sesa thjesht një luftë kundër korrupsionit është program politik që synon realizimin e modelit neoliberal në tërësinë e tij. Një shtet i vogël dhe efikas, një administratë publike meritokratike, një sistem gjyqësor funksional që dënon zyrtarët e korruptuar, një sistem politik të pakapur nga konflikti i interesave, janë të gjitha pjesë e strategjisë anti-korrupsion. Të gjitha këto masa së bashku nëse do të implementoheshin saktë do të eliminonin jo vetëm korrupsionin, por do të ravigëzonin situatën ideale të një modeli neoliberal për shtetin dhe shoqërinë. Të gjitha këto masa të marra së bashku premtojnë eliminimin e korrupsionit çka do të çlironte edhe energji zhvilluese të tregut dhe modelit liberal në përgjithësi.

Dy janë problemet themelore me këtë paradigmë. Së pari, ajo bazohet tek premisa e gabuar se korrupsioni është burimi i mungesës së zhvillimit dhe jo pasojë e saj. Sikurse do të argumentojmë më poshtë korrupsioni është pasojë e mungesës së zhvillimit apo e një procesi të deformuar zhvillues dhe jo thjesht burim i saj. Së dyti, kjo paradigmë presupozon ekzistencën paraprake të kapaciteteve financiare dhe administrative që janë të nevojshme për implementimin e saj. Ndërkohë, sikurse do të argumentojmë më poshtë, këto kapacitete dhe financa jo vetëm mungojnë, por ato edhe rrezikohen nga lufta anti-korrupsion. Shpesh anti-korrupsioni thith burime financiare dhe administrative që duhet t'i dedikoheshin procesit të zhvillimit, duke riprodhuar kështu vetë burimin e korrupsionit, mungesën e zhvillimit. Le t'i shikojmë këto dy momente më konkretisht.

### *Korrupsioni si pasojë e mungesës dhe deformimit të zhvillimit*

Nën udhëheqjen e FMN-së qeverisja në Shqipëri është fokusuar tërësisht tek stabiliteti makro-ekonomik dhe disiplina fiskale. I gjithë modeli ynë i zhvillimit bazohet tek utopia neoliberale e Bankës Botërore dhe FMN-së se sapo të zvogëlohet dhe forcohet shteti, tregu do fuqizohet dhe ne do shpëtojmë nga korrupsioni dhe nga varfëria. Paradigma aktuale e zhvillimit bazohet në idenë naive se biznesi shqiptar do të shpërthejë sapo t'i hiqet qafe shteti. Edhe pse gjithë eksperiencia e historive të suksesit, si Tigrat e Azisë, ka treguar se biznesi është zhvilluar me ndihmën e shtetit dhe jo nëpërmjet indiferencës së tij. Eksperiencia zhvillimore e vendeve më të suksesshme të Azisë Jugore ka treguar se ndonëse këto vende kanë shkuar drejt modelit neoliberal ky model nuk ka qenë aspak pikënisja e tyre.<sup>34</sup> Në këto vende shteti ka pasur politika të qarta jo vetëm protektive, por edhe klienteliste për promovimin e sektorëve të caktuar industrial, që sipas paradigmës aktuale anti-korrupsion dotë quheshin korruptive.\*\*

\*\* Diçka të tillë ne e kemi parë fare mirë edhe në rastin e Shqipërisë. Media dhe ndoshta biznesi më i suksesshëm në Shqipëri sot është Top Media Grup. Ama të gjithë e dimë se ky grup fillimisht u favorizua shumë nga shteti duke përfutur ambiente shtetërore tek piramida. Padyshim që ky favor e lehtësoi suksesin e këtij grupi mediatik. Natyrisht dikush mund të ankohet se kjo u bë me të padrejtë, se ky ishte favorizim, etj. Ama fakti mbetet që edhe me ndihmën e shteti ne sot kemi një grup të fuqishëm mediatik që ka pasuruar shumë skenën mediatike, dhe ka kontribut të jashtëzakonshëm në formësimin e hapësirës publike dhe kombëtare. Fakti që shteti ka mbështetur një ndërmarrje të tillë më shumë sesa turp duhet të ishte krenari. Ama në kuadrin e luftës anti-korrupsion diçka e tillë është e pakonceptueshme.

Në këtë mënyrë shteti ka luajtur një rol parësor edhe në menaxhimin e zhvillimit dhe në përbalimin e polarizimit dhe kostove sociale që shoqërohen me të. Pra, roli i shtetit nuk ka qenë aspak në përputhje me modelin aktual neoliberal që promovohet në Shqipëri, ku roli i shtetit është konsolidimi i indiferencës 'pozitive' si ndaj shtresave në nevojë, ashtu edhe ndaj kapitalit apo biznesit vendas, me përjashtim të ndonjë lidhje tejet të shkurtër. Prandaj sot për sot qeverisja në Shqipëri nuk ka pothuajse asnjë rol në politikën zhvillimore, dhe aq më pak në ato rishpërndarëse dhe integruese. Ajo kufizohet tek forcimi i shtetit të vogël që pret një mrekulli nga tregu i madh. Në këto kushte pabarazia në Shqipëri është gjithnjë e më rritje si në aspektin social edhe në atë gjeografik. Një pjesë gjithnjë e më e vogël e popullatës dhe territorit po pasurohet, ndërsa një pjesë gjithnjë e më e madhe e territorit dhe popullatës po varfërohet.

Pikërisht këtu zë rrënjë korrupsioni. Korrupsioni në formën e ryshfetit luan një rol rishpërndarës të të ardhurave. Nuk është rastësi që niveli më i lartë i korrupsionit apo i ryshfetit është në sektorë të tillë si doganat, tatimet apo policia rrugore dhe gjithashtu në këto sektorë është edhe niveli më i lartë i qarkullimit të personelit. Tabela 2 tregon përqindjet e individëve që kanë paguar ryshfet në këta sektorë për vitet 2000 dhe 2001 sipas një sondazhi të SELDI:

**Tabela 2: Përqindja e atyre që kanë dhënë ryshfet tek...**<sup>35</sup>

	2000	2001
Policia	52%	54%
Doganat	55%	56%
Tatimet	57%	50%

Sa herë ndërrohen partitë në pushtet ndërrohen edhe doganierët, tatimorët dhe policët rrugor. Në administratë futet 'gjak i ri', futen ato shtresa sociale që janë shpesh të marginalizuara, që vijnë nga zona të thella dhe që në mungesë të këtij rotacioni do ishin gjithnjë e më të varfëra dhe të paafta për të nxjerrë bukën e gojës në treg. Me fjalë të tjera, korrupsioni në formën e fenomenit të ryshfetit është një mekanizëm informal i rishpërndarjes së të ardhurave. Si çdo mekanizëm informal edhe ky është një mekanizëm jo perfekt. Shpesh si pasojë e korrupsionit disa individë akumulojnë pasuri të mëdha në kurriz të komunitetit. Megjithatë ne jemi fiksuar kaq shumë tek pasurimi i individëve apo grupeve të veçanta, sa që shpesh harrojmë të shohim sesa i përhapur është fenomeni i korrupsionit në çdo qelizë të shoqërisë sonë. Shpesh harrojmë gjithashtu se edhe korruptimi i politikanëve në raport me biznesin bëhet jo vetëm për interesat e ngushta personale, këto po e po, por edhe për të siguruar financim për grupimin e tij politik. Për më tepër kur fushatat politike janë gjithnjë e më të kushtueshme dhe vullnetarizmi politik pothuajse inekzistent.

Në mungesë të politikave të zhvillimit dhe rishpërndarëse e vetmja gjë që partitë politike mund t'i ofrojnë elektoratit dhe qytetarëve kur vijnë në pushtet është vetë shteti. Për pasojë shteti është një plaçkë politike që ndahet dhe rishpërndahet për të përmbushur nevojat e elektoratit përkatës. Kjo është edhe një nga arsytet se përse rotacioni në administratën publike është përgjithësisht mjaft i lartë. Tabela 3 tregon numrin e viteve në administratën qendrore shqiptare sipas një sondazhi të bërë nga Ministria e Integritimit në vitin 2007.


Tabela 3. Sa vite keni që punoni në Administratën Publike? <sup>36</sup>

Numri i viteve	Përqindja
Me pak se nje vit	15.5
1 - 2 vjet	12.3
2 - 5 vjet	25.0
5 - 10 vjet	25.9
Më shumë se 10 vjet	21.4

Sikurse tregon edhe tabela e mësipërme pothuajse 28% e të intervistuarve kishin më pak se dy vite punë në administratë, çka përkon edhe me ardhjen në pushtet të PD-së dy vjet para sesa të bëhej sondazhi në vitin 2005. Ndërsa vetëm 21% kanë më shumë sesa 10 vite punë në administratë. Këto shifra janë akoma më domethënëse po të kemi parasysh se administrata qendrore është shtuar së tepërmi pas rënies së komunizmit, me shtimin e një sërë ministrive, si ajo e drejtësisë apo e integritimit, dhe institucionesh të reja si Avokati i Popullit apo Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).


Shifrat mësipër tregojnë qartë se rotacioni i pushtetit shoqërohet edhe me zhvendosje thelbësore në administratë. Ky është edhe sistemi klientelist mbi të cilin bazohen partitë politike në Shqipëri. Në mungesë të një ideologjie mobilizuese ky sistem bëhet edhe më i domosdoshëm, pasi e vetmja mënyrë sesi partitë politike mund t'i mobilizojnë militantët është ose duke i paguar në fushatë ose duke i premtuar punësim nesër në pushtet. Dhe kur këta militantë punësohen nesër në shtet ata do duan të 'hanë', sidomos pasi rroga e shtetit është tejet e vogël dhe nevojat e tyre tejet të mëdha, sepse shpesh ata vijnë nga zona apo shtresa të marginalizuara. Partitë politike më shumë sesa një bashkim vullnetar rreth një ideje janë transformuar në një bashkim vullnetar rreth një përfitimi që është pushteti apo shteti.

Diçka e tillë del qartë edhe në një sondazh të zhvilluar me delegatët e dy partive kryesore, PS dhe PD, në kongreset përkatëse gjatë vitit 2005. Në momentin që është kryer ky sondazh Partia Socialiste kishte qenë në pushtet prej tetë vitesh. Kjo reflektohet qartë tek diferenca në të ardhura dhe në punësim midis delegatëve të PS-së dhe PD-së. Kështu tabela 4 tregon qartë se delegatët e PS-së kanë të ardhura më të larta sesa ata të PD-së.

Tabela 4. Paraqitja e të ardhurave të delegatëve të PS-së dhe PD-së<sup>37</sup>


Delegatët e PS-së ishin gjithashtu jo vetëm me përqindje më të lartë punësi, por edhe me përqindje më të ulët papunësie. Sikurse tregon tabela 5, 10% e delegatëve të PD-së ishin të papunë, ndërsa asnjë nga delegatët e PS-së nuk u deklarua i papunë.

Tabela 5. Paraqitja grafike e punësimit të delegatëve të PS-së dhe PD-së<sup>38</sup>



Së fundi, vlen për tu shënuar se jo vetëm që delegatët e PS-së ishin me më shumë të ardhura dhe më të punësuar sesa ata të PD-së, por shumica e tyre ishin të punësuar në sektorin publik ose në shtet. Sikurse tregon qartë tabela 6, nga delegatët e PS-së 69% ishin të punësuar në shtet përkundër 43% të delegatëve të PD-së.

Tabela 6. Paraqitja grafike e sektorit të punësimit të delegatëve të PS-së dhe PD-së<sup>39</sup>



Të dhënat e mësipërme flasin qartë për funksionin që kryejnë partitë politike si kanale nëpërmjet të cilave individët pasurojnë të ardhurat dhe punësohen, kryesisht në sektorin shtetëror. Do ishte interesante të shikohej se si kanë ndryshuar këto dinamika që nga viti 2005 tashmë që PD-ja ka mëse tre vite në pushtet.

Natyrisht ne dhe shumë ekspertë ndërkombëtarë tek blloku mund ta dënojmë një fenomen të tillë si diçka negative. Ama fakti mbetet që partitë politike janë ndoshta kanalet e vetme nëpërmjet të cilave shtesa, që ndryshe do ishin harruar, mund të përfitojnë status social dhe ekonomik. Sa më pak që ky rol luhet nga shteti i cili është në rrudhje e sipër, aq më shumë ai luhet nga partitë politike. Për shumë individë që nuk kanë lindur brenda unazës së Tiranës partitë politike duke përdorur shtetin bëhen kanale të karrierës dhe integritimit social. Jo rastësisht shumë nga militantët më të flaktë partiak vijnë nga zona periferike. Nuk është për tu çuditur pse më shumë sesa shtet në Shqipëri ne ndërtojmë parti-shtet.

Prandaj në kushtet aktuale është e pamundur për një parti politike të luftojë realisht korrupsionin. Eliminimi i korrupsionit do të thotë eliminimi i klientelizmit politik që në mungesë të një ideologjie organizuese mban partitë në këmbë dhe integron shtesa të ndryshme sociale në shoqëri. Në thelb korrupsioni është një sistem informal klientelist ku klanet apo individët shpërblehen sipas pozicionit që kanë në hierarkinë partiake. Një parti që do të dënonte të gjithë anëtarët e saj të përfshirë në korrupsion, nepotizëm apo favorizim do mbetej pa kryetar, pa kryesi dhe ndoshta pa anëtarë. Ne mund ta urrejmë dhe dënojmë klientelizmin politik për korrupsionin që prodhon, por për momentin është i vetmi sistem që ruan kohezionin social.

Në kushtet e zhvillimit të shoqërisë shqiptare sot, sistemi që rekomandohet nga Bashkimi Evropian dhe Banka Botërore është sa i pamundur aq edhe i rrezikshëm. Sipas këtyre institucioneve, sot Shqipëria duhet të ndërtojë një administratë publike meritokratike dhe të pavarur politikisht, që administron një shtet të vogël dhe eficient, që nuk fut duart në një treg të madh. Një administratë publike meritokratike dhe jopolitike sot do të thotë një administratë shtetërore që popullohet pak a shumë nga shtresat më të privileguara, duke lënë tërësisht jashtë shtresat në nevojë. Në kushtet kur shteti ka një rol minimal në shoqëri, një administratë e pavarur dhe mbi palët do të prodhonte një pabarazi edhe më të madhe ekonomike dhe sociale mes qendrës dhe periferisë. Ndërsa një shtet i vogël që nuk fut duart në një treg të madh për momentin do të thotë që biznesi shqiptar nuk do të jetë kurrë i aftë të konkurrojë jashtë kufijëve shqiptar dhe aq më pak me bizneset evropiane që mbështeten në mënyra komplekse nga shteti. Pra, edhe sikur të realizonim sot modelin që rekomandohet nga Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian do të kishim një Shqipëri edhe më të varfër edhe më të pabarabartë, dhe për pasojë akoma më të destabilizuar. Është pikërisht klientelizmi politik që e zbut polarizimin dhe ruan në mënyrë imperfekte kohezionin social, edhe nëpërmjet korrupsionit. Prandaj pa ndërtuar një sistem alternativ nuk mund të heqim qafe sistemin aktual. Përndryshe rrezikojmë të heqim qafe vetë shoqërinë.

### *Kosto e anti-korrupsionit*

Megjithatë edhe sikur anti-korrupsioni të ishte i mundur politikisht ai nuk është i mundur administrativisht. Flas gjithnjë për korrupsionin si fenomen dhe jo për dënimin e zyrtarëve të veçantë, për të cilët nuk ka nevojë për fushata anti-korrupsion, por thjesht për pak drejtësi. Anti-korrupsioni kërkon nënpunës, zyra dhe buxhet. Anti-korrupsioni kërkon kapacitete që administrata jonë nuk i ka. Anti-korrupsioni thith kapacitete që administratës sonë i mungojnë. Kapacitete që në vend që të merreshin me përmirësimin e punës së administratës merren me kontrole, përgjime, dhe terror psikologjik. Për të kuptuar sesa i kushtueshëm është një program i suksesshëm anti-korrupsion mjafton të përmendim rastin e Komisionit të Pavarur Kundër Korrupsionit që u ngrit në Honk Kong në vitin 1973, i cili kishte 1200 punonjës dhe një buxhet prej 14 milion dollarësh amerikan në vit (flaim për dollarë amerikanë në vitin 1973!).<sup>40</sup> Që një strukturë e tillë nuk përballohet dot nga buxheti i lodhur i shtetit tonë kjo është mëse e qartë.

Por edhe sikur një strukturë e tillë të ngrihej përsëri ajo nuk do të funksiononte në rastin e Shqipërisë siç ndodhi në Honk Kong. Në Honk Kong kjo strukturë u ngrit në një sistem politik jo demokratik, në një provincë koloniale që kontrollohej nga Britania e Madhe

dhe ku kjo e fundit mund t'i bënte ligjet më shpesh tërësisht sipas nevojave të çastit dhe jo procedurave demokratike. Në fakt Komisioni i Pavarur Kundër Korrupsionit kishte një pushtet të pakufizuar për të thërritur, investiguar dhe ndaluar zyrtarë të të gjitha rangjeve jashtë procedurave të sistemit të drejtësisë. Ky komision vepronte me moton 'faktor derisa të provohet e kundërta'.<sup>41</sup> Një sistem i tillë në Shqipëri do të ishte tmerrësisht problematik në kushtet e një sistem politik ku anti-korrupsioni shpesh degjeneron në shantazh politik.

Prandaj sot për sot, për vetë kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria dhe për vetë modelin e zhvillimit që ajo ka përqafuar lufta anti-korrupsion është e pamundur. Jo vetëm që kjo luftë është tejet e kushtueshme, por ajo pengon edhe vetë zhvillimin ekonomik. Era anti-korrupsion ka prodhuar një sërë ligjesh dhe komplikimesh ligjore që në teori synojnë të kontrollojnë korrupsionin, porse në praktikë ose nuk zbatohen ose vështirësojnë proceset e tenderimit dhe të investimeve qeveritare. Falë anti-korrupsionit ne sot jemi në situatën paradoksale të një vendi të varfër me suficit. Apo të një vendi të varfër ku qeveria nuk arrin të kryejë të gjitha investimet që ka planifikuar, pra nuk arrin të shpenzojë dot të gjitha paratë. Dhe ndërsa korrupsioni në thelb buron nga mungesa e zhvillimit, lufta anti-korrupsion e vështirëson zhvillimin akoma më shumë duke prodhuar kështu akoma më shumë korrupsion.

### **Përfundime: në fillim zhvillimi**

Në këtë artikull jam përpjekur të argumentoj se lufta anti-korrupsion në kushtet që ndodhet Shqipëria dhe për vetë modelin e zhvillimit që ajo ka përqafuar është e pamundur. Anti-korrupsioni në thelb synon të realizojë një utopi që në rastin më të mirë është përtej kapaciteteve administrative, politike, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë. Në rastin më të keq kjo utopi nuk mund të realizohet as në parim dhe jo më në realitetin shqiptar. Për pasojë anti-korrupsioni jo vetëm që nuk ka prodhuar më pak korrupsion, por shpesh është bërë edhe pengesë e procesit të zhvillimit kur në fakt vetë fenomenet korruptive burojnë dhe ushqehen nga mungesa e zhvillimit ekonomik apo nga pasojat e një rritje të pamjaftueshme dhe të deformuar ekonomike që thëllon pabarazitë sociale dhe gjeografike.

Në këto kushte në vend që të thellohet edhe më tej lufta antikorrupsion që më shumë sesa rezultate do të prodhojë zhgënjim dhe delegjitimim të sistemit politik, është e nevojshme që theksi të vendoset tek procesi i zhvillimit. Vetëm një Shqipëri që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar, ku përfitimet e zhvillimit ndahen mes grupimeve të ndryshme sociale ka mundësi të ndërtojë një administratë meritokratike, dhe një shtet që qëndron realisht mbi klientelizmin politik. Kjo nuk do të thotë se një administratë profesionale dhe një shtet përtej klientelizmit që eliminon korrupsionin janë objektiva që nuk duhen arritur. Por këto janë synime dhe jo rrugë, stacione dhe jo itinerare. Çështja shtrohet se si do mund të arrijmë tek një shtet i zhvilluar ekonomikisht, me një administratë profesioniste dhe pa korrupsion dhe klientelizëm. Drejtimi primar këtu duhet jetë përqendrimi tek zhvillimi ekonomik duke rikonceptuar rolin e shtetit si një aktor strategjik dhe jo thjesht si një arbitër asnjës. Paradigma aktuale anti-korrupsion, çdo rol të shtetit jashtë atij të arbitrit asnjës e shikon si potencial korruptiv. Pikërisht shkëputja nga ky konceptim sot do të jetë hapi i parë që nesër korrupsioni të mos mbetet Sizifi ynë.

## Literatura

- <sup>1</sup> "Përmbledhje e rezultateve", *Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja, Sondazh 2008*. Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, Tiranë, Maj 2008, faqe 9.
- <sup>2</sup> Po aty, faqe 9.
- <sup>3</sup> Nations in Transit (NIT) Report 2006. *Freedom House*, Available at <http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=47&nit=389&year=2006> Accessed last 21 March, 2007.
- <sup>4</sup> World Bank Report: *Corruption Significant Problem in Albania Despite Reforms*. Available at <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/ALBANIAEXTN/contentMDK.21006378~menuPK.50003484~pagePK.2865066~piPK.2865079~theSitePK.301412.00.html> Accessed on Januray 10<sup>th</sup>, 2007.
- <sup>5</sup> Kotkin, S. (2002) "Liberalism, Geopolitics, Social Justice", in Kotkin, S and Sajo, A (eds.) *Political Corruption in Transition*, (Budapest – New York: CEU Press), p 395.
- <sup>6</sup> Williams, R. (2000) "The Problem of Corruption: A Conceptual and Comprative Analysis", in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 127.
- <sup>7</sup> Po aty, f 17.
- <sup>8</sup> Po aty, f 127.
- <sup>9</sup> Po aty, f 127.
- <sup>10</sup> Werner, S. (2000) "New Directions in the Study of Administrative Corruption," in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), p 189.
- <sup>11</sup> Abueva, V. J. (1966), "The Contribution of Nepotism, Spoils and Graft to Political Development," *East-West Centre Review*, Vol. 3, June 1966, pp. 45-54; Samuel Huntington, (2006) *Political Order in Changing Societies*, (New Haven: Yale University Press); Merton, K. R. (1957) "Some Functions of the Political Machine", pp 72-82, in R.K. Merton, *Social Theory and Social Structure*, (New York: Free Press).
- <sup>12</sup> Bayley, D. H. (1966) "The Effects of Corruption in Developing Nations," *Western Political Quarterly*, Vol. 19, No 4, (December 1966), p 719, pp 719 – 732.
- <sup>13</sup> Sherman, L. (1976) *Scandal and Reform: Controlling Police Corruption*, (Berkley: University of California Press), p
- <sup>14</sup> Shleifer, A. and Vishny, A. (2000) "Corruption" in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 212.
- <sup>15</sup> See Klitgaard, R. (1987) *Controlling Corruption*, (Berkeley: University of California Press).
- <sup>16</sup> See Leff, N. (1970) 'Economic development through corruption', in A J Heidenheimer (ed), *Political Corruption*, New York: Holt, Rienhart and Winston.
- <sup>17</sup> Alam, S. (2000) "Anatomy of Corruption: An Approach to the Political Economy of Underdevelopment", in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 202.
- <sup>18</sup> Heidenheimer, A. and Johnston, M. (2002) *Political Corruption: Concepts and Contexts*, (London: Transaction Publishers), f 251.
- <sup>19</sup> Alam, S. (2000) "Anatomy of Corruption: An Approach to the Political Economy of Underdevelopment", in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 208.
- <sup>20</sup> Theobald, R. (2000) "So what really is the problem about corruption?" in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 472.
- <sup>21</sup> Goudie, W.A. and Stasavage, D. (2000) "A framework for the analysis of corruption", in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), p 458.
- <sup>22</sup> Kotkin, S. (2002) "Liberalism, Geopolitics, Social Justice", in Kotkin, S and Sajo, A (eds.) *Political Corruption in Transition*, (Budapest – New York: CEU Press), f 393.
- <sup>23</sup> Johnston, M. (2005) *Syndromes of Corruption*, (Cambridge: Cambridge University Press), f 18.
- <sup>24</sup> Mauro, P. (2000) "Corruption and Growth", in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 234.
- <sup>25</sup> Po aty, f 255.
- <sup>26</sup> "Helping Countries Combat Corruption: Progress at the World Bank Since 1997", *Operational Core Service (OCS), Poverty Reduction and Economic Management (PREM) Network*, (Washington: The World Bank), June 2000. f 21
- <sup>27</sup> Wolfensohn, D. J. (1999) "The 9<sup>th</sup> International Anti-corruption Conference", International Convention Centre, Durban 10 to 15 October 1999



<sup>28</sup> Nuhu Ribadu, "Distinguished Panellists Say Corruption Fight Is Central to Improving Lives of Poor", **Press Release No:2007/96/EXC**, Panel at the IMF/World Bank annual meeting, Washington, Shtator 27, 2006.

<sup>29</sup> Williams, R. (2000) "New concepts for old?", tek Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), f 514.

<sup>30</sup> Helping Countries Combat Corruption: Progress at the World Bank Since 1997", *Operational Core Service (OCS), Poverty Reduction and Economic Management (PREM) Network*, (Washington: The World Bank), June 2000. f 21.

<sup>31</sup> "The State in the Changing World" *World Development Report 1997, Summary*, (Washington: The World Bank), f 8.

<sup>32</sup> Po aty, f 4.

<sup>33</sup> Po aty, f 5.

<sup>34</sup> Khan H. Mustaq (2006). "Governance and Anti-Corruption Reforms in Developing Countries: Policies, Evidence and Ways Forward".

Disponueshem tek <http://www.q24.org/khan0906.pdf>

<sup>35</sup> Corruption Indexes: Regional Corruption Monitoring in Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Macedonia, Romania, and Yugoslavia, The Southeast European Legal Development Initiative (SELDI), Prill 2002, f 11.

<sup>36</sup> "Shqiperia dhe Bashkimi Europian: Marrveshja e Stabilizim Asocimit dhe Përtej", Ministria e Integritimit, Republika e Shqipërisë, Tiranë, 2007.

<sup>37</sup> Balla, J. (2005) "Një vështrim krahasues i partive politike në Shqipëri", Punim Diplome, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, faqe 87.

<sup>38</sup> Po aty, faqe 88.

<sup>39</sup> Po aty, faqe 89.

<sup>40</sup> Klitgaard, R. (1988) *Controlling Corruption*, (Berkely, London: University of California Press), f 127.

<sup>41</sup> Klitgaard, R. (1988) *Controlling Corruption*, (Berkely, London: University of California Press), f 120.

## KORRUPSIONI DHE PAQARTËSITË E TIJ

Fabian ZHILLA \*

**Abstrakt.** Korrupsioni është bërë tashmë një faktor shqetësues në ekonominë botërore, por roli i tij në shoqëri mbetet i paqartë. Korrupsioni mund të çrregullojë lëvizjen e tregut të lirë ose të bëjë që investimet publike të jenë joeficiente në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër korrupsioni mund të përshpejtojë zhvillimin në hapat e para të demokracisë të një ekonomie në tranzicion. Gjithashtu korrupsioni mund të jetë një efekt anësor i 'ilaçeve' kuruese për progresin socialo-ekonomik të shoqërisë siç janë ndihmat e huaja. Për këtë qëllim në mënyrë që të kemi një pamje sa më të qartë në lidhje me rolin e korrupsionit në një vend të caktuar do të ishte më korrekte nëse do të përfshiheshin në analizimin e ndikimeve të tij disa faktorë socialë si sistemi politik, kultura demokratike e shoqërisë (maturimi demokratik), historia dhe kultura etj. Do të ishte shumë e vështirë që t'i qëndrohej mendimit se korrupsioni ndikon vetëm negativisht në shoqëri, por nga ana tjetër është po aq e vështirë gjithashtu të pretendosh vetëm të kundërtën. Në këtë kuptim fenomeni i korrupsionit dhe pasojat e tij në zhvillimet ekonomiko-sociale të një vendi janë të diskutueshme dhe për këtë qëllim kërkojnë që të analizohen duke u bazuar në një fazë apo situatë të caktuar politike ose ekonomike që ai vend kalon.

### Hyrje

*"Në të vërtetë korrupsioni nuk është më një çështje tabu, por diçka që politik-bërësit, sektori privat, shoqëria civile, media dhe donatorë nga e gjithë bota janë duke e ballafaquar haptaz"*<sup>1</sup>

**K**orrupsioni perceptohet si një fenomen negativ për ekonominë në të gjithë botën. Çështja e korrupsionit u mor në konsideratë nga organizatat ndërkombëtare vetëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pasi efektet e tij ne mirëqënien e vendeve në zhvillim ishin shkatërrues. Problematikat që prodhon korrupsioni janë të karakterit politik dhe ekonomik. Korrupsioni mund të rrisi ndjeshëm varfërinë, shkatërroj besimin e publikut tek institucionet qeverisëse, të provokojë skandale politike, të dëmtojë investimet private dhe mund të pengojë zhvillimin shoqëror për një kohë të gjatë. Megjithatë edhe pse korrupsioni konsiderohet gjërësisht nga shumë analistë si një faktor pengues për proceset e ndërtimit të një ekonomie të qëndrueshme, ngelet për tu cilësuar se ka ende shumë elementë të paqartë të këtij fenomeni që hedhin dritë në disa aspekte pozitive të tij. Është ky qëllimi që ky studim kërkon të provokojë në lidhje me disa tematika interesante në të cilat korrupsioni ka një ndikim të rëndësishëm si: roli i korrupsionit në ekonomi, pasojat e korrupsionit në investimet publike dhe efektet e ndihmave të huaja mbi rritjen apo uljen e indeksit të korrupsionit.

\* Fabian Zhilla ka përfunduar studimet e tij në nivelin master në vitin 2006 në London Metropolitan University (UK) për Ligjin Ndërkombëtar Bankar dhe Siguracionet. Gjatë periudhës 2007-2008, zoti Zhilla është specializuar në lidhje me administratën publike në George Washington University (USA) dhe Krimin Ekonomik Ndërkombëtar dhe Korrupsionin në Georgetown University, Law Center(USA).

Në fakt secila nga tematikat e mësipërme është shumë e rëndësishme dhe meriton një studim të veçantë, megjithatë ajo që i bën ato pjesë të të njëjtit subjekt është roli pak i paqartë i korrupsionit në secilën prej tyre. Pjesa e parë e këtij studimi flet në mënyrë të përmbledhur për ndryshimet e pikëpamjeve në lidhje me perceptimin e korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat. Qëllimi i këtij trajtimi është të tregojë se pozicionimi i palëve në kryerjen e nje transaksioni, që mund të përfshijë elemente korruptiv, është shumë i rëndësishëm në lidhje me perceptimin e këtij veprimi si korruptiv ose jo. Pjesa e dytë e studimit do të fokusohet në pasojat dëmtuese të korrupsionit në ekonomi në përgjithësi dhe në investimet publike në veçanti. Megjithatë në vijim të kësaj pjese, në seksionin e dytë, studimi shqyrton disa çështje të debatueshme në lidhje me korrupsionin siç është roli pozitiv i tij në vendet në zhvillim. Ndhimat e huaja shikohen si instrumente mjaft produktive nga vendet e zhvilluara për ndërtimin dhe forcimin e institucioneve në vendet në tranzicion. Po në fakt pyetja që lind është se sa praktikisht ndhimat e huaja ndihmojnë vendet në zhvillim të forcojnë institucionet e tyre apo thjesht ato rrisin fuqinë e regjimeve korruptive në kapjen e shtetit në rastet kur korrupsioni është prezent. Kjo pikë mjaft e paqartë do të trajtohet në pjesën e fundit të këtij studimi.

### **Koncepti i korrupsionit ne sektorin publik dhe privat**

Sipas Fjalorit të Oksford-it<sup>2</sup>, korrupsioni përcaktohet si "perversio ose shkatërrim i integritetit të funksionit shtetëror nga ryshfeti ose favori, përdorimi ose ekzistenca e praktikave korruptive në një shtet, ndërmarrje shtetërore, etj." ose "dashuria për paranë është korrupsion për shtetin" (Jowett, Benjamin 1875)<sup>3</sup>. Me fjalë të tjera, korrupsioni konceptohet si një keqpërdorim i besimit të publikut nga punonjësit shtetëror, një situatë e cila shfrytëzohet nga punonjësit e administratës publike si një mundësi e 'artë' për të përfituar në mënyrë të paligjshme. Mund të konsiderohet gjithashtu edhe si një kapërcim i detyrës zyrtare, pasi punonjësit publik shfrytëzojnë postin e tyre për të vendosur kontrollin mbi të mirat publike.

Sidoqoftë duhet cilësuar se konceptimi i korrupsionit mund të ndryshojë kur flitet për sektorin privat. Ajo që mund të cilësohet si 'respekt' në një marrëdhënie biznesi mund të shihet ndryshe në një shërbim publik. Nëse në sektorin privat një dhuratë mund të vlerësohet si shenjë mirënjohje ose respekti, kjo mund të paragjykohet në sektorin publik më shumë si një mundësi për të 'peshkuar' një favor në shërbimet publike sesa thjesht si një shenjë mirënjohje apo respekti. Nëse një kompani ndërtimi ndihmon një kompani tjetër nëpërmjet një nënkontraktimi, ky favor mund të shihet si një favor i padrejtë nëse e njëjta situatë ndodh me një agjenci shtetërore. Është për tu nënvizuar se çdo qytetar është i barabartë përballë ligjit dhe gëzon të drejtën për tu shërbyer po në mënyrë të barabartë me të gjitha llojet e shërbimeve publike dhe të ketë akses në to pa u diskriminuar politikisht.

Sidoqoftë, biznesi privat kërkon që veprimet administrative të jenë sa më të thjeshta dhe sa më pak burokratike, gjë e cila i ndihmon ata t'i përgjigjen më shpejt kërkesave të tregut. Nga ana tjetër administrata publike nuk është një strukturë fitimprurëse dhe nuk ka të njëjtin koncept në lidhje me tregun. Në një ekonomi të bazuar në tregun e lirë, shteti përdor veprimet burokratike si një element i cili supozohet të institucionalizojë shërbimet publike duke i legalizuar ato. Kështu, ajo që një kompani private i paguan një zyrtari publik me qëllimin për të shkurtuar veprimet burokratike duke i konsideruar ato si veprime 'lehtësuese';

në administratën publike ky veprim mund të konsiderohet ryshfet ose shkëmbim favoresh i paligjshëm.<sup>4</sup> Për tu cilësuar është gjithashtu se niveli i korrupsionit në marrëdhëniet midis administratës publike dhe biznesit privat është një tregues i rëndësishëm i korrupsionit në shoqëri. Ky fenomen mund të jetë dy llojesh ose një korrupsion që vjen nga poshtë lartë ku biznesi ushtron 'presion' për veprime korruptive ose korrupsion që vjen nga lartë poshtë, gjë e cila drejtohet nga zyrtarët shtetëror. Megjithatë ky fenomen është i ndryshëm në shoqëri të ndryshme.

Në mënyrë të përmbledhur, koncepti për korrupsionin nuk është uniform dhe kjo varet nga marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe private. Të dy palët kanë qëllime të ndryshme dhe po kështu është dhe perceptimi i tyre për veprime që mund të ndërthuren me elemente korruptive. P.sh. nëse koncepti i shkëmbimit të favoreve tingëllon i arsyeshëm në biznesin privat kjo nuk mund të jetë e tillë në administratën publike. Me fjalë të tjera ajo që konceptohet si veprim korruptiv në institucionet shtetërore nuk mund të kuptohet si e tillë në sektorin privat. Në këtë kuptim për të bërë një përcaktim sa më të saktë të korrupsionit apo veprimeve që lidhen me të duhet që së pari të përcaktohen palët pjesëmarrëse dhe qëllimet e tyre dhe pastaj të bëhet klasifikimi i veprimit si korruptiv ose jo.

### **Efektet negative të korrupsionit në shoqëri**

Shumica e analistëve kanë konkluduar se efektet e korrupsionit në shoqëri janë të shumëfishta. Ata shkojnë deri aty sa ta përcaktojnë korrupsionin vdekjeprurës po aq sa dhe virusi i HIV/AIDS.<sup>5</sup> Sidoqoftë ky studim ka si qëllim të sjellë një vështrim tjetër lidhur me korrupsionin dhe efektet e tij në shoqëri. Në pjesën e parë të këtij seksioni do të flitet për disa efekte negative të korrupsionit në ekonomi. Por në pjesën e dytë ne do të provokojmë faktin se korrupsioni nuk është gjithmonë pengues në zhvillimet ekonomike. Por ka momente ku korrupsioni luan një rol të kundërt, atë të lehtësimit dhe ndihmësimit të zhvillimit të një ekonomie në tranzicion.

#### *Efektet penguese të korrupsionit në rritjen ekonomike*

Duhet pasur parasysh se shteti është përgjegjës për mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e taksave në mënyrë korrekte. Shpërndarja e këtyre fondeve është nën kompetencën totale të zyrtarëve publik, të cilët ja përcjellin ato bizneseve private nëpërmjet investimeve publike, ku këta të fundit janë të gatshëm të paguajnë 'një taksë të pashkruar' vetëm e vetëm që t'i përfitojnë këto mjete financiare<sup>6</sup>. Me fjalë të tjera pjesa më e rëndësishme e investimeve publike në një shtet në zhvillim shkon për ngritjen e infrastrukturës së vendit. Këtu kompanitë private përpiqen t'i përfitojnë ato nëpërmjet tenderave të hapur ose prokurimeve publike të organizuara nga administrata shtetërore. Shumë zyrtarë publik të korruptuar në vend të një procedure transparente dhe konkurimi të drejtë lejojnë që të jenë ryshfetet apo '10% -shi' kriteret që përcaktojnë fituesin e një tenderi publik dhe jo kapacitetet teknike dhe monetare të kompanive pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë korrupsioni luan një rol deformues në tregun e lirë duke dëmtuar rëndë konkurrencën dhe duke ngritur kështu një sistem, i cili pengon zhvillimin e ekonomisë.

Shumë organizata ndërkombëtare<sup>7</sup>, kur i referohen problemeve financiare që sjell korrupsioni, përqëndrohen më së shumti në dhënien e ryshfetit në sektorët kyç për shoqërinë

sij janë gjyqësori, administrata publike, partitë politike, institucionet që menaxhojnë taksat dhe tatimet etj. Sipas Susan Ackerman-it<sup>8</sup>, efektet negative të ryshfetit janë të shumta pasi ato prekin zhvillimin ekonomik të një vendi në shumë aspekte. Ajo nënvizon se:

Së pari, *ryshfeti godet tregun*, që do të thotë që duke qënë se shteti 'ligjëron' përfitimet e paligjshme të sektorit privat ai prish forcat konkurrese të tregut të lirë. Me fjalë të tjera, nqs shteti do të jetë i korruptuar, tregu nuk do të udhëhiqet nga raporti i kërkesës me ofertën, por nga 'pagesa më e mirë' e ofruar nga firmat private kundrejt administratës publike për një akses prioritar në përfitimin e fondeve publike.

Së dyti, *ryshfeti luan një rol motivues* për veprime korruptive nga punonjësit e administratës publike. Sidomos në vendet në zhvillim, ku pagat e punonjësve shtetëror janë të ulta, ryshfeti mund të ulë iniciativën e tyre për të ofruar shërbimet publike korrektësisht për masën e gjërë, duke i limituar ato vetëm për ata që paguajnë ryshfetin.

Së treti, *ryshfeti ul kostot*. Biznesi privat mund të shkëmbejë mospagimin e një takse apo ndonjë tatimi shtetëror me pagimin e një ryshfeti pasi kjo formë mund të jetë më e leverdisshme sesa pagimi i rregullt i detyrimeve shtetërore.<sup>9</sup>

Së katërti, *ryshfeti ndihmon përhapjen e aktiviteteve kriminale*. Bizneset e paligjshme dhe organizatat kriminale mund të blejnë 'lirinë' e tyre duke korruptuar forcat e rendit apo institucionet e tjera të specializuara shtetërore që merren me luftën kundër krimit të organizuar apo dhe krimit ekonomik.<sup>10</sup>

Megjithatë, sipas Khan-it<sup>11</sup>, 'korrupsioni uzurpues' është forma më e rrezikshme e korrupsionit për vendet në zhvillim. Korrupsioni uzurpues është skenari tipik i sistemit pronar-klient. Këtu punonjësit publik përdorin kompetencat e tyre për të përfituar personalisht atë që është publike. Ky lloj korrupsioni nuk vjen si rezultat i ndonjë mangësie në sistemin ekonomik, as për mungesë burimesh financiare; është thjesht për qëllime përfitimi dhe një sistem korruptiv që vjen nga lart-poshtë, që nga zyrtari më i lartë shtetëror deri tek ai më i thjeshti.

### *Roli i korrupsionit në investimet publike*

Shumë investime publike si rrugët, spitalet, aeroportet, zgjerimi i porteve, ujesjellës-kanalizimet etj., janë investime me kosto të lartë, dhe për këtë qëllim dhe shumë tërheqës për zyrtarët shtetëror. Këta të fundit i shfrytëzojnë këto projekte për të rritur të ardhurat e tyre personale në mënyrë të paligjshme. Kështu veprimet korruptive mund të vënë në rrezik bile dhe avantazhet e identifikuar nga ekspertët e ekonomisë në lidhje me rolin pozitiv të investimeve publike në zhvillimet ekonomike. Ata cilësojnë se një ekonomi e qëndrueshme kërkon kapitale dhe sa më shumë investime publike të kryen aq më shumë rritet niveli i kapitaleve.<sup>12</sup> Në këtë kuptim një shtet që ka një numër të madh investimesh publike ka më shumë gjasa të ketë një zhvillim të shpejtë ekonomik. Megjithatë prezenca e korrupsionit në këto investime luan një rol të kundërt në këtë drejtim, dhe Vito dhe Hamidi nënvizojnë se:

Korrupsioni rrit buxhetin për investim<sup>13</sup> dhe ka tendencë të zgjerojë numrin e investimeve dhe kompleksitetin e tyre. Megjithatë rezultati paradoksisht është se, disa investime publike mund të përfundojnë të ulin rritjen ekonomike pasi, megjithëse pjesa e investimeve publike në prodhimin bruto vendas (GDP) mund të jetë rritur, produktiviteti

i këtyre investimeve ka rënë.<sup>14</sup>

Me pak fjalë roli i korrupsionit në ekonominë në zhvillim është kompleks. Nuk mund të jetë i limituar në një sektor të ekonomisë apo përqëndruar në një segment kohor. Çfarë e bën korrupsionin të dëmtojë zhvillimet ekonomike nuk është një apo dy faktorë, por disa si në rastin tonë p.sh ish-in deformimi i tregut të lirë dhe roli 'i kundërt' i investimeve publike në lidhje me rritjen ekonomike. Sidoqoftë në pjesën në vazhdim ne do të shohim se negativiteti i korrupsionit mund të vihet në dyshim nëq në analizën e tij përfshihen dhe faktorë të tjerë socialë.

### **Korrupsioni nuk është gjithmonë dëmtes**

Ende kuptimi për korrupsionin është i paqartë dhe nuk ka një përcaktim unik në lidhje me të; cilësimi i tij varion nga vendi në vend, nga kultura në kulturë dhe nga një proces historik në një proces tjetër.<sup>15</sup> Ka opinione të ndryshme rreth impaktit të korrupsionit në shoqëri. Sipas disa studimeve disa analistë nuk e shohin korrupsionin në vetvete si faktorin kryesor për pengimin e zhvillimit shoqëror. Ajo që është e rëndësishme thonë ata, është ajo që 'blihet' në shkëmbim të ryshfeti të dhënë. Shumë ekonomistë dhe politologë nuk i konsiderojnë efektet minimale të një ryshfeti të vogël dhënë një punonjësi të administratës publike si diçka shumë serioze, por ajo që është serioze thonë ata është 'shkelja e parimeve'. Me fjalë të tjera është precedenti që korrupsioni mbjell në funksionimin e shoqërisë dhe impakti i tij mbi vlerat etike dhe morale të saj.<sup>16</sup> P.sh korrupsioni politik mund të jetë më i rrezikshëm për publikun e gjërë sesa një ryshfet i vogël dhënë një punonjësi publik. Në qoftë se i pari rrezikon kapjen e shtetit, forma e dytë mund të ketë efekte më të limituara në zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Jo vetëm kaq, por ryshfeti mund të shihet si një shtytje pozitive në fazat e para të zhvillimeve ekonomike për vendet në tranzicion. Në shumë vende të Azisë Lindore bumi ekonomik nuk do të kishte qënë i suksesshëm pa ekzistencën e ndonjë forme korrupsioni. J. Edgardo Campos-i në volumnin e tij të edituar (Corruption: The Boom and Bust of East Asia, 2001), vëren se "ryshfeti dhe korrupsioni kanë qënë esenciale në besueshmërinë e zbatimit të kontratave dhe kështu në prurjen masive të investimeve."<sup>17</sup> Duke ruajtur të njëjtin këndvështrim për disa role pozitive të korrupsionit, Khan-i ka bërë një klasifikim të korrupsionit në vendet në zhvillim duke u nisur nga disa pikëpamje që ndjellin interes.<sup>18</sup>

Së pari, ndërhyrja e qeverisë në disa procese të zhvillimeve ekonomike është perceptuar gabimisht si diçka negative apo si një mundësi shtesë për sektorin publik për përfitime të paligjshme. Në fakt ndërhyrja e shtetit nëpërmjet të ashtëquajturës 'pagesa e qerasë'<sup>19</sup> në vend të proceseve të liberalizimit të tregut apo privatizimeve të objekteve shtetërore, ka qënë jetike për shtetin për të ruajtur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për të mbajtur nën kontroll korrupsionin. Si rezultat p.sh, shumë vende të Azisë kanë arritur të jenë të suksesshëm sidomos në implementimin e politikave për zhvillimin e teknologjisë.

Së dyti, korrupsioni nuk vjen gjithmonë nga 'dëshirat' e pandershme për përfitime apo nga keqpërdorimi i pushtetit të punonjësve publikë. Detyrimet fiskale si p.sh politikat proteksioniste për të ndihmuar buqësinë vendase janë faktorë të rëndësishëm për t'i dhënë një hov ekonomisë. Në këtë mënyrë nëse ekonomia është e qëndrueshme kjo do të luajë një rol shumë pozitiv dhe në qëndrueshmërinë politike të vendit, gjë që është një ndër objektivat

kryesor të shtetit. Sidoqoftë duhet cilësuar se nëse në vendet e zhvilluara niveli i pagave është i konsiderueshëm dhe numri i papunësisë është në kuota të ulta, vendet në zhvillim kanë një raport negativ në këtë drejtim, i cili shoqërohet me buxhete financiare të limituara dhe shkurtime vendesh pune në masë. Në këto raste drejtues të sektorit publik mund të tolerojnë bakshishe të vogla të përfituara nga punonjës publik të niveleve të ulëta si 'kompesim' për rrogat e ulëta që këta të fundit posedojnë. Në këtë mënyrë mund të supozohet se fazat e zhvillimit dhe faktorë ekonomik mund të kushtëzojnë deri diku shtetin të tolerojë bakshishe të vogla me qëllimin sadopak për të ndikuar pozitivisht në stabilitetin politik të vendit.

Së treti, mungesa e mundësive për të mbrojtur të drejtat e pronësisë është gjithashtu një siptomë tjetër e korrupsionit në vendet në zhvillim. Sidoqoftë, sikurse u përmend dhe mësipër, faktori ekonomik është prapë një ndër arsyt kryesore. Khan-i nënvizon se kosto e aplikuar për reforma të menjëhershme në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së pronësisë mund të ndikojë në ekonomi dhe të çrregullojë sistemin pasi produktiviteti i këtyre reformave është i ngadalshëm dhe i ulët si dhe i pamundshëm për të mbuluar kostot e krijuara. Për më tepër, duke komentuar Khan-in në këtë ide, Filomeno S. Sta. Ana cilëson se:

Por sikurse tregojnë edhe shembujt e Kinës dhe Vietnamit<sup>20</sup>, marrëveshjet informale të kryera nga institucione, përfshirë këtu dhe iniciativat për mekanizma inovativë, mund të plotësojnë vakumin e krijuar nga mungesa e ligjeve për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe japin rezultate të kënaqshme si për individin ashtu dhe për shoqërinë.<sup>21</sup>

Në mënyrë të përmbledhur në një vend në tranzicion korrupsioni mund të lehtësojë zhvillimin ekonomik në fazat e para të proceseve demokratizuese.<sup>22</sup> Shumë vende në zhvillim si Kina dhe India, të njohura në lidhje me nivelin e lartë të korrupsionit, nuk kanë vështirësi në rritjen e tyre të shpejtë ekonomike. Ky është një tregues i rëndësishëm që tregon se korrupsioni nuk mund të jetë aq negativ për shoqërinë sa shumë analist e përcaktojnë. Nga ana tjetër kjo nuk do të thotë që korrupsioni duhet parë vetëm pozitivisht. Sidoqoftë, ajo që duhet pasur parasysh është se kur nisemi të studiojmë korrupsionin do të ishte shumë më shkencore që gjatë studimit të rolit të tij në një vend apo rajon të caktuar të përfshinim disa faktorë socialë të atij vendi ose rajoni si sistemi politik, shkalla e maturimit të demokracisë në atë vend, tradita kulturore dhe historike.

### **Korrupsioni dhe ndihmat e huaja**

Ndihmat apo asistencat e huaja luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimet ekonomiko-sociale të vendeve në zhvillim. Ndihmat apo asistencat e huaja ndryshojnë nga qëllimet, aktorët dhe buxhetet e tyre.<sup>23</sup> Në përgjithësi këtu kemi një transferim të sasive të mëdha të kapitalit në formë produktesh ose monedhe të huaj nga dhuruesi tek marrësi. Qeveritë e vendeve marrëse kanë avantazhin e të qenit direkt të përfshira në menaxhimin e këtyre projekteve dhe kjo e drejtë kaq ekskluzive mund të çojë deri atje sa këto qeveri të rrezikojnë t'i keqpërdorjnë këto ndihma të huaja. Pyetja që shtrohet është se cili është raporti midis korrupsionit dhe ndihmave apo asistencës së huaj?

Ndihmat e huaja mund të ndihmojnë regjimet e korruptuara të ruajnë pushtetin

dhe ta kontrollojnë atë. Duke qenë se ndihmat e huaja shkojnë nga një qeveri në tjetrën, nënvizon Thomas J. Di Lorencio, "në mënyrë të paevitueshme ndryshon drejtimi i burimeve të produkteve nga ai i aktivitetit prodhues tek ai i aktivitetit të 'qera marrjes' ose i atij të përfitimit të paligjshëm të fondeve të shtetit." Ai vazhdon më tej duke thënë se "ato [ndihmat e huaja] krijojnë një makinë patronazhi gjigande, me fjalë të tjera, të gjithë pjesëmarrësit ose gjërat që sistemi i korrupsionit ka përfshirë.<sup>24</sup> Me pak fjalë korrupsioni është një shqetësim konstant në projektet që lidhen me ndihmat e huaja.<sup>25</sup> Arsyeja është se qeveritë e vendeve në zhvillim kanë buxhete të vogla dhe paga të ulëta për punonjësit e administratës publike. Dukë qenë se projektet që lidhen me ndihmat e huaja përfshijnë mekanizma si tendera, prokurime dhe shumë procedura administrative, punonjësit e administratës publike e kanë të vështirë t'i rezistojnë tundimit ndaj ryshfeteve të majme të cilat zakonisht mund të jenë më të mëdha se e gjithë rroga vjetore e një punonjësi publik. Kështu në vend që fondet e ndihmave të huaja të shkojnë në destinacionin e përcaktuar, ato keqpërdoren nga punonjësit e administratës publike për përfitime personale të paligjshme. Duke parë se sa të rrezikuara janë ndihmat e huaja nga veprimet korruptive, shumë individë kanë vënë në dyshim metodat me të cilat organizohet i gjithë procesi i ndihmave dhe asistencës së huaj. Mark Thornton-i cilëson se:

Fatkeqësisht amerikanët janë të bashkuar në kundërshtimin që i bëjnë dhënies së ndihmave të huaja dhe kjo me një arsye të drejtë! Ndhimat e huaja, ndihmat ushtarake, falja e borxheve, ndihmat në përmirësimet ekonomike bile dhe ndihmat në të holla në raste fatkeqësish ... janë të shoqëruara me "mashtime, shpërdorime, dhe abuzime".<sup>26</sup>

Nga ana tjetër, shumë donatorë të fuqishëm argumentojnë se korrupsioni është një instrument të cilin ata e përdorin për të mbrojtur investimet e tyre.<sup>27</sup> Kështu në vitin 1994, kompanitë franceze llogaritet të kenë paguar 10 miliard franga franeze dhe kompanitë gjermane më shumë se 3 miliard dollarë amerikanë ryshfet vetëm për vitin 1996.<sup>28</sup> Megjithatë aktualisht shumë donatorë e kushtëzojnë dhënien e ndihmave duke i kërkuar vendeve përfituese plotësimin e disa kriterëve siç janë zhvillimi dhe promovimi i vlerave demokratike<sup>29</sup> dhe forcimi i institucioneve shtetërore<sup>30</sup> me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe luftën ndaj korrupsionit. Donatorët cilësojnë se shtetet me qeverisje të dobët janë të pafuqishëm të zbatojnë reforma kundër korrupsionit. Megjithatë pyetja shtrohet a mundet që ndihma apo asistenca e huaj me qëllim forcimin e institucioneve të vihet në rezik në një demokraci të brishtë?<sup>31</sup> Të asistosh me ndihma një shtet të korruptuar për forcimin e institucioneve të tij mund të dëmtojë sektorin privat pasi ky shtet mund të shtrijë pushtetin e tij në tregun e lirë nëpërmjet ligjeve dhe agjencive ligjzbatuese të cilat kontrollojnë tregun. Ky disavantazh i ndihmave apo asistencës së huaj shpjegohet nga Jim Saxton-i, i cili nënvizon se:

Literatura e cila merret me ndihmat ekonomike të huaja njih faktin se marrëdhëniet shtet me shtet në lidhje me ndihmat dhe asistencën e huaj mund që shpesh në mënyrë të kundërt të promovojë ato kushte që ndihmojnë në forcimin e korrupsionit. Kjo ndodh në mënyrë të veçantë në shtetet përfituese të ndihmave në të cilat korrupsioni është present.<sup>32</sup>



'Frika' në lidhje me ndihmat e huaja e Saxton-it është e bazuar në hipotezën e Tanz-it, i cili argumenton se një pushtet i gjërë i shtetit në ekonomi mund të çojë në korrupsion. Ky 'pushtet i zgjeruar' zakonisht reflektohet në rritje taksash, rritje të shpenzimeve nga administrata publike dhe shtrirje të kontrollit dhe kuadrit regullator të shtetit në tregun e lirë. Kështu Tanz-i pretendon se të gjitha mekanizmat e mësipërm ku zakonisht korrupsioni është prezent mund të kthehen gradualisht në një normë sjelljeje sidomos në vendet pa tradita apo eksperiencë në demokraci. Shteti kështu mund të ketë perceptim tjetër të zbatimit të ligjit. Përfaqësuesit e shtetit mund të perceptojnë si mjet për të goditur korrupsionin uljen e shpenzimeve administrative ku përfshihen dhe pagat e punonjësve publikë pasi dihet që këta të fundit kanë përfitime të paligjshme si rezultat i keqpërdorimit të funksionit publik (perceptimi i zakonshëm) sesa duke i dënuar ata për veprimet korruptive (perceptimi i shtetit ligjor).<sup>33</sup> Në këtë kontekst, roli i ndihmave të huaja në uljen e korrupsionit ngelet një pikëpyetje. Sipas fakteve të mbledhura nga Alesina dhe Weder-i, qeveritë e korruptuara nuk janë ato që marrin më pak ndihma. Në të kundërt një vrull i ndihmave të huaja në vendet në zhvillim është shoqëruar me një rritje të konsiderueshme të nivelit të korrupsionit. Alesina dhe Weder-i nënvizojnë se:

Variablet, ndryshimet në ndihma kanë pasur një koeficient të rëndësishëm negativ, i cili statistikisht tregon se një rritje në ndihma është shoqëruar me një rritje të nivelit të korrupsionit dhe e kundërta në atë se korrupsioni shfaqet të jetë i vazhdueshëm.<sup>34</sup>

Me pak fjalë ndihmat dhe asistencat e huaja luan një rol të rëndësishëm në zhvillimet ekonomiko-sociale të vendeve në zhvillim. Sidoqoftë, duhet cilësuar se ndihmat e huaja gjithashtu mund të stimulojnë korrupsionin dhe të ndihmojnë në forcimin e pozitave të qeverive të korruptuara. Ka rëndësi të theksohet gjithashtu se sipas studimit të kryer nga Alesina dhe Weder-i raporti midis ndihmave të huaja dhe korrupsionit është pozitiv, duke nënkuptuar se rritja e ndihmave të huaja ka qënë e shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me rritje të korrupsionit.

## Përfundime

Korrupsioni është bërë tashmë një faktor shqetësues në ekonominë botërore. Të analizosh korrupsionin dhe pasojat e tij në një shoqëri kërkon studimin e një tërësie faktorësh në mënyrë që të kuptohen më qartë etapat ku korrupsioni mund të dëmtojë ose jo zhvillimin ekonomik dhe social. Kështu roli i korrupsionit në shoqëri është i paqartë. Korrupsioni mund të çrregullojë lëvizjen e tregut të lirë ose të bëjë që investimet publike të jenë jo eficientë në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër korrupsioni mund të përshpejtojë zhvillimin në hapat e para të demokracisë të një ekonomie në tranzicion. Gjithashtu korrupsioni mund të jetë një efekt anësor i 'ilaceve' kuruese për progresin socialo-ekonomik të shoqërisë siç janë ndihmat e huaja. Për këtë qëllim në mënyrë që të kemi një pamje sa më të qartë në lidhje me rolin e korrupsionit në një vend të caktuar do të ishte më korrekte nëse do të përfshiheshin në analizimin e ndikimeve të tij disa faktorë socialë si sistemi politik, kultura demokratike e shoqërisë (maturimi demokratik), historia dhe kultura etj. Në mënyrë më të përmbledhur, do të ishte shumë e vështirë që t'i qëndrohej mendimit se korrupsioni ndikon vetëm negativisht në shoqëri, por nga ana tjetër është po aq e vështirë gjithashtu të pretendosh vetëm të kundërtën. Në këtë kuptim fenomeni korrupsionit dhe pasojat e tij në zhvillimet ekonomiko-

sociale të një vendi janë të diskutueshme dhe për këtë qëllim kërkojnë që të analizohen duke u bazuar në një fazë apo situatë të caktuar politike ose ekonomike që ai vend kalon.

## Referenca

- <sup>1</sup> USAID, (1999) 'A Handbook on Fighting Corruption' USAID, Center for Democracy and Governance, Washington D.C. Available at [http://209.85.135.104/search?q=cache:IQi86HPKUEJ:www.usaid.gov/our\\_work/democracy\\_and\\_governance/publications/pdfs/pnace070.pdf+Klitgaa rd+and+corruption&hl=sq&ct=clnk&cd=1#11](http://209.85.135.104/search?q=cache:IQi86HPKUEJ:www.usaid.gov/our_work/democracy_and_governance/publications/pdfs/pnace070.pdf+Klitgaa rd+and+corruption&hl=sq&ct=clnk&cd=1#11)
- <sup>2</sup> Fjalori Oksfordit Online; i aksesueshëm në [http://dictionary.oed.com/cgi/entry/50050860?single=1&query\\_type=èord&queryèord=corruption&first=1&max\\_to\\_shoë=10](http://dictionary.oed.com/cgi/entry/50050860?single=1&query_type=èord&queryèord=corruption&first=1&max_to_shoë=10)
- <sup>3</sup> Ibid, ky citim është marrë nga Jowett, Benjamin "The dialogues of Plato" tr. 1871 (1875), *Thucydides* tr. 1881
- <sup>4</sup> Ackerman-Rosse, Susan. (1999) "Corruption and Government; Causes, Consequences and Reform" Cambridge University Press p.91
- <sup>5</sup> Shiko *The Guardian*, 22 Maj 2006 ku parafrizohet Bono, një thirrës në fushatën Kunder-Varfërisë duke thënë se "Korrupsioni është po aq vdekje prurës sa dhe virusi i HIV/Aids- është një kancer, s'ka rëndësi nëse është një 12 firmësh i nevojshëm për marrjen e një licence, një polic që merr rryshfet në doganë apo një traktor që është paguar por që kurrë nuk është blerë."
- <sup>6</sup> Shiko më sipër referenca nr. 4 fq. 9
- <sup>7</sup> Për më shumë shiko Organizata për Bashkpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) "Anti-Bribery Report 2006" dhe "Global Corruption Barometer 2006" e Transparency International
- <sup>8</sup> Shiko më sipër referenca nr. 4 fq. 9-10
- <sup>9</sup> ibid
- <sup>10</sup> Ibid
- <sup>11</sup> Shiko Khan H. Mustaq (2006) "Governance and Anti-Corruption Reforms in Developing Countries: Policies Evidence and Ëays Forëard". Available at <http://ëëë.g24.org/khan0906.pdf>
- <sup>12</sup> Tanzi Vito and Davoodi Hamid (1998) "Roads to Nowhere: How Corruption in Public Investment Hurts Growth" *International Monetary Fund Papers*, Washington D.C. Available at <http://www.imf.org/external/pubs/ft/issues12/index.htm>
- <sup>13</sup> Ekonomistët bëjnë dallimin midis shpenzimeve korrente dhe atyre për investim. E para shërben në përgjithësi për të mbuluar rogat, pensionet, shpenzime administrative dhe mirmbajtje etj dhe e dyta përdoret vetëm për investime. Ata thonë se buxheti korrent mund të mbulohej nga të ardhurat që siguron shteti por përse i përket buxheti të investimeve shteti është i lirë të kërkojë hua ku të mundet. Është pikërisht ky lloj buxheti ku ekzekutivi ka akses direkt dhe mund ta përdori fuqimisht për përfitim të paligjshëm.
- <sup>14</sup> ibid
- <sup>15</sup> Korrupsioni ka qënë prezent në të gjitha shoqëritë; që nga Lashtësia Greke e deri tek Demokracitë Postmoderniste. Njihet dhe ka qënë prezente në të gjitha besimet fetare në forma të ndryshme. Për më shumë shiko Huntington P. Samuel, and Harrison E. Lawrence (2000) "Culture Matters: How Value Shape Human Progress" Basic Books, New York, USA p.112-113
- <sup>16</sup> Miller L. William, Grodelan B. Ase and Koshechkina Y. Tatyana (2001) "A Culture of Corruption?; Coping Ëith Government in Post Communist Countries" Central European University Press, p.14
- <sup>17</sup> Ky citim është marrë nga Filomeno S. Sta. Ana III (2006) "YELLOW PAD; Fighting corruption needs more than a 'spray gun'" *Business World*, 2 Tetor 2006, Pg. S1/5
- <sup>18</sup> Khan H. Mustaq (2006) "Governance and Anti-Corruption Reforms in Developing Countries: Policies, Evidence and Ways Forward". Available at <http://ëëë.g24.org/khan0906.pdf>
- <sup>19</sup> Me pagesë qeraje Khani nënkupton atë se duke qënë se shteti përdor rregullat dhe procedurat shtetërore për të bërë stabilizimin e tregut kjo padyshim mund të krijojë mundësi për afera korruptive. Kjo pasi biznesi privat duhet tu paguajë 'qeranë' zyrtareve publik në vend të pagesave ligjore ose taksave. Megjithatë ky proces të paktën mund të realizoj një farë kontrolli në treg ose të paktën mund të shmangi një farë kaosi që mund të shoqërojë tregjet në fazat e para të demokracisë në shoqëritë në zhvillim. Për më shumë shiko ibid tek fq. 17-19.

- <sup>20</sup> Shiko vlerësimin e bërë nga Banka Botërore bërë për Kinën dhe Indinë ku treguesit ekonomikë janë shumë pozitiv kur ndërkohë në vende të tjera këto tregues janë ende në nivele modeste. Për më shumë shiko "Annual Review of Development Effectiveness 2006", World Bank, Washington D.C. p. .xii
- <sup>21</sup> Për më shumë shiko tek Filomeno S. Sta. Ana III (2006) "YELLOW PAD; Fighting corruption needs more than a 'spray gun' *Business World*, October 2, 2006 Monday, Pg. S1/5
- <sup>22</sup> Me procese demokratizuese ose demokraci do të kuptojmë 'Një qeveri nga populli; atë formë të qeverisjes në të cilën panvarsia e pushtetit mbeshetet nga populli në tërësi; Ose një shtet ose komunitet në të cilën qeverisja është veshur nga populli në tërësi (Fjalori Oksfordit Online), Ose 'Demokracia është një sistem qeverisje ku individit është i lirë. Individit është i lirë jo vetëm sepse sistemi qeverisës është demokratik por sepse asnjë organizëm i shoqërisë nuk mundet që forcërisht të shtrengojë individin.' (Weaver H. James 1996). Shiko gjithashtu që demokracia është liri ose hapje. Kjo përfshin liri ose hapje politike por dhe ekonomike. (Wintraub Sidney 1991)
- <sup>23</sup> Për më shumë shiko Tisch J. Sara, & Wallace B. Michahel (1994) "The What, Why, and Who of Foreign Aid", Westview Press Inc, Colorado, USA, p 49-87
- <sup>24</sup> Di Lorenzo, J Thomas (2005), "A Foreign Aid Disaster in the Making", Lodwig von Mises Institute, Available <http://www.mises.org/story/1715>.
- <sup>25</sup> Ibid pp.102
- <sup>26</sup> Për më shumë shiko Thornton Mark (2002) "Corruption and Foreign Aid", Lodwig von Mises Institute, available <http://www.mises.org/story/1093>
- <sup>27</sup> Shiko See Tanzi Vito (1998) "Corruption Around the World, Causes, Consequences, Scope and Cure" IMF Working Paper, WP/98/63, p. 5 International Monetary Fund, Washington D.C., available at <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/wp9863.pdf>. Shiko gjithashtu Ackerman Susan tek futnota 4 më sipër në fq 177 e cila nënvizon se "shumë vende në zhvillim i rezistojnë përpjekjeve për të kontrolluar korrupsionin sepse ata besojnë së pagesa e ryshfeteve në vendet në tranzicion i ndihmon zhvillimit të biznesit vendas"
- <sup>28</sup> Ibid fq.7
- <sup>29</sup> Sipas një studimi të USAID në lidhje me rolin e ndihmave të huaja të dhëna nga USAID në forcimin e demokracisë u konkludua se " Vlerat e demokracisë dhe e një qeverisje të drejtë sipas USAID kanë një luajtur një rol të rëndësishëm pozitiv në demokraci, ndërkohë që asistencat të tjera Amerikane ose jo variojnë dhe janë statistikiqisht të pa konsiderueshme" Për më shumë shiko tek USAID Final Report on "EFFECTS OF U.S. FOREIGN ASSISTANCE ON DEMOCRACY BUILDING: Available [http://blackboard.gwu.edu/webapps/portal/frameset.jsp?tab=courses&uri=/bin/common/course.pl?course\\_id=101218\\_1](http://blackboard.gwu.edu/webapps/portal/frameset.jsp?tab=courses&uri=/bin/common/course.pl?course_id=101218_1)
- <sup>30</sup> Shiko se si Banka Botërore i jep më shumë rëndësi ndërtimit të institucioneve sesa psh ndërtimit të infrastrukturës. Për më shumë shiko tek World Bank "Reforming Public Institutions and Strengthening Governance; A World Bank Strategy. Washington, DC; World Bank, November 2000 xi-xx
- <sup>31</sup> Në lidhje me përkufizimet që i bëhen demokracisë shiko tek futnota 22 më sipër
- <sup>32</sup> Saxton Jim (1999) "Can IMF Lending Promote Corruption" Joint Economic Committee Studies, United States Congress. Available <http://www.house.gov/jec/imf/corrupt.htm#endnot29>
- <sup>33</sup> Për më shumë shiko tek futnota 27 fq. 6 më sipër
- <sup>34</sup> Alesina Alberto & Weder Beatrice (2002) 'Do Corrupt Governments Receive Less Foreign Aid?', *The American Economic Review*, Vol. 92, No. 4 (Sep., 2002), pp. 1126-1137

## Bibliografi

- Ackerman-Rosse, Susan ( 1999 ). "Corruption and Government; Causes, Consequences and Reform" Cambridge University Press p.91
- Alesina Alberto & Weder Beatrice (2002). 'Do Corrupt Governments Receive Less Foreign Aid? *The American Economic Review*, Vol. 92, No. 4 (Sep., 2002), pp. 1126-1137
- Belton Catherine and Buckley Neil (2007) "Investing in Russia; Corruption Complicates An Image Problem" *Financial Times*, October 2, 2007.
- Di Lorenzo, J Thomas (2005). "A Foreign Aid Disaster in the Making", Lodwig von Mises Institute. Available

<http://www.mises.org/story/1715>

Filomeno S. Sta. Ana III (2006). "YELLOW PAD; Fighting corruption needs more than a 'spray gun' *Business World*, October 2, 2006 Monday, Pg. S1/5

Huntington P. Samuel, and Harrison E. Lawrence (2000). "*Culture Matters: How Value Shape Human Progress*" Basic Books, New York, USA p.112-113

Kenny Charles (2007) "Construction, Corruption and Developing Countries" World Bank Policy Research Working Paper 4271, June 2007 World Bank, Washington D.C. USA.

Khan H. Mustaq (2006). "Governance and Anti-Corruption Reforms in Developing Countries: Policies, Evidence and Ways Forward".

Available at <http://www.g24.org/khan0906.pdf>

Levis James (2005). "Earthquake Destruction; Corruption on the Fault Line", Global Corruption Report 2005. Available

[http://66.102.1.104/scholar?hl=en&lr=&q=cache:MWzzzMexpacJ:ww1.transparency.org/in focus archive/tsunami/earthquake\\_destruction.pdf+corruption+and+earthquakes+in+turkey](http://66.102.1.104/scholar?hl=en&lr=&q=cache:MWzzzMexpacJ:ww1.transparency.org/in+focus+archive/tsunami/earthquake_destruction.pdf+corruption+and+earthquakes+in+turkey)

Miller L. William, Grodelan B. Ase and Koshechkina Y. Tatyana (2001). "A Culture of Corruption?; Coping With Government in Post Communist Countries" Central European University Press, p.14

Mufson Steven (2007) "Oil Prices Rise Causes Global Shift in Wealth; Iran, Russia and Venezuela Feel the Benefits" *The Washington Post*, November 10<sup>th</sup> 2007 p.A01. Available [http://www.washingtonpost.com/wpdyn/content/article/2007/11/09/AR2007110902573\\_2.html?wpisrc=newsletter](http://www.washingtonpost.com/wpdyn/content/article/2007/11/09/AR2007110902573_2.html?wpisrc=newsletter)

Poroznik Amber (2007), Spotlight Story; Transparency Watch, October 2007 Transparency International. Available [http://www.transparency.org/publications/newsletter/2007/october\\_2007/spotlight](http://www.transparency.org/publications/newsletter/2007/october_2007/spotlight)

Saxton Jim (1999). "Can IMF Lending Promote Corruption" Joint Economic Committee Studies, United States Congress. Available <http://www.house.gov/jec/imf/corrupt.htm#endnot29>

Tanzi Vito (1998). "Corruption Around the World, Causes, Consequences, Scope and Cure" IMF Working Paper, WP/98/63, p. 5 International Monetary Fund,

Washington D.C. Available at <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/wp9863.pdf>

Tanzi Vito and Davoodi Hamid (1998). "Roads to Nowhere: How Corruption in Public Investment Hurts Growth" *International Monetary Fund Papers*, Washington D.C. Available at <http://www.imf.org/external/pubs/ft/issues12/index.htm>

Tisch J. Sara, & Wallace B. Michahel (1994) "The What, Why, and Who of Foreign Aid", *Westview Press Inc*, Colorado, USA, p 49-87

Transparency International "[Global Corruption Barometer 2006](#)" Transparency International, Berlin Germany

The New York Times "China's Paradox Corruption" at *The New York Times*, March 6 1998

Thornton Mark (2002). "Corruption and Foreign Aid", Lodwig von Mises Institute, available <http://www.mises.org/story/1093>

USAID '[USAID Final Report on "Effects of U.S. Foreign Assistance on Democracy Building"](#)' USAID, Washington D.C.

Weaver H. James and Rock, T. Michael, (1996) "*Achieving Brad Based Sustainable Development*" ch. 4 p.85

World Bank "[Annual Review of Development Effectiveness 2006](#)", World Bank, Washington D.C. p. .xii

World Bank , "[Governance and Anticorruption Strategy 2007](#)" World Bank, Washington D.C.

Available [http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTGOVANTICORR/0\\_0\\_contentMDK:21096079~pagePK:210058~piPK:210062~theSitePK:3035864,00.html](http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTGOVANTICORR/0_0_contentMDK:21096079~pagePK:210058~piPK:210062~theSitePK:3035864,00.html),

World Bank "[Reforming Public Institutions and Strengthening Governance; A World Bank Strategy](#)", World Bank, Washington, DC, November 2000 p. xi-xx

World Bank "[World Bank's Strategy 2007](#)" World Bank, Washington D.C. Available <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/EXTECAREGTOPANTCOR/contentMDK:20607098~menuPK:1525227~pagePK:34004173~piPK:34003707~theSitePK:704666,00.html>

World Bank, (1997) "Overview" *The State in Changing World- World Development Report*, New York, Oxford Press for the World Bank, summery, p. 9-11

## GJINIA DHE KORRUPSIONI: A JANË GRATË MË PAK TË KORRUPTUARA SE BURRAT?

Sonila DANAJ\*

**Abstrakt.** Artikulli bën një analizë të literaturës ekzistuese që shqyrton raportin midis gjinisë dhe korrupsionit. Në të argumentohet se gratë nuk janë më pak të korruptuara se burrat për shkak të vlerave të tyre të brendshme, por për shkak të mungesës së aksesit ndaj pushtetit, dhe faktorëve socialë e kulturorë që kanë shkaktuar këtë mungesë, por që gjithashtu rregullojnë marrëdhënien e grave me korrupsionin. Pjesëmarrja e grave në politikë dhe rënia e nivelit të korrupsionit nuk janë të vendosura në raportin shkak-pasojë, por treguese të një rendi demokratik të konsoliduar ku sundon rendi ligjor, gjë që duhet pasur parasysh gjatë hartimit të politikave që promovojnë pjesëmarrjen e grave dhe luftën e korrupsionit në vendet në zhvillim.

### Hyrje

Po krijohet një mit i ri në këto momente: se gratë priren të jenë më pak të korruptuara se burrat” është fjalia hyrëse e artikullit të Anne Marie Goetz *Political Cleaners: How Women are the New Anti-Corruption Force. Does the Evidence Wash?* (2007). Dhe vërtet, ajo që të bie në sy midis të tjerave në literaturë është se një nga arsytet pse gratë nuk marrin pjesë në politikë është se nuk duan të korruptohen prej saj, pasi ato janë më të moralshme sesa njerëzit (dmth kryesisht burrat) që merren me politikë. Ky perceptim mbi gratë si më pak të korruptuara se burrat, qoftë në numër qoftë në sasi, gjendet dhe në një mori botimesh që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe gjininë. Gjithsesi, analizat gjinore të fenomenit të korrupsionit janë të pavendosura në lidhje me nivelin e korruptueshmërisë së grave dhe disa prej tyre sugjerojnë se nuk ka prova të mjaftueshme për një dallim gjinor në lidhje me korrupsionin. Me pak fjalë, literatura sugjeron qoftë se gratë janë më pak të korruptueshme se burrat, qoftë se ato janë po aq të korruptueshme sa edhe meshkujt në të njëjtat pozita me ta.

Studimet që mbështesin idenë se gratë janë më pak të korruptuara se burrat e shpjegojnë mungesën e korrupsionit tek gratë me moralitetin dhe ndjeshmërinë e tyre të lindur përkundrejt mungesës së këtyre dy tipareve të meshkujt. Në këtë artikull do të argumentoj kundër tezës se ekziston një lidhje shkak-pasojë midis rritjes së pranisë së femrave në poste publike dhe pakësimit të korrupsionit, gjë që i ka shtyrë disa autorë të argumentojnë se femrat janë më pak të korruptuara dhe të korruptueshme se meshkujt. Njëkohësisht do të

\* Sonila Danaj është lektore në Universitetin Europian të Tiranës (UET) për lëndët Teori Feministe dhe Shkrim Akademik. Ajo ka një diplomë MA në Studime Evropiane Bashkëkohore nga Universiteti i Sussex-it në Mbretërinë e Bashkuar dhe fushat e saj të interesit akademik janë kryesisht migracioni dhe pjesëmarrja e grave në politikë.

shpjegoj se gratë nuk janë më pak të korrupuara për shkak të moralitetit dhe ndjeshmërisë së tyre, por për shkak të mungesës së aksesit ndaj pushtetit dhe mungesës së konsolidimit të pozitive të tyre pushtetare, që do të përgatisnin terrenin për shfaqjen e sjelljeve korruptive. Pra, falë faktorëve socialë e kulturorë, të cilët pakësojnë mundësitë e tyre për të ardhur në dhe për të mbajtur pozita pushteti, gratë duke mos qenë të ekspozuara ndaj pushtetit, kanë më pak mundësi të korruptohen. Ky artikull do të nisë me rishikimin e literaturës nga paraqitja e argumentave pro tezës se gratë janë më pak të korrupuara se burrat, do të vazhdojë me paraqitjen e argumentave kundër, që do të pasohet nga shpjegimi i arsyeve pse edhe unë jam kundër dhe i implikimeve negative të kësaj teze. Më pas do të shqyrtoj pozitën e grave në Shqipëri në lidhje me korrupsionin.

Vlen gjithashtu të përmend se në këtë shkrim termi korrupsion do të përdoret sipas përkufizimit të Bankës Botërore, që e shpjegon si "abuzimin e pushtetit të besuar për përfitim personal". Mirëpo nuk duhet të harrojmë se përveç aktit të shkeljes së ligjit, korrupsioni perceptohet edhe si diçka e pamoralshme, që duhet të dënuar si akt i pandershëm dhe i pistë. Lidhur me këtë përkufizim do të përdoren edhe dy termat "i/e korruptuar" dhe "i/e korruptueshëm/shme", si edhe antonimet e tyre "i/e pakorruptuar" dhe "i/e pakorruptueshëm/shme", sipas kuptimit të dallueshëm të secilit prej tyre. Çifti i parë i antonimeve nënkupton përfshirjen ose jo të një personi në korrupsion, ndërsa "i korruptueshëm – i pakorruptueshëm" ka të bëjë me aftësinë e brendshme të një personi për t'u përfshirë në korrupsion, nëse i jepet mundësia.

### **Argumentat pro tezës se gratë janë më pak të korrupuara se burrat**

Ekzistojnë një sërë argumentash që mbështesin idenë se gratë janë më pak të korrupuara se burrat. Këto argumenta janë mbështetur dhe nga të dhënat empirike të studimeve si ai i Bankës Botërore të kryer nga Dollar et al (1999), apo ai i Swamy-it et al (2001). Ndër shpjegimet kryesore pse mendohet se gratë janë më pak të korrupuara se burrat është ai esencialist që i njeh gratë si më të moralshme se burrat. Përveç kësaj, duke qenë se gratë, për shkak edhe të marxhinalizimit të tyre në sferën publike, i kanë vuajtur më shumë pasojat e korrupsionit në formën e privimit të shërbimeve, janë më të prirura ta shmangin atë.

Argumenti i parë për numrin më të vogël të grave të korrupuara dhe për perceptimin e përgjithshëm se femrat janë vërtet më pak të korrupuara se meshkujt, lidhet siç e përmendëm më lart me moralin. Një nga përkufizimet më të hershme të korrupsionit ka qenë i lidhur me mungesën e moralit në sferën publike, veçanërisht atë politike. Duke mos bërë pjesë në të, atëherë gratë janë më të moralshme dhe të pakorruptueshme. Për ta përforcuar këtë argument, ai lidhet me argumentin se mospërfshirja e grave në afëra korruptive vjen nga morali i tyre, i cili i pengon të përfshihen në radhë të parë në çështjet politike dhe ato të pushtetit. Kështu duke mos u marrë me politike dhe duke mos synuar pushtetin, gratë arrijnë të ruajnë moralitetin e tyre dhe të qëndrojnë të pakorruptuara. Me pak fjalë gratë janë më të ndershme se burrat dhe zgjedhin të mos angazhohen në politike për shkak të ndershmerisë së tyre dhe për të mos e humbur atë (Ekonomi et al, 2006).

Nisur nga përkufizimi i mësipërm i korrupsionit si "abuzim të pushtetit të besuar për përfitim personal" (Banka Botërore), apo dhe si "shitje e pronës shtetërore për interesa vetjake" (Shleifer dhe Vishny, 2000: 212), atëherë qoftë nga perspektiva moraliste/

normative, qoftë nga ajo e tregut, ky fenomen është negativ dhe duhet shmangur pasi ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillim. Një arsyetim i tillë shkon krah për krah me tezën se gratë janë më pak të korruptuara, pasi ato duke qenë të papërfshira ose të tëhuajzuara në qeverisje, jo vetëm që nuk kanë pasur mundësi të përfshihen në korrupsion, por shpesh edhe i kanë vuajtur pasojat e tij, kryesisht mungesën e shërbimeve dhe favorizimit. Pozita prej vuajtësi të pasojave negative të korrupsionit bën, thonë disa autorë, që gratë të jenë më të ndjeshme dhe më të ndërgjegjshme ndaj pasojave negative të korrupsionit. Për rrjedhojë, kur pozita e tyre ndryshon, pra kur ato kanë akses ndaj pushtetit dhe pronës shtetërore janë më pak të prirura të përsërisin situatat, në të cilat ato janë gjendur më herët, dhe në të cilat kanë vuajtur mungesën e shërbimeve. Me pak fjalë, përjetimi i pasojave negative të korrupsionit nëpërmjet mungesës së drejtpërdrejtë të shërbimeve e favoreve të shpërndara padrejtësisht, i bën gratë të drejtohen nga parrulla të tipit “mos i bëj dikujt, atë që s’do të doje të ta bënin ty”, gjë që i kthen rrjedhimisht në më pak të korruptueshme dhe të korruptuara se kolegët e tyre meshkuj.

Argumenti i ndjeshmërisë ndaj komunitetit bashkëvuajtës është mbështetur nga gjetjet e studimeve të ndryshme, të cilat kanë vënë re dallime në sjellje midis dy gjinive, si për shembull, gratë shfaqin më shumë sjellje “ndihmuese”; votojnë në bazë të çështjeve sociale; marrin më shumë pikë në “testet mbi integritetin”; mbajnë qëndrime më të forta mbi sjelljen etike; dhe sillen më bujarisht kur përballen me vendime ekonomike. Këto rezultate nënkuptojnë se gratë janë më pak të prirura për ta sakrifikuar të mirën e përbashkët për fitim personal (material) (shih Dollar, Fisman dhe Gatti, 1999: 1). Duke qenë se qeveritë në mbarë botën janë të dominuara nga meshkujt, disa politologë dhe feministe e kanë cituar këtë fakt për të shpjeguar funksionimin e keq dhe mungesën e përgjegjshmërisë së shumë qeverive (Staudt, 1998 sipas Dollar, Fisman dhe Gatti, 1999: 1), të cilat kanë rezultuar në rritjen e korrupsionit në punonjësit e tyre, shpesh të shprehur me shpenzime të pajustificueshme të drejtuesve për makina, truproja, udhëtime e të tjera. Për më tepër, gratë ndryshe nga burrat sjellin në sferën publike vlera të pasura si ndershmëria, e për rrjedhojë, sipas Tishkov, ato rrallë i nënshtrohen stileve autoritare të sjelljes dhe preferojnë të mos mbajnë atë lloj enturazhi të shtrenjtë që shpesh shoqëron zyrtarët e lartë meshkuj (Valerii Tishkov sipas Dollar et al, 1999).

Për të vërtetuar se gratë janë më pak të korruptuara se meshkujt, Dollar, Fisman dhe Gatti në studimin e tyre hetuan marrëdhënien midis pjesëmarrjes femërore dhe korrupsionit të perceptuar në një kampion prej 100 vendesh tregojnë se gratë kanë standarde më të larta të sjelljes etike dhe janë më të interesuara për të mirën e përbashkët se meshkujt, ky studim krahasimor dëshmoi se në nivel vendi, numri më i madh i pjesëmarrjes së grave në qeverisje shoqërohet me nivele më të ulta korrupsioni, gjetje këto të mbështetura edhe nga studime të tjera si ai i Swamy et al (2001), të kryera në nivel mikro dhe kombëtar. Ky përfundim i shtyu autorët e të dy studimeve të argumentojnë se nëse gratë kanë më pak gjasa të sillen në mënyrë oportuniste, atëherë sjellja e më shumë grave në pushtet mund të sjellë përfitime domethënëse për shoqërinë në përgjithësi.

### **Argumentat kundër tezës se gratë janë më pak të korruptuara se burrat**

Edhe pse disa studime kanë përfunduar se gratë janë më pak të korruptuara se burrat, nuk ka

prova të mjaftueshme e të qëndrueshme se gratë në përgjithësi janë më pak të korruptueshme se burrat. Disa studime madje tregojnë se nuk ka dallime gjinore në nivelet e korrupsionit ose se ato janë të papërfillshme, si edhe se rritja e pjesëmarrjes së grave në poste publike nuk shkakton rënien e nivelit të korrupsionit në ato institucione. Duke kritikuar artikullin e Dollar et al, Goetz, për shembull, argumenton se edhe pse prania e grave në legjislativ, ekzekutiv dhe poste të tjera publike ndikon në futjen e ligjeve, politikave dhe caktime burimesh që favorizojnë çështjet që iu interesojnë grave dhe që i ndihmojnë ato të përmirësojnë kushtet e grave në përgjithësi, gjithsesi qoftë ky studim, qoftë ai i Swamy et al, nuk arrijnë të gjejnë një masë të saktë për matjen e korrupsionit. Ajo gjithashtu flet për kufizimet e këtyre studimeve që vijnë nga vetë vështirësia e përkufizimit dhe identifikimit të korrupsionit. Vështirësia, thotë ajo, nuk vjen vetëm prej natyrës kriminale e rrjedhimisht të fshehur të tij, por edhe prej faktit se edhe vetë natyra e korrupsionit është e gjinizuar për shkak se gratë mund të vihen përballë kërkesës për favore seksuale në këmbim të një sjellje preferenciale, gjë që nuk ndodh me burrat. Kjo bën që përfshirja në korrupsion të përmbajë dhe elementin e turpit, i cili nga ana e vet bën që gratë të heshtin kur ndodh, ndryshe nga rastet kur qoftë burrave, qoftë grave u kërkohen shpërblime monetare. Kështu që duke qenë se përkufizimi dhe matja e korrupsionit janë të mangëta, atëherë dhe raporti i zhdrejtë midis pakësimit të korrupsionit dhe rritjes së pranisë së grave në poste publike nuk mund dhe nuk është arritur të shpjegohet në mënyrë korrelative (Goetz, 2007).

Për më tepër, studime të tjera që kanë synuar krahasimin e sjelljes së burrave dhe grave në lidhje me korrupsionin nuk kanë gjetur dallime domethënëse. Për shembull, studimi i Alatas et al (2006), në një analizë eksperimentale të të dhënave në Australi, Indi, Indonezi dhe Singapor, tregojnë se edhe pse në Australi gratë ishin më pak tolerante ndaj korrupsionit se burrat, në tri vendet e tjera nuk kishte dallime domethënëse gjinore. Në këtë studim korrupsioni u pa në dy aspekte: mundësia për të dhënë rryshfete dhe për të dënuar mitmarrjen në të gjitha format e saj. Në përfundimet e tyre autorët sugjerojnë se dallimet gjinore janë të papërfillshme, përveç rastit të Australisë dhe ky qëndrim ndaj korrupsionit është më shumë i lidhur me kulturën, sesa me gjininë, që nënkupton se në një shoqëri ku gruaja është më e çliruar nga marrëdhëniet patriarkale dhe prania e saj në sferën publike/politike është tashmë e gjerë, gratë njëkohësisht kanë përqaftuar vlerat e demokracisë liberale duke dënuar rrjedhimisht fenomene si korrupsioni.

Teza që e shpjegon dallimin gjinor të bazuar në kulturë dhe të influencuar nga faktorë shoqërorë mbrohet dhe nga autorë të tjerë si Alolo (2006: 6-7), e cila në studimin e saj argumenton se gratë priren të korruptohen ashtu si edhe burrat, edhe pse paraqesin arsye të ndryshme për një sjellje të tillë. Në studim, studiuesja u prezantoi 140 punonjësve civilë një skenar, kur një drejtor kontraktonte një firmë me më pak para se buxheti i caktuar për atë punë, dhe i përdor paratë që i tepruan për kurat e fëmijës së vet dhe punonjësit duke i pyetur nëse kjo ishte e pranueshme. Nga përgjigjet e marra në favor të kësaj sjelljeje, gratë e justifikuan përvetësimin e fondeve shtetërore, në rastet kur këto para do të shërbejnë për shpëtimin e jetës së fëmijës së vet ndërkohë që meshkujt argumentuan se përderisa ishte aq i zoti sa t'i kursente, atëherë mund t'i mbante.

Alolo gjithashtu argumenton se gratë, për shkak të faktorëve socio-kulturorë të cilët presin që gruaja të jetë më tolerante, zemër-butë dhe bashkëpunuese, mund t'u nënshtrohen presioneve të miqve dhe familjarëve, pra të një komuniteti, që pret që gruaja të jetë e "butë



dhe e bindur, dhe të synojë kompromisin, në mënyrë që t'i kënaqë të gjithë" dhe t'i shkelë rregullat në favor të tyre (2006: 14-16). Ky argument na shtyn të mendojmë se jo vetëm janë gratë po aq të korruptueshme sa meshkujt, por ato mund të përballen edhe me presione të tjera, të nxitura nga pozita e tyre prej femrash, që të pranojnë dhe kryejnë korrupsion, qoftë duke favorizuar të njohurit, qoftë duke pranuar rryshfete, si një mundësi për më shumë të ardhura familjare dhe për të ruajtur marrëdhëniet me të njohurit duke i favorizuar ata në mënyrë të njëanshme. Me pak fjalë, ka pak të ngjarë që gratë të veprojnë si pastruesit politikë (Goetz sipas SIDA, 2007: 12). Përkundrazi, siç na thotë Alolo për shkak të faktorëve socio-kulturorë që i pozicionojnë gratë si nënshtruara brenda familjes nukleare dhe të zgjeruar, gratë mund të jenë më të prirura të përfshihen në korrupsion.

### **Pse gratë nuk janë më pak të korruptuara se burrat**

Jo vetëm që gjetjet e studimeve të ndryshme tregojnë se dallimet gjinore përsa i përket përballjes me korrupsionin nuk janë aq të qarta sa ç'kanë pohuar disa studiues, por edhe vetë argumentat pro tezës se gratë janë më pak të korruptuara se burrat nuk qëndrojnë. Kështu problemi me argumentin e mungesës së grave në politikë për shkak të moralit dhe ndershmërisë së tyre qëndron në faktin se edhe pse mospërfshirja e grave në politikë është e dukshme, ajo është pasojë sa e mungesës së angazhimit të tyre, aq edhe e faktorëve të jashtëm që i kanë penguar në shekuj, duke e kthyer mungesën e grave në politikë në diçka normale, të cilën nuk e kundërshtojnë as ato vetë (mënyra më e mirë për t'u shprehur këtu është "as edhe një pjesë prej atyre vetë"). Pra, mungesa e grave në politikë nuk vjen si pasojë e faktit se politika është e pamoralshme, dhe ato nuk duan të "ndoten" prej saj duke u korruptuar, por sepse kjo gjë iu është penguar për mjaftueshëm kohë sa pengesat të jenë konsoliduar qoftë nga faktorë të jashtëm, qoftë të brendshëm. Ndër faktorët e jashtëm përmendim mungesën e mbështetjes shoqërore, partiake, familjare dhe financiare; ndër faktorët e brendshëm më i rëndësishëm në këtë pikë është fakti se ato nuk e shohin politikën dhe pushtetin në sferën publike si diçka që iu përket dhe e duan, pavarësisht nga lidhjet që ka pushteti me korrupsionin.

Me fjalë të tjera, përshtypja se gratë janë më pak të korruptuara se burrat vjen sepse gratë kanë pasur mundësi të pakta për të qenë në pozita pushteti dhe vendimmarrjeje publike, e për rrjedhojë kanë pasur më pak mundësi për të treguar nëse janë më pak të korruptueshme se ç'janë apo do të ishin meshkujt në të njëjtat pozita. Ky pohim është bërë edhe tridhjetë e shtatë vjet më parë nga një prej aktivisteve feministe amerikane, Gloria Steinman, në një artikull të Uashington Post argumentoi se gratë nuk janë më të moralshme, ato janë thjesht të pakorruptuara nga pushteti (1970). Angazhimi i pakët në politikë dhe pozicioni i grave në poste me pak pushtet, në mos thjesht në shërbim të eprorëve vendimmarrës në administratën politike e publike për shembull, bën që më pak gra të kenë mundësi të korruptohen. Nisur nga thënia e Lord Aktonit mbi prirjet e pushtetit për të korruptuar njerëzit, mund të themi se gratë duke qenë të përjashtuara nga pushteti, kanë pasur më shumë mundësi të ruajnë vlerat e tyre dhe të mos korruptohen. Gjithsesi, kjo nuk na garanton se me të ardhur në pozita pushteti, gratë nuk do të korruptohen.

Gjithsesi vlerat që vijjnë nga akseset në pakët në pushtet nuk na garantojnë se gratë janë të pakorruptueshme. Goetz sugjeron se qëndrimi i grave ndaj korrupsionit kushtëzohet

dhe nga rruga sesi gratë vijnë në pushtet. Ardhja në format demokratike të zgjedhjes me votën e lirë dhe/ose emërimit në bazë meritokracie ka më shumë të ngjarë të shoqërohet me sjellje etike dhe mosabuzim të pushtetit për përfitim personal. Nga ana tjetër gratë të cilave futja në rradhët e vendimmarrësve iu është garantuar në forma jodemokratike jemi të prirur të mendojmë se do ta abuzojnë pushtetin e tyre (shih Goetz, 2007). Përderisa ato vetë ose mbështetësit e tyre kanë abuzuar me pushtetin për t'i fuqizuar, edhe vetë gratë përfituese nuk mund të sillen ndryshe përveçse në mënyrë abuzive.

Gjithashtu nuk duhet të harrojmë se në një sistem të korruptuar, përfitojnë ata që kanë lidhjet e duhura dhe të ardhurat për të blerë pronën shtetërore, informacion apo shërbime të tjera që ofron shteti. Gratë janë në disfavor në këtë situatë për dy arsye. Së pari, struktura patriarkale e shoqërive bën që bisedat dhe negociatat në sferën publike të kryhen mes burrash, shpesh në rrethana joformale, gjë që në të njëjtën kohë përjashton gratë. Këtu përfshihen dhe situatat e korrupsionit dhe nuk është çudi që raportimet për mitmarrje tregojnë se për të kryer shkëmbimin është e nevojshme prania e një mashkulli, që shoqërohet me thënienë të tipit "nuk keni ndonjë burrë me kë të bisedoj/më?!", ku biseda nënkupton dhënien dhe marrjen e rryshfetit. Së dyti, është tashmë e vërtetuar nga një sërë studimesh, përfshi dhe raportet e Bankës Botërore se në vendet në zhvillim, gratë janë pjesa më e madhe e grupit të atyre që jetojnë në varfëri apo dhe nën nivelin e varfërisë. Procesi i feminizimit të varfërisë bën që gratë të kenë më pak burime për të blerë atë çka ofrojnë të korruptuarit. Si rrjedhim, argumenton Goetz marrëdhëniet gjinore kufizojnë *mundësitë* për sjellje prej të korruptuari, apo oportuniste, gjë që mund të ndryshojë, kur të vendosen rrjetet femërore, kur vendet e punës të bëhen më të femërorizuara, ose kur gratë të kenë pozicione të larta udhëheqjeje që do t'u mundësojnë atyre t'i ridrejtojnë rrjetet e shkëmbimeve të paligjshme kah përfitimi vetjak (2007).

Përveç mungesës së mundësisë për t'u përfshirë në situata ku ato mund të përfitojnë nga pozita e tyre institucionale, gratë vihen edhe në rolin e pësuesit të pasojave të korrupsionit. Ato vuajnë mungesat që vijnë me përjashtimin ndaj aksesit në pushtetin dhe mundësisë për të abuzuar me të për përfitim personal. Korrupsioni shpesh i përjashton gratë nga pushteti dhe pasuria, sepse ato kanë më pak akses në rrjetet joformale dhe favoritizëm (SIDA, 2007: 12). Për më tepër, duke qenë se korrupsioni favorizon ata që korruptojnë punonjësit shtetërorë, ata që nuk paguajnë, marrin shërbime të pjesëshme ose jocilësore dhe kur korrupsioni është në nivele të larta si në vendet në tranzicion, nuk përfitojnë asnjë shërbim. Kjo do të thotë se në vende ku korrupsioni është shumë i përhapur, shtohet edhe rreziku i diskriminimit gjinor (po aty), dhe gratë kanë më pak mundësi e pushtet për ta sfiduar korrupsionin, dhe madje të bien pre e formave të gjinizuara të korrupsionit, siç janë kërkesat për favore seksuale (Sever for Bridge, 2005). Edhe në një studim të Këshillit të Evropës mbi Gjininë dhe Korrupsionin në Evropën Jug-Lindore (2004) u argumentua se në vendet me njëanshmëri gjinore të institucionalizuara, është më e vështirë për gratë sesa për burrat për të dalë nga varfëria (Council of Europe, 2004: 6).

Lind pyetja: pse politikat e zhvillimit dhe projektet e organizatave ndërkombëtare i mëshojnë tezës së grave si më pak të korruptuara dhe të korruptueshme se meshkujt. Përgjigjja është e thjeshtë, këto argumente janë instrumente për arritjen e një qëllimi më të madh: rritjen e pjesëmarrjes së grave në poste publike. Në lidhje me këtë çështje Phillips shpjegon se në debatin publik ekzistojnë tri argumente kryesore në lidhje me kërkesën për

më shumë pjesëmarrje të grave në politikë dhe në postet publike: së pari, gratë sjellin në politikë një grup tjetër vlerash, përvoja dhe ekspertize, duke pasuruar jetën politike të një vendi; së dyti, duke qenë se burrat dhe gratë janë në konflikt, gratë duhet të jenë të pranishme në jetën publike për të përfaqësuar interesat e grave si gjini; dhe së treti, thjesht sepse është çështje drejtësie, pra është e padrejtë që ato të përjashtohen. Dy argumentat e parë Phillips i hedh poshtë duke thënë se supozimet esencialiste janë të pavërtetuara, dhe se gratë mund edhe të sjellin vlera jo-demokratike, duke pasur parasysh shoqërizimin e tyre në ambiente jodemokratike si shtëpia, ndërkohë që nuk mund të flasim as edhe për gratë si një grup i vetëm dhe i konsoliduar interesi, duke pasur parasysh se gratë janë të ndara në besnikëritë e tyre ndaj fesë, rajonit, shtresës e të tjera, më shumë sesa mund të bashkohen nga fakti se janë të gjitha gra. Si rrjedhim, shton Goetz i vetmi argument i qëndrueshëm është ai i drejtësisë në dhënien e mundësisë grave të përfaqësohen dhe të jenë të pranishme në sferën publike, që, duke iu referuar sërish Phillips, "nuk na thotë gjë për atë që do të bëjnë gratë kur të futen në politikë". Mirëpo, argumentet e bazuara në të qenit i drejtë janë më pak bindës se ato instrumentale, të cilat nënkuptojnë se gratë do të ndryshojnë mënyrën e kryerjes dhe përmbajtja e vetë politikës (gjë që është shumë e dëshirueshme në vendet në tranzicion e në zhvillim). Për këtë arsye, shumë feministe e kanë kombinuar argumentin e drejtësisë qëoftë me pritshmërinë se gratë mund ta transformojnë politikën, ose duke këmbëngulur se gratë janë të nevojshme për të përfaqësuar interesat e grave (Goetz, 2007).

### *Implikimet negative të një miti*

Pra, opinioni se gratë janë të pakorruptueshme nuk është veçse një mit, i cili, siç na thotë Goetz, dikur përdorej për t'i penguar gratë të përfshihen në politikë dhe që sot prezantohet si një vlerë që ato mund dhe duhet t'i sjellin shoqërive, veçanërisht atyre në tranzicion e zhvillim. Pakorruptueshmëria e tyre lidhet me ndershmërinë e tyre, që ka qenë një tipar i kërkuar dhe i vlerësuar, jo vetëm në rrafshin personal, por edhe atë të familjes, komunitetit, apo dhe vetë kombit. Ky konceptim dikur i bënte gratë të papërshtatshme për t'u angazhuar në sferën publike (Goetz, 2007). Por nëse dikur argumenti se gratë janë emotive dhe të ndjeshme, dhe në të njëjtën kohë simbol i ndershmërisë, i ka mbajtur ato jashtë sferës publike, sot ai përdoret si slogan për të promovuar nxitjen dhe pranimin e tyre në poste publike. Edhe pse në plan të parë, kjo mund të duket si pozitive, pasi lejon që gratë të konkurojnë për poste publike me vlera të ndryshme nga ato të burrave, dhe madje edhe të fitojnë, ekzistojnë dy implikime negative kryesore: ky mit përforcon stereotipet gjinore dhe është në thelb i padrejtë.

Propaganda që synon ta fusë gruan në sferën publike për shkak të moralit të saj prej gruaje, bën që gratë që vijnë në pushtet të jenë të kufizuara në angazhimet e tyre publike, sepse kërkon që ato të përmbushin pritshmëritë përse i përket këtyre vlerave, duke e kthyer ndjeshmërinë dhe ndershmërinë në vetë esencën e gruas. Si rrjedhim, edhe pse konsiderohen si pikat e forta të tyre, ndjeshmëria dhe ndershmëria kufizojnë edhe më tej sjelljen e grave në publik, duke i nxitur të riprodhojnë marrëdhëniet prej të nënshtruarash dhe të marrin përsipër të njëjtat detyra që kanë në sferën private. S'është çudi që gratë në vendimmarrje i gjen duke u marrë kryesisht me çështje që kanë të bëjnë me higjenën, shëndetin dhe edukimin, ndërkohë që janë pothuaj të padukshme në sektorët e tjerë të jetës publike. Me pak fjalë, rezultatet nuk janë ato që priten, sepse edhe pse nëpërmjet promovimit të "vlerave të tyre të

diferencuara" gratë mund të arrijnë të jenë të pranishme në sferën publike, kontributi i tyre është dhe do të jetë i ngushtë në fokus, dhe shpesh formal e simbolik.

Një situatë e tillë është e papranueshme. Ardhja e grave në pushtet dhe ndarja e posteve publike me burrat është një e drejtë të cilën ato duhet ta gëzojnë dhe shfrytëzojnë, pavarësisht nga tiparet dhe sjellja e tyre. E drejta e përfaqësimit është universale dhe duhet respektuar në rastin e grave si të kujtudo tjetër. Kështu që nëse duam të promovojmë fuqizimin e tyre dhe nxitjen e pjesëmarrjes në sferën publike, duhet t'i mbështesim qëndrimet tona në argumentin e drejtësisë së një akti të tillë, dhe jo të përdorim argumenta esencialistë dhe instrumentalistë si ai i moralit dhe ndershmërisë, të cilat ofrojnë një imazh të gruas dhe të kontributit të tyre në publik, të cilin nuk mund ta garantojnë.

Pjesëmarrja e më shumë grave mund të sjellë një numër domethënës përfitimesh për shoqërinë, por të mos harrojmë se ato janë të lidhura drejtpërsëdrejti me përfaqësimin e grave si grup shoqëror dhe i interesave dhe nevojave të tyre në vendimmarrje dhe se lidhja me pakësimin e korrupsionit është e tërthortë. Studime të ndryshme tregojnë se rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë vjen së bashku me pakësimin e korrupsionit, por kjo nuk do të thotë se kemi të bëjmë me një shkak (pjesëmarrja aktive e grave në politikë dhe jetën publike në tërësi) dhe një pasojë (pakësimi i korrupsionit), por me dy tregues të qartë të një demokracie të konsoliduar.

## **Gratë dhe korrupsioni në Shqipëri**

Argumentat kundër tezës së gratë janë më pak të korruptuara dhe të korruptueshme se burrat vlen edhe për rastin e Shqipërisë. Marrëdhënia e grave me pushtetin dhe korrupsionin në Shqipëri paraqet të njejtat probleme si ato të përmendura më lart. Edhe pse nuk ka ndonjë studim krahasimor mbi nivelin e korrupsionit midis burrave dhe grave, studime të ndryshme mbi pjesëmarrjen e gruas shqiptare në politikë dhe angazhimi i saj në jetën publike shpesh e kanë shpjeguar mospjesëmarrjen e grave në politikë si shprehje të vullnetit të tyre për të mos u përlyer e korruptuar nga "ndotja" që karakterizon politikën shqiptare në vitet e tranzicionit. Ky shpjegim është shoqëruar dhe me perceptimin se politika është pjesa më e korruptuar e shoqërisë shqiptare, e cila ka shkaktuar përhapjen e këtij fenomeni në të gjithë sektorët publike. Duke i besuar shprehjes "peshku qelbet nga koka", mendimi i shqiptarëve për politikën është se ajo i shpërftyron njerëzit duke i kthyer ata në të korruptuar.

Ky perceptim i politikës bie ndesh me imazhin e gruas në Shqipëri, si një figurë e pastër dhe si ruajtëse të moralit të vet dhe atë të familjes së saj. Sjellja e gruas pretendohet të jetë e papërlyer dhe e pakorruptuar, e për rrjedhojë ajo nuk e ka gjetur veten në politikën shqiptare dhe të shmangë postet publike drejtuese. Ky lloj justifikimi, ka pasur tri pasoja kryesore. Së pari, ka bërë që pjesëmarrja e grave në postet publike vendimmarrëse të jetë shumë e vogël. Duke qenë se perceptime të tilla për politikën dhe për gruan ndahen nga burrat dhe gratë e shoqërisë shqiptare, grave u ka munguar mbështetja nga familja dhe komuniteti për të ndjekur synime politike, dhe njëkohësisht kanë refuzuar të ndjekin synime të tilla. Nga ana tjetër, ato pak që kanë guxuar të angazhohen, nuk i kanë shpëtuar përkufizimit të mësipërm. Në fakt, e kanë zgjedhur atë imazh për garat e tyre politike, edhe në rastin e politikaneve të afirmuara, si kryetarja e parlamentit, Jozefina Topalli, e cila edhe pse deputete me një mandat të sigurtë që prej 1992, të cilin mund ta prezantonte së bashku

me punën e vet si pikën më të fortë në favor të kandidaturës së vet, në zgjedhjet e fundit e shoqëroi kandidimin e saj me një reklamë, që nxirrte në pah pozitën e saj prej gruaje dhe nënë të përkushtuar. Strategji të tilla të gabuara, të ndjekura dhe nga plot candidate të tjera femra në nivel qendror e lokal, u kanë kushtuar shumë atyre. Përforsimi i stereotipit gjinor nuk ka bërë gjë tjetër veç ta dobësojë pozitën e tyre si candidate për poste publike. Së treti, instrumentalizimi i imazhit të gruas nuk është përdorur vetëm për t'i promovuar ato. Në fakt, ai është përdorur më shumë për t'i kritikuar qëndrimet dhe vendimet e tyre, madje dhe vetë angazhimin e tyre në politikë dhe në sektorin publik. Komente të tipit "është edhe grua" kanë nënkuptuar se pritshmëria e opinionit publik dhe e personave të veçantë ka qenë që si gra, duhet të përmbushin pritshmëritë e rolit gjinor dhe se ato që janë korruptuar kanë vepruar kundër natyrës së gruas, duke u akuzuar se sillen "si burra".

Nga vetë nivelet e raportuara të korrupsionit në Shqipëri është e qartë se ky qëndrim nuk i ka shtrënguar gratë në poste publike të mos korruptohen. Nëse ka më pak gra të korruptuara, kjo vjen sepse ka më pak gra në poste publike, që mund të abuzojnë me pushtetin për përfitime personale. Në të njëjtën kohë, gratë kanë vuajtur pasojat e korrupsionit, që ka ndikuar në diskriminimin dhe marxhinalizimin e tyre më të madh, si edhe privimin nga një sërë shërbimesh, të cilat ligjërisht i ofron sektori publik për të gjithë, por që nuk mund të shfrytëzohen pa dhënë rryshfet. Së fundi, duhet të themi se lidhjet familjare në Shqipëri janë të forta dhe, në përputhje me argumentin e Alos për shoqëritë me strukturë patriarkale (2006), janë përdorur si forma presioni ndaj grave në poste publike, që i kanë shtyrë ato drejt korrupsionit.

Pasojat e korrupsionit rëndohen për gratë në Shqipëri, sepse ndryshimi i regjimit u krye nëpërmjet modelit ekonomik të terapisë së shokut, që u shoqërua me privatizime, të cilat bënë që shumë gra të humbnin punën e tyre në kompanitë shtetërore të fryra me personel, si edhe me një mungesë sigurie publike. Këto fenomene të tranzicionit shqiptar rezultuan në një tërheqje masive të grave nga sfera publike, që nënkuptoi jo vetëm mungesën e tyre në poste publike, por edhe mosdaljen e tyre në publik të pashoqëruara. Tërheqja fillestare nga sfera publike e imponuar nga kushtet e viteve 1990të me kalimin e kohës u konsolidua në ndërgjegjen qytare dhe u ka kushtuar shumë grave, sepse i përjashtoi nga rrjetet e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, qoftë edhe për çështje që u përkisnin atyre.

Marrëdhënia e tyre me institucionet gjithashtu u vështirësua nga informaliteti i marrëveshjeve, të cilat në Shqipëri bëhen kryesisht nëpër lokale, bare e kafene. Madje edhe vetë dhënia dhe kërkimi i rryshfetit në gjuhën e përditshme fshihet pas aluzionit të kafes ("merre një kafe nga unë", apo "më jep një kafe dhe u lamë"). Përfshirja e grave në këto situata është shumë e vështirë jo vetëm sepse ato kryhen në ambiente të tilla, të cilat nuk frekuentohen nga gratë, por edhe se vetë ideja që një grua të shkojë dhe të flasë me një punonjës shtetëror është e pakonceptueshme, pasi marrëveshje të kësaj natyre kërkojnë sipas mendësisë vendase praninë e një burri, duke qenë se gratë mund të vihen përballë kërkesave të pamoralshme për favore seksuale. Natyrisht kjo nuk i ka penguar persona të veçantë, që në pozita pushteti të mos abuzojnë me to. Gjithsesi fakti se gratë shqiptare janë në pozita më të kufizuara pushteti dhe mundësie për të abuzuar me të, nuk do të thotë se janë më pak të korruptuara apo korruptueshme se burrat, edhe pse nuk ka dyshime se ato janë ndër personat që e vuajnë më shumë atë.

## Përfundime

Ekziston një mit i mbështetur qoftë nga disa feministe, qoftë nga politikëbërësit dhe drejtuesit e politikave të zhvillimit, se gratë jo vetëm janë më pak të korruptuara se meshkujt, por edhe më pak të korruptueshme se ata. Ky argument ka baza esencialiste dhe instrumentaliste, pasi mbështet tezën se gratë në pushtet do të sillnin vlera të reja, të cilat do të kontribuonin në ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve demokratike, duke minimizuar fenomene negative si korrupsioni, dhe në të njëjtën kohë synon që nëpërmjet këtij arsytimi të fitojë mbështetjen e shoqërive, ku gruaja është e marxhinalizuar në sferën publike për të pranuar, lehtësuar dhe mundësuar ndarjen e pushtetit me drejtuese femra.

Edhe pse disa studime pohojnë se kanë arritur të vërtetojnë se gratë janë më pak të korruptuara se meshkujt, studime të tilla kanë probleme me përkufizimin e konceptit themelor, që është korrupsioni, si dhe për shkak të natyrës së tij kriminale, vështirësinë për ta matur atë me të dhëna të sakta. Vështirësia në vërtetimin e këtij miti vjen dhe prej faktit se nëse gratë janë më pak të korruptuara, kjo ndodh si pasojë e mungesës së aksesit të tyre në pushtet dhe konsolidimit të rrjetit femëror, që do t'i lejonte ta ridrejtonin pushtetin kah përfitimi personal. Për më tepër, duke qenë se shoqërimi i shumicës së grave është ndikuar nga faktorë socialë e kulturorë të caktuar dhe ka ndodhur në ambiente familjare jo-demokratike, mund të mendojmë se ato do të kenë prirje jodemokratike nëse vijnë në pushtet, ide e cila përforcohet më tepër nëse vetë ardhja e këtyre grave në pushtet nuk ka qenë demokratike.

Si rrjedhim, nëse vëmë re se në një shoqëri ku pjesëmarrja e grave në poste publike është e lartë dhe shoqërohet nga nivele të ulta korrupsioni, nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie shkak – pasojë, por me dy rezultate të një rendi demokratik, ku zbatohet drejtësia e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes për gjithë qytetarët dhe ku mbizotëron rendi ligjor. Për sa kohë vendet në zhvillim nuk e kanë arritur këtë, politikëbërësit do të vazhdojnë të përdorin argumenta të tillë instrumentalistë. E rëndësishme është të mos harrojmë se pjesëmarrja e grave në poste publike është një e drejtë në vetvete, pavarësisht ndikimeve dhe rezultateve që mund të sjellë kjo pjesëmarrje. Nga ana tjetër, fenomenet negative si korrupsioni duhen hetuar dhe zgjidhur duke pasur parasysh kompleksitetin e tyre dhe jo në bazë mitesh, edhe kur ato janë pozitive e dashamirëse.

## Bibliografia

Alolo, N. A. "Gendering Public Sector Corruption: Are Men from Mars and Women from Venus where this Vice is Concerned?". Paper presentet at PSA Women and Politics Conference, University of Edinburgh, 11.02.2006.

Chengu, I. Dhe Mukwamba, M. *Women and the Anti-Corruption Debate*. 11 prill 2004. Marrë nga [www.peacewomen.org/news/Zimbabwe/April04/corruption.html](http://www.peacewomen.org/news/Zimbabwe/April04/corruption.html) [parë për herë të fundit më 02 shtator 2008].

Council of Europe, PACO IMPACT. *Gender and Corruption in South East Europe: Making and Impact*. Economic Crime Division Directorate General I-Legal Affairs. 30 August 2004.

Danaj, S. "Qytetaret e Padukshme në Politikë: Gratë në Zonat Rurale". *Polis* 5. Tiranë: UET, 2008.

Dollar, D. Fisman, R. dhe Gatti, R. "Are Women Really the "Fairer" Sex? Corruption and Women in Government". Policy Research Report on Gender and Development, Working Paper Series, No. 4. October 1999.

- Ekonomi, M. Sokoli, L. Danaj, S. dhe Picari, B. *Përfaqësimi dhe Cilësia e Demokracisë në Shqipëri: Një Perspektivë Gjinore*. Tiranë: Pegi, 2006.
- Fofanah, M. *POLITICS-SIERRA LEONE: Women As An Antidote to Corruption?* 10 gusht 2007. Marrë nga AllAfrica.com në faqen [www.allafrica.com/stories/200708100887.html](http://www.allafrica.com/stories/200708100887.html) [parë për herë të fundit më 02 shtator 2008].
- Goetz, Anne-Marie: "Political Cleaners: How Women are the New Anti-Corruption Force. Does the Evidence Wash?", *Development and Change*, Volume 38, Number 1, January 2007, pp. 87-105(19)
- Kajsiu, B. "Në Rrënojat e Një Utopie: Përse Dështoi Anti-Korrupsioni." *Polis 6*. Tiranë: UET, 2008.
- Server, Ch. *BRIDGE. The Gender, Poverty, Governance Nexus: Key issues and current debates*. BRIDGE. September 2005. Marrë nga [www.dci.gov.ie/uploads/gender-poverty-governance.doc](http://www.dci.gov.ie/uploads/gender-poverty-governance.doc) [parë për herë të fundit më 02 Shtator 2008].
- SIDA, *Albanian Anti-Corruption Study*. December 2007 (revised January 2008).
- Steinem, G. "Women's Liberation Aims to Free Men, Too". *The Washington Post*. Sunday, June 1970.
- Shleifer, A. and Vishny, A. "Corruption" in Williams, R, ed. *Explaining Corruption*, (Cheltenham: Edward Elgar Publishing), 2000.
- Snitow, A: 'Feminist Futures in the Former East Bloc', *Peace and Democracy News*, Vol. VII No. 1, Summer 1993, p. 1, 40-44.
- Swamy, A., Knack, S., Lee, Y. dhe Azfar, O. "Gender and Corruption". *Journal of Development Economics*. Vol. 64, 2001. pp. 25-55.

## ARSYEJA QEVERISËSE DHE ARTI I QEVERISJES TEK MICHEL FOUCAULT

Muhamedin KULLASHI

**Abstrakt.** Në këtë studim do të orvatemi të shkoqisim disa aspekte të hulumtimeve të Foucault-së (Mishel Fuko) mbi lidhjet e shumta që sajohen midis pushtetit dhe dijes në periudhën e Mesjetës, Renesancës (Rilindja), periudhës klasike dhe modernitetit. Më konkretisht do të shqyrtojmë lindjen e konceptit dhe praktikës moderne të qeverisjes sipas Foucault-së. Në pjesën e parë të artikullit do të hedhim një vështrim të përgjithshëm tek kalimi gradual nga koncepti dhe praktika mesjetare e sundimit drejt konceptit dhe praktikës moderne të qeverisjes, çka shoqërohet edhe me lindjen e një koncepti të ri, atë të shtetit. Në pjesën e dytë do të përqendrohemi tek mënyra se si Foucault-ja e ka trajtuar konceptin e 'arsyes së shtetit' si reflektim dhe materializim i praktikës dhe entitetit të ri konceptual 'shtet'. Në pjesën e tretë do të ndalemi tek metodologjia e hulumtimit të Foucault-së për të kuptuar më mirë mënyrën se si Foucault-ja analizon 'vënien në skenë' të *arsyes së shtetit* në raport me një sërë konceptesh të tjera çka ravijëzon dhe sendërton edhe më qartë entitetin *shtet*. Këtë moment të sendërtimit të shtetit si një realitet objektiv në një kontekst të caktuar historik, epistemologjik dhe politik, gjithmonë sipas Foucault-së, do ta shtjellojmë me më hollësi në dy pjesët e fundit të punimit.

### Hyrje

**M**ichel Foucault është pamëdyshje një nga mendimtarët më të mëdhenj të shekullit të XX. Veprat e tij kanë ushtruar dhe vazhdojnë të ushtrjnë një ndikim të rëndësishëm në shumë vende, kryesisht në Francë, Gjermani, Itali, Angli, SHBA dhe Amerikë Latine. Frytshmëria e ndikimit të tij shfaqet jo thjesht në shtrirjen e vazhdueshme të pikëpamjeve të tij në disa kontinente, por me nxitjen e hulumtimeve shkencore në fusha të ndryshme (filozofi, histori, psikologji, sociologji, politikologji, antropologji, drejtësi, letërsi etj.), duke u nisur nga *problematizimi* i temave që ai kishte analizuar (çmenduria, pushteti, burgu, seksualiteti, urbanizmi, arti e letërsia, subjektiviteti). Sa për të ilustruar përmasat e këtij ndikimi, do të mjaftohemi këtu me një shembull që duket marginal në opusin e Foucault-së. Është fjala për analiza kritike të raporteve që thuren midis politikës dhe liberalizmit ekonomik në botën e sotme, të botuara në përmbledhjet e ligjëratave të mbajtura në *Collège de France*, *Siguria*, *Territori dhe Popullsia* (1977-1978) dhe *Lindja e biopolitikës* (1978-1979).<sup>1</sup> Këto ligjëratat do të jenë gurë frymëzimi, jo vetëm për simpoziume e botime të shumta në dy dekadat e fundit, por edhe për zhvillimin e një rryme të tërë hulumtimesh të quajtura "*governmentality studies*", që morën hov së pari në SHBA (Colin Gordon, Graham Burchell, Piter Millar), e më vonë edhe në



Angli (Michel Dean), Gjermani (Thomas Lemeke, Susanne Krasmann), e në Francë (Sylvain Meyet, Thomas Ribemont). Njësoj, edhe hulumtimet nga sociologjia e mjekësisë si edhe kërkimet juridike mbi të drejtën penale dhe institucionet penale shumë shpesh i referohen analizave të Foucault-së. E të mos flasim për kërkimet etike, e në veçanti temat e “bregës për vetë”, e subjektivitetit dhe procesit të subjektivimit.

Tipar karakteristik që shfaqet në shkrimet e Foucault-së, qysh herët, nga fusha e tema të larmishme, është *origjinaliteti* i theksuar. Origjinalitet ky që do të manifestohet te stili rrëmbyes i të shkruarit, te problemet e zgjedhura, shpesh të para si probleme e tema të padenja për mendimin filozofik, e në veçanti në mënyrën e trajtimit të tyre, te qasja karakteristike. Bukuria e stilit të Foucault-së shpërfaqet jo vetëm në shkrimet kushtuar letërsisë e artit (në veçanti pikturës), por edhe në ato ku trajtohet çmendia e çmendina, burgu dhe tortura. Mirëpo, kjo *bukuri e stilit*, që e ka bërë të vështirë punën e përkthyesve të teksteve të tij, nuk ka shërbyer për ta mbuluar cektësinë e mendimit, por i ka ndihmuar depërtimet e mendimit të tij në kapjen dhe ndriçimin e *përvojave* të pahetuara e të pahulumtuara të historisë e të shoqërisë evropiane. Veçantia e stilit, e metodave të kërkimit dhe qasjeve gërshetonin në vete elemente të dijeve nga fusha të ndryshme: ky gërshetim nuk ishte një lidhje mekanike e fragmenteve të njohurive të disiplinave të ndryshme në një kazan multidisiplinor, ngase ishte rezultat i një përpunimi të hollë të njohurive, përpunim që doli nga puna e zjarrtë e një mendimi vetanak.

Në këtë studim do të orvatemi të shkoqisim disa aspekte të hulumtimeve të Foucault-së mbi lidhjet e shumta që sajohen midis pushtetit dhe dijes në periudhën e Mesjetës, Renesancës (Rilindja), periudhës klasike dhe modernitetit. Më konkretisht do të shqyrtojmë lindjen e konceptit dhe praktikës moderne të qeverisjes sipas Foucault-së. Për këtë qëllim punimi është ndarë në pesë pjesë. Në pjesën e parë do të hedhim një vështrim të përgjithshëm tek kalimi gradual nga koncepti dhe praktika mesjetare e sundimit drejt konceptit dhe praktikës moderne të qeverisjes, çka shoqërohet edhe me lindjen e një koncepti të ri, atë të shtetit. Në pjesën e dytë do të përqendrohemi tek mënyra se si Foucault-ja e ka trajtuar konceptin e 'arësyes së shtetit' si reflektim dhe materializim i praktikës dhe entitetit të ri konceptual 'shtet'. Në pjesën e tretë do të ndalemi tek metodologjia e hulumtimit të Foucault-së për të kuptuar më mirë mënyrën se si Foucault-ja analizon 'vënien në skenë' të *arsyes së shtetit* në raport me një sërë konceptesh të tjera, çka ravijëzon dhe sendërton edhe më qartë entitetin *shtet*. Këtë moment të sendërtimit të shtetit si një realitet objektiv në një kontekst të caktuar historik, epistemologjik dhe politik, gjithmonë sipas Foucault-së, do ta shtjellojmë me më hollësi në dy pjesët e fundit të punimit.

## **Nga sundimi tek qeverisja**

Veçantinë e mënyrës së qeverisjes së shtetit, në fillimet e modernitetit, Foucault-ja e bën duke e krahasuar me funksionimin e pushtetit mbretëror në Mesjetë. Për këtë qëllim ai do të merrte parasysh tekstat politike të Saint Thomas Aquinas-it (Shën Thoma Aquinit). Dallimin midis pushtetit të sovranitetit, nga periudha klasike, dhe pushtetit të qeverisjes, që i takon modernitetit, Foucault-ja e shpreh edhe me termat “sundim” (*règne*) dhe “qeverisje” (*gouvernement*). Sundimi i sovranit është mbi të gjitha sundim mbi një territor, ndërkaq

*qeverisja* ka të bëjë me qeverisjen e njerëzve, nënshtrësit. Mirëpo, te Thomas Aquinas-i, Foucault-ja i has të dy termat, sadoqë është fjala për periudhën politike të mesjetës. Ky e përkufizon mbretin si "ai i cili qeverisë popullin e një shteti dhe të një krahine, gjithnjë duke patur parasysh të mirën e përbashkët".<sup>2</sup> Mirëpo, Foucault-ja vë në pah se brenda pikëpamjes së Aquinas-it nuk bëhet dallimi midis *sundimit* si ushtrim i sovranitetit të mbretit dhe *qeverisjes* së mbretit: këto nuk dalin përkaq specifika e tyre, si dy funksione të ndryshme. Për ta saktësuar idenë e vet mbi qeverisjen e sovranit, Aquinas-i bën disa analogji me modele jopolitike të qeverisjes. Qeverisja e mbretit krahasohet me qeverisjen e natyrës nga zoti, ajo do të jetë e mirë në atë masë sa do të jetë në gjendje të imitoj qeverisjen e zotit mbi natyrën. Analogjia shkon madje edhe më larg, ngase supozon se sikurse që zoti e ka krijuar natyrën, edhe mbreti apo monarku e themelojnë shtetin.<sup>3</sup>

Analogjia e dytë ka të bëjë me natyrën: natyra e kuptuar si forcë jetësore e një organizmi unik, forcë e cila drejton shumësinë e qenieve të veçanta natyrore drejt një të mire të përbashkët; në mënyrë analoge, mbreti me fuqinë e vet bën koordinimin e kahjeve të synimeve të veçanta të çdo individi kah e mira e përbashkët, duke e penguar shkapërderdhjen.<sup>4</sup>

Në saje të analogjisë së tretë, Aquinas-i e paraqet të ngajshëm funksionin e mbretit me atë të pastorit dhe të babait të familjes. Qëllimi i fundit i aktivitetit të të treve nuk është thjesht pasuria, shëndeti apo madje lumturia në jetën tokësore, por synimi nga lumturia e përjetshme në botën e ardhshme, ose "shpëtimi i përjetshëm" i individit (besimtari i pastorit, fëmija i babait apo nënshtrësi i mbretit). Këto tri analogji tregojnë vazhdimësinë e qeverisjes, duke filluar nga zoti, duke shkuar drejt natyrës, duke arritur te pastori dhe babai si kreu i familjes.<sup>5</sup>

Foucault-ja në analizat e veta tani vë në pah se kah mbarimi i shekullit të XVI dhe fillimi i shekullit të XVII do të paraqitet një *shkëputje* midis vazhdimësive të përmendura: kështu *qeverisja* e mbretit do të dalë gradualisht si trajtë e ndryshme jo vetëm nga qeverisja e zotit mbi natyrën, por edhe nga qeverisja e besimtarëve nga pastori, nga qeverisja e familjes nga babai, si edhe nga *ushtrimi i sovranitetit* nga mbreti. Së këndejmi, qeverisja e mbretit tani nuk do të ketë më si model qeverisjet e tjera, por do të zhvillohet sipas tipareve të veta specifike: kjo qeverisje do të artikullohet sipas rregullave dhe parimeve të *artit të qeverisjes (l'art de gouverner)*.<sup>6</sup>

Për Foucault-në, në mbarim të shekullit të XVI, çështja themelore për mendimin politik, do jetë me çfarë racionaliteti do të ushtrohet qeverisja apo ç'është arti i qeverisjes? Si rezultat i këtij kërkimi, që bëhej në drejtime të ndryshme, doli koncepti i *arsyes së shtetit (ratio status)*. Rrethanat historike, sociale e politike të paraqitjes së këtij koncepti të ri janë tejet komplekse. Foucault-ja përkujton se, veç të tjerash, paraqitja e këtij koncepti përputhet me shkëputjen, pas bashkekzistencës shumëshekullor, të lidhjes midis të kuptuarit të natyrës dhe qeverisjes politike. Shkëputjen e kësaj lidhje Foucault-ja e shpjegon me zbulimet shkencore në fushën e astronomisë (Copernicus e Keppler), në fushën e fizikës mekanike (Galileo) dhe në fushën e historisë natyrore (John Ray). Këto hulumtime të reja bën që natyra të shpjegohet jo me si një qeverisje e vazhdueshme nga zoti, por me parimet e arsyes, të përkufizuara nga njohuritë e reja shkencore.<sup>7</sup>

Përkufizimin e parë të *arsyes së shtetit* Foucault-ja e gjen te Giovanni Botero, në veprën

e tij *Arsyeja dhe qeverisja e shteteve* (Milano, 1598). Këtu Botero-ja e përkufizon shtetin jo si sundim mbi një territor, por si “një sundim të fortë mbi njerëzit”, ndërkaq arsyen e shtetit si “njohje të mjeteve që e bëjnë të mundur themelimin, mbajtjen dhe zgjerimin e një sundimi të tillë”.<sup>8</sup> Kjo domethënie e gjerë dhe komplekse është shumë e ndryshme nga domethëniet e ngushta që do t'i jepen këtij termi nga disa qarqe politike, më vonë, rëndom si argument i cili duhet të arsyetojë *dhunën* dhe *arbitraritetin* e shtetit. Megjithë gjerësinë që kishte ky nocion krejt i ri, ai shkaktoi reagime dhe kritika të ashpëra që vinin sa nga qarqet kishtare aq edhe nga ato politike. Madje, Foucault-ja konstaton, në saje të analizës së literaturës historike të fundit të shekullit të XVI, se zbulimi i këtij koncepti shkaktoi skandal të njëjlojt me atë që kishin shkaktuar zbulimet shkencore të Galileo-ut. Kështu papa Pie i V, asokohe e cilësoi arsyen e shtetit (*ratio status*) si “arsye e djallit” (*ratio diaboli*).<sup>9</sup> Një autor i kësaj kohe, at Clement-i, në librin e tij *Makiavelizmi i mbytur* e cilëson këtë orientim të “sektit të politikanëve” si “statolatri”, si njerëz që shtetin dhe interesat e tij i kanë “hyjni e vetme”.<sup>10</sup>

Ndonëse një literaturë e tërë e kësaj kohe e lidh qasjen e arsyes së shtetit me emrin e Machiavelli-t dhe e shikon makiavelizmin të përcaktuar me arsyen e shtetit, e cila nuk përfill vlerat morale dhe fetare, Foucault-ja mendon se “arsyeja e shtetit” si koncept, i cili do të duhej të përmbante racionalitetin e artit të qeverisjes, nuk është i pranishëm në mendimin e Machiavelli-t. Foucault-ja pohon se te Machiavelli nuk mund të gjendet arti i qeverisjes, ngase ai nuk është i preokupuar me racionalitetin e mbajtjes së shtetit, por me “raportin e princit ndaj territorit dhe popullsisë së tij. E kjo është diçka krejt tjetër”.<sup>11</sup> Këtu vetëm mund të themi se ky interpretim është i ndryshëm nga ai i Claude Lefort-it. Por lidhur me dallimet midis këtyre dy interpretimeve, sa i takon Machiavelli-it, do bëjmë fjalë më vonë. Tani të shohim se si Foucault-ja vazhdon të zhvilloj pikëpamjen e vet mbi paraqitjen dhe formimin e konceptit të arsyes së shtetit.

Ndërsa disa bashkëkohës nuk e hetuan risinë themelore të konceptit të arsyes së shtetit, Foucault-ja gjen autorë politik që e kanë hetuar mirë këtë risi. Kështu bie fjala, juristi gjerman von Chemnitz-i në veprën e vet kushtuar arsyes së shtetit shkruante më 1640: “Matematikanët modern kanë zbuluar me syzat e tyre yje të reja në gjithësi dhe njollat e diellit. Politikanët e rinj kanë patur syza të njëjta, me anë të të cilave kanë zbuluar atë që të Moçmit nuk njihnin apo e kishin fshehur nga ne me aq kujdes”. Foucault-ja thekson se Chemnitz-i e nënvizon kështu risinë e këtij “instrumenti intelektual absolutisht të ri për të detektuar dhe analizuar” fenomene politike.<sup>12</sup>

Në shumicën e teksteve të kësaj periudhe ku kritikohen idhëtarët e arsyes së shtetit përdoret termi “politikanë” për të emërtuar njerëzit që kanë të përbashkët një pikëvështrim mbi qeverisjen politike, mbi racionalitetin e qeverisjes, i ndryshëm nga ushtrimi i sovranitetit. Këta i cilësonin ndonjëherë si “sekt”, duke dashur kështu të ceket karakteri gati heretik i bindjeve të tyre politike. Mirëpo, siç thekson Foucault-ja, në këtë kohë (mbarimi i shekullit të XVI dhe fillimi i shekullit të XVII) nuk përdoret ende termi “politikë” për të emërtuar një fushëveprim të caktuar. Termi “politika” si fushë apo si tip i aksionit paraqitet në mjedis të shekullit të XVII. Kështu, Bossuet në veprën e tij *Politika e nxjerr nga Shkrimi i Shenjtë* (1709) me termin “politikë” nuk emërton diçka heretike a djallëzore, por një aktivitet që ka një vlerë pozitive, në kohën e sovranitetit të monarkisë absolute franceze.<sup>13</sup> Foucault-ja e sheh, në këtë kontekst,

rolin e Luigjit të XIV si tejet të rëndësishëm ngase se ky ia doli të fusë arsyen e shtetit brenda trajtave të përgjithshme të sovranitetit. Ai arriti ta bëjë të dukshme, edhe përmes ritualeve monarkike, lidhjen dhe njëherit dallimin "e nivelit, dallimin e formës, specifikën e sovranitetit dhe të qeverisjes".<sup>14</sup>

Në këto shqyrtime mbi rrethanat e paraqitjes së kategorisë së re të arsyes së shtetit, Foucault-ja e sheh të udhës që të ritheksoj veçantinë e qasjes së vet ndaj shtetit, në dallim nga teoritë e tjera filozofike. Duke pohuar se lindja e konceptit të ri të arsyes së shtetit përputhet me një realitet të ri politik, Foucault-ja nuk dëshiron të pohoj se shteti, si tërësi e institucioneve, ka lindur në këtë mbarim të shekullit të XVI. Ato ishin të organizuara, kur është fjala për shtetin francez që nga koha e mbretit François I (1494-1547). Mirëpo, për Foucault-në risia qëndron në faktin se në kohën e paraqitjes së nocionit të arsyes së shtetit, shteti nisë të "projektohet, programohet, zhvillohet brenda kësaj praktike të vetëdijshme të njerëzve". Për të, është me rëndësi të kapet momenti kur shteti bëhet "objekt i njohjes dhe analizës", momenti kur ai "hyn brenda një strategjie të menduar", brenda "një fushe të praktikës dhe të menduarit të njerëzve".<sup>15</sup>

Në qasjen e vet Foucault-ja përpiket të vendos lindjen e shtetit, si çështje kyçe politike, "brenda një historie më të përgjithshme, brenda historisë së qeverishmërisë" apo brenda "fushës së praktikave të pushtetit". Ndaj kritikave që i ishin drejtuar pikëpamjes së tij mbi pushtetin si "një ontologji e brendshme dhe qarkore e pushtetit, Foucault-ja përgjigjet duke kritikuar qasjen, e cila, duke shtjelluar shtetin si "një entitet" që ka origjinën dhe zhvillimin e vet në histori, pikërisht bën një ontologji të shtetit.<sup>16</sup> Përkundrazi, Foucault-ja është prirur që shtetin ta kuptoj si një tip i qeverishmërisë, si mënyrë të qeverisjes. Mu për këtë ai e shikon shtetin jo si entitet të gatshëm, me një bërthamë paraprake, por si prodhim gradual i "një shumësie procesesh, shumë të ndryshëm njeri nga tjetri, e të cilët koaguloohen dhe sajajnë efekte". Për Foucault-në "shteti nuk është një peripeci e qeverisjes, e qeverisja nuk është një instrument i shtetit".<sup>17</sup>

## Arsyeja e shtetit

Për ta shqyrtuar më hollësisht kategorinë e arsyes së shtetit, ashtu si u sajua në mbarim të shekullit të XVI dhe në fillim të shekullit të XVII, Foucault-ja do të marr në shqyrtim disa përkufizime e analiza të kësaj kategorie te disa autorë italianë, francez, gjerman e anglez. Nga autorët italian të asaj kohe, ai do të analizojë veprën e Giovanni Palazzo-s, *Ligjëratë mbi qeverisjen dhe arsyen e vërtetë të shtetit*, e botuar me 1604-n. Pasi të ketë zbërthyer veç e veç disa domethënie të termave "arsye" (esencë e një gjëje, ajo që bashkon të gjitha pjesët e saj, por edhe si fuqi e shpirtit që bën të mundur njohjen e të vërtetës) dhe "shtet" (Etat) (domen, tërësi e ligjeve, një status profesional dhe stabiliteti i një gjëje), Foucault-ja shtron një përkufizim të dyfishtë (objektiv e subjektiv) të arsyes së shtetit te Palazzo si tërësi e kushteve që të mbahet integriteti i republikës dhe si "regull apo si art, i cili na bën të mundur të njohim mjetet për ta fituar integritetin, qetësinë apo paqën e republikës".<sup>18</sup>

Tipari kryesor shquës i këtij përkufizimi, për Foucault-në, ka të bëjë me faktin se të kuptuarit e shtetit nuk i referohet më as rendit hyjnor e as rendit natyror, por vetëm vetë

shtetit. Tiparin tjetër Foucault-ja e sheh në mbështetjen e arsyes së shtetit mbi raportin esenca-dija: ajo është vet esenca e shtetit e njëherit dije mbi atë që shquan shtetin. Në tiparin e tretë Foucault-ja heton se theksi vihet te *mbajtja* apo *ruajtja* e shtetit në integritetin e tij, e nuk bëhet fjalë për *transformimin* e mundshëm të tij, por vetëm për "ritën" e tij.<sup>19</sup> Kështu, arsyeja e shtetit përkufizohet në aspektin konservator. Në mënyrë të ngjashme, te juristi gjerman Chemnitz, arsyeja e shtetit përkufizohet si "një konsideratë politike që duhet patur në të gjitha çështjet publike, në të gjitha këshillat dhe qëllimet, e cila duhet të synojë vetëm ruajtjen, traditat dhe lumturinë e shtetit".<sup>20</sup> I vetmi element i ri që paraqitet në këtë përkufizim të Chemnitz-it është "lumturia", mirëpo Foucault-ja vëren se lumturia për të cilën bëhet fjalë aty i referohet kryekëput vet mbretit. Risinë e këtij pikëshikimi mbi shtetin, Foucault-ja e vë në pah në sajë të krahasimit me atë të Thomas Aquinas-it. Te Aquinas-i qeverisja mbretërore ka të bëjë me një mjeshtri (art) tokësor, por qëllimi i saj kapërcen horizontin e shtetit ngase është i drejtuar nga "lumturia e përjetshme" e botës së ardhshme, pra nga një "qëllim jashtë-tokësor e jashtë-shtetëror".<sup>21</sup>

Një veçori tjetër të rëndësishme që Foucault-ja e heton brenda pikëpamjes së Palazzo-s mbi shtetin i përket të kuptuarit të ri të kohës dhe kohësisë historike e politike. Koha e qeverisjes del si kohë e papërcaktuar apo si e pakufijshme; aty nuk shtrohet pyetja e origjinës së shtetit dhe themelimit të tij, por vetëm ajo e mbajtjes së vazhdueshme të tij. Aspektin tjetër të kësaj kohësie të re politike Foucault-ja e vëren te mungesa e një pikëmbërritjeje të fundit. Ndërkaq, në mesjetë, koha historike e një perandorie të krishterë, në mbarimin e saj, përfytyrohej të takohet me përjetësinë, të paralajmëruar me riparaqitjen e Krishtit. Pra, qeverisja nuk shihej si e pakufishme në kohësinë historike. Ndryshe nga kjo pikëpamje, projektet politike të "paqës së përjetshme" midis *shumësisë* së shteteve, që duhej të mbanin një drejtpeshim, kishin parasysh jo përjetësinë e botës së ardhshme, por vazhdimësinë dhe stabilitetin e kohës historike-tokësore.<sup>22</sup>

Duke dashur të vendosë arsyen e shtetit brenda një horizonti më të gjerë Foucault-ja shqyrton tiparet karakteristike të qeverisjes së njerëzve siç zhvillohen në kohën e shfaqjes së arsyes së shtetit. Siç analizoi më parë raportet mes qeverisjes pastorale dhe problemit të *shpëtimit* shpirtëror, problemit të *dëgjueshmërisë* (të të bindurit) dhe problemit të së *vërtetës*, tashmë Foucault-ja do të shqyrtojë relacionet që zhvillohen midis këtyre çështjeve dhe arsyes së shtetit. Për ta analizuar raportin që tani arsyeja e shtetit do ta ndërtojë me çështjen e shpëtimit, Foucault-ja zgjedh veprën e Gabriel Naudé-së (Node), me titull *Shqyrtime politike mbi grusht shtetet* (1639). Grushti i shtetit, në mendimin politik të kësaj kohe, nuk kuptohej si përmbysje e një mbreti, si uzurpim i pushtetit të tij nga dikush tjetër, por më shumë si suspendim i ligjeve në fuqi. Kjo ide përputhej me të kuptuarit e arsyes së shtetit si ndërpreje e vlerës "e të gjitha ligjeve, të veçanta, fundamentale, të ciltdo lloji që të jenë". Kështu arsyeja e shtetit del si fuqi që i komandon vet ligjet. Në interpretimin e Foucault-së grushti i shtetit nuk shkëputet nga arsyeja e shtetit: "Përkundrazi ai është një element, një ngjarje, një mënyrë e të bërit, e cila regjistrohet tërësisht brenda horizontit të përgjithshëm, brenda formës së përgjithshme të arsyes së shtetit, do të thotë diçka që kapërcen ligjet apo së paku që nuk i nënshtrohet ligjeve".<sup>23</sup>

Megjithëkëtë, për Foucault-në grusht shteti nuk është thjesht një shfaqje e arsyes së

shtetit, ngase ka specifikën e vet. Këtë specifikë ai e vë në pah duke i saktësuar disa tipare të arsyes së shtetit, në veçanti raportin e saj ndaj ligjeve. Arsyeya e shtetit, rëndom, duhej të respektonte ligjet në fuqi, ligjet publike, por dhe ato morale, natyrore e hyjnore. Mirëpo, në disa momente të caktuara të historisë politike, të cilësuar me urgjencë e rreziqe, arsyeja e shtetit mund të veproj duke mos i marr parasysh ato ligje. Argumenti, në emër të të cilit shteti, në situata të tilla, i linte anash ligjet, ishte argumenti i *shpëtimit*, jo të shpirtit, por të shtetit.<sup>24</sup> Kështu Naudé-ja, e shpjegon kriterin me të cilin arsyeja e shtetit vendosë të veprojë, pa i përfillur ligjet, jo në sajë të "drejtësisë natyrore e universale", por me "një drejtësi artificiale, të veçantë, politike [...] që i referohet domosdoshmërisë së shtetit".<sup>25</sup> Ç'është e vërteta, mendimtarët modern të politikës, si Hobbes-i, e shikonin shtetin dhe ligjet jo si shprehje të vullnetit hyjnor apo të një rendi kosmik, por si prodhime artificiale, si *artefact*. Edhe te autorë të tjerë të kësaj kohe Foucault-ja gjen mbështetjen e arsyeshmërisë së arsyes së shtetit te kategoria e domosdoshmërisë. Fjala vjen, Le Bret në veprën *Mbi sovranitetin e mbretit, mbi fushën e tij dhe mbi kurorën e tij* (Paris, 1632) shkruan kështu:

"Aq e madhe është forca e domosdoshmërisë saqë, si një perëndeshë sovrane, duke mos patur asgjë tjetër të shenjtë veç vendimeve të veta të parevokueshme, ajo i vë nën pushtetin e vet çdo gjë hyjnore e njerëzore. Domosdoshmëria i bën ligjet memece. Domosdoshmëria bën të pushojnë të gjitha privilegjet dhe të gjithë i detyron të binden".<sup>26</sup>

Nocioni tjetër i rëndësishëm në të kuptuarit e kategorisë së arsyes së shtetit është nocioni i dhunës. Foucault-ja thekson se arsyeja e shtetit, ashtu si kuptohej nga klasikët e modernitetit, rëndom funksiononte në mbështetje të ligjeve, do të thotë në mënyrë të padhunshme. Mirëpo, në situata të jashtëzakonshme, kur çënohen interesat e shtetit, arsyeja e shtetit manifestohet si grushtet e shtetit, në kuptimin që e përmendëm më sipër. Do të thotë se në raste të tilla shteti do ta konsideroj legjitim përdorimin e dhunës, e cila ka për qëllim ta shpëtoj shtetin. Klasikët bënë lidhur me këtë problem, dallimin midis dhunës, e cila konsiderohej mjet i arsyeshëm i shtetit në disa situata, dhe brutalitetit, si shprehje e tekave personale të sundimtarit.<sup>27</sup>

### Horizonti tragjik i politikës dhe tragjedia

Filozofi japonez Mariaki Watanabe, specialist i teatrit francez, në një bisedë me Foucault-në, të mbajtur në vitin 1978 në Tokio, e ngre çështjen e përsëritjes dhe riparaqitjes së shpesht të temës së *shikimit* dhe të teatrit në tekstet e Foucault-së.<sup>28</sup> Foucault-ja pajtohet se këto tema janë të rëndësishme për mendimin e tij dhe shpreh keqardhje pse filozofia, pas dënimit të teatrit nga Platoni, nuk u interesua fort për teatrin. Në përpjekjet e tij për të rivendosur lidhjet midis filozofisë dhe teatrit, ai u frymëzua nga Nietzsche (Niçe). Për filozofinë, sipas Foucault-së, përherë ka qenë e rëndësishme çështja e domethënies së shikimit mbi gjërat, ajo që shikohet është e vërtetë apo iluzion, a jemi në një botë reale apo në një botë iluzore, të rreme. Këto dallime janë të rëndësishme për filozofinë, por jo edhe për teatrin: "Nuk ka

kuptim të shtrohet çështja se a është teatri i vërtetë, a është real, apo është iluzor, apo është i rremë; vetë shtrimi i kësaj çështjeje e bën të zhduket teatri. Të pranosh mosdallimin midis të vërtetës dhe të pavërtetës, midis reales dhe iluzores është kushti i funksionimit të teatrit".<sup>29</sup> Foucault-ja thekson këtu se njëri nga synimet e shkrimit të tij ishte:

"Të përshkruajë mënyrën se si njerëzit e Perëndimit i kanë parë gjërat pa e shtruar asnjëherë çështjen nëse kjo ishte e vërtetë apo e pavërtetë, të përpiqem të përshkruajë mënyrën se si ata vet kanë ngritur, në saje të lojës së shikimit, spektaklin e botës [...] mua më intereson se si është vënë në skenë sëmundja, se si është vënë në skenë çmenduria, si është vënë në skenë krimi, fjala vjen, do të thotë si e kanë parë, si e kanë pranuar, çfarë vlere i kanë dhënë çmendurisë, krimin, sëmundjes, çfarë roli i dhanë të luajë; do të dëshiroja të bëj një histori të skenës, mbi të cilën, më vonë, janë orvatur të bëjnë dallimin midis të vërtetës dhe të pavërtetës, por nuk është ky dallim që më intereson, por është konstituimi i skenës dhe teatrit. Është teatri i të vërtetës ai që do të doja ta përshkruaj. Në ç'mënyrë Perëndimi ka ndërtuar një teatër të të vërtetës, një skenë të të vërtetës, një skenë për këtë racionalitet, i cili është bërë tani si një shenjë e imperializmit të njerëzve të Perëndimit, sepse ekonomia e tyre, ekonomia perëndimore, ndoshta ka arritur pikën e vetë të fundit, thelbi i trajtave të jetës dhe të dominimeve politike të Perëndimit ka arritur pa mëdyshje mbarimin e vet. Mirëpo, ka diçka që ka mbetur, që perëndimi gjithësesi ia ka lënë botës, e kjo është një formë e racionalitetit. Kjo është një trajtë e perceptimit të vërtetës dhe gabimit, është ky një teatër i të vërtetës dhe të pavërtetës".<sup>30</sup>

Watanabe e shikon shkrimin e Foucault-së të organizuar në mënyrë shumë dramaturgjike, ngase siç shkruan vetë Foucault-ja është e nevojshme "të dallohen ngjarjet, të dallohen rrjetet dhe nivelet të cilave ato i takojnë, dhe të ripërtrihen fijet që i lidhin dhe i bëjnë të prodhohen njëri nga tjetri". Watanabe e çmon epërsinë që Foucault-ja i jep një historiciteti të përcaktuar nga luftërat e konfliktet, nga raportet e forcave, relacionet e pushtetit e jo nga "një model i madh i gjuhës dhe shenjave". Ngjashmërinë e shkrimit të Foucault-së me shkrimin e Racine-it në tragjeditë e tij, Watanabe e sheh në faktin se edhe "strategjia e pasionit rasinian është krejt luftarake". Ngjashmërinë e shikimit të Foucault-së me gjenin e madh të dramaturgjisë klasike franceze, Watanabe e sheh në faktin se ai gjithashtu ia del "të bëjë të shpërthejnë këto përplasje të mëdha historike, të cilat, deri më tani, mbeteshin të pavrejtura apo të panjohura".<sup>31</sup>

Foucault-ja përkujton se tema e ngjarjeve historike, e lënë anash nga filozofia tradicionale, është futur brenda mendimit filozofik nga Nietzsche, i cili "e përkufizoi filozofinë si aktivitet që shërben të njoh atë që po ndodh, dhe atë që po ndodh tani. Me fjalë të tjera, ne jemi të kapluar nga procese, lëvizje e forca; këto procese dhe forca, ne nuk i njohim, dhe roli i filozofit është që të jetë diagnostik i këtyre forcave, të diagnostifikojë aktualitetin".<sup>32</sup> Më pastaj, Foucault-ja shfrytëzon rastin të saktësojë dallimin midis filozofisë bashkëkohore dhe asaj tradicionale edhe përmes dallimit të pyetjeve që ato shtrojnë. Derisa për filozofinë bashkëkohore, si filozofi e të tashmes dhe ngjarjes, janë qënësore pyetjet "kush jemi ne?

Dhe ç'po ndodh?", filozofia tradicionale pyeste "ç'është shpirti? ç'është përjetësia?". Këtu Foucault-ja e sheh edhe ngjashmërinë me teatrin, që synon të kapë një ngjarje dhe ta vërë në skenë.<sup>33</sup>

Në pika shumë të rëndësishme të veprave të veta, Foucault-ja ngre skena brenda të cilave luhet një ngjarje e rëndësishme për problemin të cilin ai e shqyrton. Kështu, njëra nga veprat më të rëndësishme të tij, *Të mbikëqyrësh dhe të ndëshkosh*, hapet me një skenë teatrale të torturës dhe ekzekutimit të vrasësit të mbretit Luigji të XIII, me 1757, para portës kryesore të Kishës së Parisit. Këtë skenë të ndëshkimit, Foucault-ja e rindërton në sajë të dokumenteve të arkivës. Roli i saj është që të nxjerrë në shesh disa tipare karakteristike të funksionimit të pushtetit të sovranitetit mbretëror. Edhe skena që e kemi përmendur më sipër të *Pushteti psikiatrik*, lidhur me mbizotërimin e mbretit anglez Georges III, në spitalin psikiatrik, nga një infermier, ka për qëllim të shpjegoj kalimin prej procedurave të pushtetit të sovranitetit kah metodat e pushtetit disiplinor, që nisin të zhvillohen qysh prej shekullit të XVIII. Veç të tjerash, veprat e Foucault-së i kundrojnë ngjarjet që zhvillohen brenda skenave të mbyllura, në çmendina, burgje, spitale, uzina, kazerma, e sidomos dispozitivat e pushtetit dhe relacionet e pushtetit dhe dijes brenda tyre. Bie në sy, megjithatë, një kontrast i theksuar midis asaj që Foucault-ja përmend këtu, sikurse edhe në tekstin mbi Kant-in dhe iluminizmin, lidhur me vokacionin e mendimit të tij që të ballafaqohet me aktualitetin e së tashmes, e në anën tjetër, me prirjen e hulumtimeve të tij që, në shumë tekste, të merret me ngjarje e procese të së kaluarës. Në dallim nga librat dhe shumica e ligjëratave, intervistat i referohen më shpesh ngjarjeve të së tashmes dhe bëjnë lidhjen me analizat e së shkuarës. Mirëpo, nuk mund të mohohet fakti se analizat e tij gjenealogjike për të shkuarën nisen prej pyetjeve mbi të tashmen, mbi relacionet e pushtetit dhe dijes sot.

T'i kthehemi tani analizës së arsyes së shtetit tek *Siguria, Territori dhe Popullsia* dhe krahasimit të grusht shtetit me praktikën teatrale. Në mënyrë që efektet e grusht shtetit të jenë më mbresëlënëse dhe më efikase, qeveritarët përgatisnin një skenë në të cilën duhet të shfaqej në mënyrë të rrëmbyeshme arsyeja e shtetit, vullneti i tyre i prerë dhe vendimet e pakontestueshme. Foucault-ja përmend si shembuj të vënies në skenë të arsyes së shtetit përmes grusht shtetit, disa aksione politike të Luigjit të XIII ndaj kundërshtarëve të tij.<sup>34</sup> Këtu shtrohet tani problemi i praktikës teatrale në politikë ose teatralizimi i aksioneve të shtetit dhe sovranit. Foucault-ja bën dallimin midis ceremonive tradicionale mbretërore si shenjtërimi, kurorëzimi apo funerali i sovranit, që shënojnë lidhjen e pushtetit mbretëror me pushtetin fetar e teologjinë, dhe me "këtë lloj teatri modern në të cilin shfaqet dhe mishërohet mbretëria, dhe ku praktika e grushtit të shtetit, e bërë nga vetë sovrani, është njëra nga shfaqjet më të rëndësishme".<sup>35</sup>

Më tej, Foucault-ja ndalet në shtjellimin e domethënies së karakterit politik të teatrit klasik, duke marrë si shembuj veprat e Racine-it (Rasin), Corneill-it (Kornej) si edhe ato të Shakespeare-it (Shekspirin). Ai pohon se veprat e Racine-it si *Andromaque*, *Atalie* e madje edhe *Bérénice* shpalosin, në mënyrë dramatike, disa grushte shteti: "ashtu si në politikë arsyeja e shtetit shfaqet përmes teatralitetit, edhe teatri, nga ana tjetër, organizohet rreth paraqitjes së arsyes së shtetit në trajtën e saj dramatike, intensive dhe të dhunshme të grushtetit". Oborin mbretëror të Luigjit të XIV, Foucault-ja e kundron si pikëlidhje midis një vendi ku



teatralizohet arsyeja e shtetit në trajtë të "intrigave, ndëshkimeve, zgjedhjeve, përjashtimeve, egzileve, dhe pastaj oborri po ashtu si vend ku pikërisht teatri do ta paraqesë vetë shtetin".<sup>36</sup> Luigji i XIV, në fakt, i porosiste autorët si të tragjediive, Racine-in dhe Corneill-in, edhe ata të komedive, si Molliere (Molieri), që të bënin shfaqje për të dhe mbi të. Këto pjesë shfaqeshin në oborrin e tij dhe ofronin jo një pasqyrim të thjeshtë të ngjarjeve e konflikteve aty, por një transponim artistik të tyre.

Foucault-ja hap një aspekt tjetër të shqyrtimit të relacioneve që u sajuan midis teatrit klasik dhe historisë politike në shekullin e XVII, në periudhën midis përfundimit të luftërave fetare në Francë, në njerën anë dhe në anën tjetër me nisjen e Luftës Tridhjetëvjeçare (midis Francës, Anglisë, Spanjës, Holandës) dhe kërkimin e një ekuilibri gjeopolitik midis fuqive të mëdha evropiane. Ky dramatizim i historisë politike bëhej në kohën kur "shembej uniteti gati perandorak i gjithësisë, në epokën kur natyra çdramatizohej, çliruhej nga ngjarja, nga tragjika". Ajo që cilëson risinë e historisë politike të modernitetit është "perspektiva e të qeverisurit të pakufishëm, perspektiva e vazhdimësisë së shteteve që nuk do të kenë as qëllim të fundit e as mbarim". Arsyeja e shtetit, e cila do të shfaqet në situata të jashtëzakonshme me grushte shteti, që mëtojnë t'i bëjnë ballë rreziqeve e sfidave për vet ekzistencën e shtetit, do të shpalosen tani në një "horizont të ri tragjik të politikës dhe të historisë". Kështu, grusht shtetin, si shfaqje të veçantisë dhe fuqisë së arsyes së shtetit, Foucault-ja e shikon si "përmbushje të tragjikes në një skenë që është vet realiteti". Naudé-ja e paraqet këtë grusht shteti edhe përmes metaforës së "rrefesë e cila godet, edhe pa e dëgjuar bubullimën e saj në re".<sup>37</sup> Pra, grushti i shtetit del si një trajtë e *shpëtimit* në raport ndaj shtetit.

### *Bindja dhe Arsyeja e shtetit*

Ndërkaq, çështjen e dëgjueshmërisë Foucault-ja e trajton nga një aspekt tjetër dhe duke u nisur nga tekstet e filozofit anglez Francis Bacon (Bekon). Është fjala kryesisht për tekstin e Bacon-it *Ese mbi kryengritjet dhe çrregullimet*. Këtu Bacon-i i trajton kryengritjet jo si ngjarje të jashtëzakonshme, por si dukuri gati të natyrshme që cilësojnë jetën e shteteve. Ai merret me analizën e shenjave paralajmëruese të shtrëngatave. Këto shenja i ndanë përkah burimi i tyre: disa vijnë nga poshtë, gjegjësisht nga populli e të tjerat vijnë nga lart, nga qarqet e të pasurve dhe të fuqishmëve. Për të përvijuar kryengritjen ai përdor edhe imazhin e shtrëngatës së detit, e cila ngjet në momente të papritura, duke shpërthyer në kohë të qetësisë. Sikurse zhurma e valëve paralajmëron shtrëngatën, edhe pamfletet me kritika të shtetit dhe të qeveritarëve, si shenja nga poshtë, paralajmërojnë kryengritjen. Shenjat e tjera paralajmëruese shfaqen në vlerësime negative mbi veprimet e qeveritarëve, madje edhe kur këto janë të qëlluara. Për Bacon-in njera nga këto shenja ka të bëjë me funksionimin e dobët të raportit midis atyre që komandojnë dhe atyre që duhet të zbatojnë urdhërat.<sup>38</sup>

Ndërkaq shenja dalluese nga lartë ka të bëjë me veprimet e të mëdhenjëve, që i përkasin oborrit mbretëror, veprime që nuk janë shprehje e urdhërave të sovranit, por që dalin nga interesat e tyre të veçanta. Foucault-ja zë në gojë këtu një imazh, që e gjen te Bacon-i, për të ilustruar këtë çrregullim: "Në vend që, siç thotë Bacon-i, të jenë si planetet që lëvizin me shpejtësi nën shtytjen e lëvizësit të parë, në këtë rast të sovranit, ata duken si të

humbur në një qiell pa yje, ata shkojnë kudo, apo shkojnë atje ku duan në vend që të mbahen brenda orbitës që u është imponuar". Një shenjë tjetër e çrregullimit të ardhshëm Bacon-i e sheh te paaftësia e sundimtarit që të veproj nga një pikëshikim, i cili do të tejkalonte kufizimet e qëndrimeve të veçuara të partive që luftojnë mes vetes brenda një shteti.<sup>39</sup>

Bacon-i analizon gjithashtu edhe *shkaqet* e kryengritjeve. Këto shkaqe ai i ndan në dy lloje: në materiale dhe në të rastit. Brenda shkaqeve materiale ai merr në shqyrtim në radhë të parë varfërinë e popullit, gjegjësisht një shkallë të varfërisë e cila bëhet e padurueshme dhe nxitë në kryengritje: "Rebelimet që vijnë nga barku janë nga më të këqijat".<sup>40</sup> Lloji tjetër i shkaqeve materiale të kryengritjeve është *pakënaqësia*, e shkaktuar nga pikëpamje e bindje të ndryshme që i kundërvihen veprimeve të qeverisë. Sikurse shkaqet që dalin nga barku, po ashtu edhe ato që dalin nga koka, janë si "materje djegëse" të domosdoshme për të nxitur një kryengritje. Sa i takon shkaqeve të rastit, Bacon-i përmend një numër të konsiderueshëm të tyre: ndryshime të religjionit, ndryshime të privilegjeve të grupeve të caktuara, ndryshimet në sistemin tatimor që mund të godasin më shumë një grup të caktuar shoqëror. Këto ndryshime, që prekin interesat e grupeve jo të njëjta, mund të bëhen shkak i rastit i një kryengritje nëse arrihet të krijohet një lloj i njëjtë i "pakënaqësisë së vetëdijshme" që bashkon njerëz të ndryshëm: "gjë që i shtyn të bashkohen përballë kundërshtisë së interesave të tyre".<sup>41</sup>

Foucault-ja këtu sjell në vëmendje edhe propozimet e Bacon-it për mjetet "shëruese" të shkaqeve të kryengritjeve. Kështu për zvogëlimin e varfërisë, ai propozon në njerën anë masa kundër luksit dhe përtacisë, kundër endacakëve dhe lypsave, e në anën tjetër masa për zhvillimin e tregtisë së brendshme e të jashtme, si edhe masa për drejtpeshimin midis resurseve të një vendi dhe popullsisë së tij. Ai njëherit sugjeron një varg veprimesh të cilat do të duhej të pengonin rebelimin sa të të mëdhenjëve aq edhe të popullit. Për Bacon-in, sovranit më lehtë mund të heq ose zvogëloj shkaqet e revoltave të të mëdhenjëve: "duke i blerë apo duke i ekzekutuar". Çështja është më e vështirë me pengimin e shkaqeve të pakënaqësisë që e shtyjnë popullin në revolta. Meqë situata më e rrezikshme, për të, është ajo ku lidhet pakënaqësia e të mëdhenjëve me atë të popullit, Bacon-i i sygjeron sovranit që në këtë rast të nxisë rivalitetin e interesave midis këtyre dy grupeve.<sup>42</sup>

Rëndësinë e pikëpamjes politike të Bacon-it, Foucault-ja do ta nxjerr në pah edhe duke e krahasuar atë me konceptet e Machiavelli-t. Foucault-ja nuk mohon faktin se ka ngjashmëri midis pikëpamjeve politike të dy mendimtarëve; ai përkujton edhe faktin se Bacon-i i referohej me respekt Machiavelli-t. Mirëpo, Foucault-së i interesojnë më shumë dallimet midis tyre. Në këtë tekst Foucault-ja saktëson interpretimin e vet të Machiavelli-it. Këtë interpretim të vetin ai e rezymon duke pohuar se "problemi i Princit ishte thelbësisht rreziku që i kanosej për ta humbur principatën". Pra, për Machiavelli-n çështja kryesore, sipas Foucault-së, është "pushtimi apo humbja e principatës". Ndërkaq Bacon-i nuk e trajton problemin e shpërvetësimit të mbretit nga pushteti i tij, por mundësinë vazhdimisht të pranishme; "në jetën e përditshme të shteteve", të shpërthimit të kryengritjeve.<sup>43</sup>

Ndonëse Foucault-ja sheh si pikë të përbashkët midis Bacon-it dhe Machiavelli-t rrezikun që mund të dalë nga bashkimi i pakënaqësisë së të mëdhenjëve me atë të popullit, ai megjithatë thekson dallimin midis tyre. Për Machiavelli-n rreziku kryesor vinte nga të mëdhenjtë, të cilët në një rast apo në një tjetër bëjnë përpjekje që ta përmbysin princin

apo sundimtarin. Populli, ndërkaq, për të ishte kryesisht pasiv dhe "duhej t'i shërbente si instrument Princit, përndryshe bëhej instrument i të mëdhenjëve".<sup>44</sup> Për Machiavelli-n, sipas këtij interpretimi, problemi kyç ishin relacionet e Princit me rivalët e tij të brendshëm apo të jashtëm. Ndryshe nga Machiavelli, Bacon-i duke e parë rrezikun e kryengritjes kryesisht të dalë nga populli, e shikonte këtë si "objekt thelbësor i asaj që duhet të jetë qeverisja e një shteti".<sup>45</sup>

Dallimin midis dy mendimtarëve, Foucault-ja e saktëson duke marë parasysh objektin kryesor që synon politika e sovranit: meqë ky te Machiavelli ka për preokupim si ta mbajë principatën, atëherë ai do të jetë i orientuar te marrëdhëniet e tij me të *mëdhenjtë* dhe rivalët. Ndërkaq, derisa për Bacon-in çështja shtrohet "si të qeveriset në sajë të arsyes së shtetit", Machiavelli ka parasysh gjithëherë *popullin*. Njëra nga pikat kryesore të dallimit midis Bacon-it dhe Machiavelli-t lidhet për Foucault-në me një aspekt të rëndësishëm në shpjegimin e një tendence të re të qeverisjes moderne. Derisa për Machiavelli-n janë kyçe tiparet reale apo aparente të Princit (i drejtë a i padrejtë, i ndershëm a i pandershëm, bujar apo koprac etj.), për Bacon-in është thelbësore çështja e mënyrës së qeverisjes që ka të bëjë me prodhimin e pasurive, për ta hequr apo zvogluar varfërinë si burim i kryengritjeve, me qarkullimin e mallërave, me tatimet e taksat. Por, qeverisja ka të bëjë, veç këtyre aspekteve të ekonomisë, edhe me opinionet e mendimet e njerëzve që përbëjnë një shtet.<sup>46</sup>

Foucault-ja i sheh të pranishme në mendimin e Bacon-it vijat e para të një praktike politike të re, që mbështetet në "politikën e kalkulimit ekonomik me merkantilizmin", e në anën tjetër, cilësitë e "fushatave të para të mëdha të opinionit të cilat, në Francë, do të shoqërojnë qeverisjen e Richelieu-së". Foucault-ja përkujton se Richelieu-ja kishte zbuluar fushatën politike përmes pamfleteve, bartësit e të cilëve do të quhen asokohe "publicistë".<sup>47</sup> Duke analizuar këtë dukuri në shekullin e XVII, Etienne Thuau (Tyo), në librin e cituar më parë, shtjellon pikëpamjen e Richelieu-së për "qeverisjen e mendjeve" dhe zbatimin e parimit se "të qeverisësh do të thotë të bësh që të të besojnë".<sup>48</sup>

### *Arsyeja e shtetit dhe e vërteta*

Në fund të kësaj ligjërate, Foucault-ja merr në shqyrtim raportin midis arsyes së shtetit dhe të vërtetës. Për të vënë në pah risinë epokale të raportit të qeverisjes së njerëzve, në modernitet, Foucault-ja rikujton raportin e pushtetit pastoral ndaj të vërtetës: pastorati nënkuptonte së pari, ekzistencën e një të vërtete, e cila duhej të përvetësohej, të mësohej, e pastaj edhe një të vërtetë të cilën besimtari duhej, në sajë të ndihmës së pastoratit, ta zbulojë brenda vetes. Ndërkaq arsyeja e shtetit ka të bëjë me një tip krejtësisht tjetër të së vërtetës. Tani, duke filluar nga shekulli i XVII, për të qeverisur nuk do të mjaftoj dija tradicionale e një urtie politike, e cila nënkuptonte njohjen e ligjeve pozitive të vendit, ligjet e natyrës që duhet të vlejnjë për të gjithë dhe urdhërimet e zotit për besimtarët. Për të qeverisur, sovrani doemos duhet të përvetësojë njohuri të reja, "mbi gjërat e jo aq mbi ligjet", të cilat duhet të bëjnë të mundur mbajtjen dhe zhvillimin e forcës së shtetit. Këto njohuri quheshin asokohe "statistikë", etimologjikisht si njohje e forcave dhe resurseve që cilësojnë një shtet. Këto njohuri, siç vë në pah Foucault-ja, kanë të bëjnë me *popullsinë*, me aspektet sasimore të jetës së tij,

“me natalitetin dhe mortalitetin, me vlerësimin e kategorive të ndryshme të individëve të një shteti dhe pasurive të tyre, vlerësimin e pasurive virtuale me të cilat disponon një shtet: minierat, pyjet, etj., vlerësimin e pasurive të prodhuara, vlerësimin e pasurive që qarkullojnë, vlerësimin e balancit tregtar, matjen e efekteve të taksave dhe tatimeve, janë të gjitha këto të dhëna e shumë të tjera që do të sajohen tani përmbajtjen thelbësore të dijes së sovranit”.<sup>49</sup> Nevoja për këto njohuri teknike mbi aspekte të ndryshme të realitetit të një shteti do të ndikojë në formësimin e një aparati administrativ, i cili nuk do të reduktohet, si më parë në zbatimin e urdhërave të sovranit apo në mbledhjen e tatimeve. Ky aparat i ri administrativ, për Foucault-në, ka nevojë për njohuri të reja si “dimension thelbësor për ushtrimin e pushtetit”.<sup>50</sup>

Një aspekt tjetër i raportit të arsyes së shtetit modern ndaj të vërtetës lidhet me domosdoshmërinë që shteti të ketë sekrete, pikërisht ajo që asokohe quhej *arcana imperii* ose sekretet e pushtetit.

Njëri nga aspektet më të rëndësishme të raportit të arsyes së shtetit me çështjen e të vërtetës ndërlidhet me veprimet dhe ndikimet e pushtetit ndaj opinionit publik. Këto ndikime synojnë të ndryshojnë opinionet e njerëzve e njëherit mënyrën e veprimit dhe sjelljet e tyre si subjekte ekonomike dhe si subjekte politike.<sup>51</sup>

Me këtë qasje Foucault-ja nuk synon të bëjë historinë e shtetit, por vetëm të përvijojë disa aspekte të “prizmës praktiko-refleksive, brenda së cilës u paraqit nga mbarimi i shekullit të XVI e fillimi i shekullit të XVII, problemi i shtetit”. Qasjen e tij Foucault-ja e krahason me qasjen e cila nuk mëton të bëjë historinë, me terma të astrofizikës, e planetit të Tokës, por prizmen refleksive e cila “e ka bërë të mundur, duke filluar nga një moment i caktuar, të mendohet se Toka është një planet”.<sup>52</sup> Megjithatë, ky krahasim nuk e nxjerr në shesh specifikën e qasjes së Foucault-së mbi shtetin e qeverisjen. Kjo specifikë synon të jetë lidhja midis paraqitjes së shtetit brenda horizontit të një praktike të menduar dhe efektive që dalin nga kjo në vetë historinë e shtetit dhe në mënyrën se si sajohen institucionet e tij.<sup>53</sup>

Kështu, Foucault-ja në të vërtetë dëshiron të veçoj një prizëm reflektiv, i cila u sajua në një moment të caktuar të historisë së Evropës perëndimore. Është fjala për prizmin nëpërmjet të cilit, qeveritarët dhe këshilltarët e tyre, por edhe mendimtarët e asaj kohe, do ta shikojnë dhe shqyrtojnë shtetin dhe funksionimin e tij, gjegjësisht *mënyrën e qeverisjes*. Për Foucault-në shteti dhe institucionet e tij (ushtria, fiskaliteti, drejtësia) ekzistonin edhe para mbarimit të shekullit XVI, por pikërisht në këtë kohë ato do të bëhen objekt i qëmtimit politik e ky qëmtim do të ndikojë në ndryshimet që do t'i pësojë shteti, i cili do të kundrohët gjithnjë e më shumë jo si një “shtet-gjësend thujse të ishte një qenie që zhvillohet duke u nisur nga vetvetja dhe duke i imponuar individëve me një mekanikë spontane, si pothuajse automatike”.<sup>54</sup>

Një kufizim të *arsyes së shtetit* të kësaj kohe Foucault-ja e sheh në faktin se ajo nuk e bëri eksplicite çështjen e *popullsisë* e në veçanti popullsinë si subjekt ekonomik. Kjo çështje do të elaborohet më vonë në mendimin politik, duke filluar nga shekulli i XVIII, falë një “aparati i cili u sajua për ta bërë të mundur funksionimin e arsyes së shtetit. E ky aparat është policia”.<sup>55</sup> Tematizimin e *policisë*, jo si organ shtypës i shtetit, si kuptohet sot, por si “fushë e praktikave” të shtetit modern, Foucault-ja do ta bëjë në shtjellimet e mëtejme.

## Shteti si parim shpjegues dhe si objektiv

Në analizat e tij, Foucault-ja përpqet të nxjerr në shesh veçantinë dhe risinë e artit të qeverisjes që u formësua në fillet e modernitetit. Ndonëse vë në pah ndikimin që praktika pastorale ushtroi te ky art i qeverisjes, Foucault-ja njëherit thekson se ndikimi nuk u bë si bartje e thjeshtë e një tipari të pushtetit pastoral te pushteti sovran: "Mbreti nuk u bë bari, nuk u bë bari i trupave dhe jetëve, si bariu tjetër, pastori shpirtëror, i cili ishte bari i shpirtërave dhe i mbijetimit".<sup>56</sup>

Foucault-ja dëshiron të shkojë risinë e një "ngjarje në historinë e arsyes perëndimore, të racionalitetit perëndimor, ngjarje po aq e rëndësishme sa edhe ajo e shënuar nga Keppler-i, Galileo, Descartes-i etj, pikërisht në të njëjtën epokë, nga mbarimi i shekullit të XVI dhe gjatë shekullit të XVII". Lindja e arsyes së re qeverisëse, përmes transformimit të arsyes perëndimore, shoqërohet me një mënyrë të re të menduarit, të rezonancës, të kalkulimit që asokohe do të emërtohet me termin "politikë". Kështu, *politika* si mënyrë tjetër e të menduarit të pushtetit dhe të raportit midis mbretërisë tokësore dhe asaj qiellore do të shikohet si "heterodoksi". Politikën e kësaj kohe Foucault-ja do ta përkufizojë me një analogji: politika në raport me artin e qeverisjes është sikurse dija matematikore (*mathesis*) ishte asokohe në raport me shkencën e natyrës.<sup>57</sup> Më tej, Foucault-ja përkufizon raportin midis arsyes qeverisëse dhe shtetit. Shteti del njëherazi si parim dhe themel, por edhe si objektiv dhe qëllim i arsyes qeverisëse. Brenda të menduarit politik modern, i cili mëton të kapë "racionalitetin e një arti të qeverisjes" shteti nis të shihet, së pari, si parim, i cili bën të mundur të shpjegohet dhe të kuptohet realiteti politik, të shpjegohen relacionet midis institucioneve ekzistuese politike: mbreti, sovrani, qeveritari, ligji, territori, banorët e këtij territori etj.<sup>58</sup>

Në anën tjetër, shteti shihej edhe si objektiv që duhej të arrihej në sajë të veprimt të artit të qeverisjes, duke i marr parasysh shtrëngesat e realitetit, domosdoshmëritë. Kështu të menduarit politik, si teori, mban lidhjen me realitetin politik, me praktikën politike. Këtë lidhje Foucault-ja e vë në dukje edhe kur trajton raportin midis arsyes së shtetit dhe shtetit modern, gjegjësisht praktikave apo "teknologjisë politike". Teoricienët e arsyes së shtetit vinin në pah se shteti modern nuk i nënshtrohej tani asnjë ligji të jashtëm ndaj tij, qoftë ai moral, natyror apo hyjnor. Kjo do të thotë se shteti nuk ka ndonjë qëllim jashtë vetes. Ai do të shihet i vendosur brenda një "bote historike të papërcaktuar", të një kohe që nuk është më e drejtuar me një mbarim, i cili do të shënonte kalimin në botën e ardhshme mbinatyrore. Realiteti politik tani do të përkufizohet brenda një *shumësie* të shteteve që nuk do të kenë për synim të bashkohen në ndonjë perandori të vetme e përfundimtare.<sup>59</sup>

Ngjarja historike, e cila cilëson më së miri këtë realitet të ri politik, për Foucault-në ishte lidhja e traktatit të Westphalia-së (me 1648), pas përfundimit të luftës Tridhjetëvjeçare, dhe pas pesë vitesh të negociatave midis fuqive evropiane. Ky traktat përmban, së pari, idenë e pranimit të shumësisë së shteteve dhe fundin e idesë së Perandorisë romake. Ide tjetër e rëndësishme e këtij traktati, sipas Foucault-së, është ajo që në njerën anë pranon legjitimitetin e tri feve (veç katolicizmit edhe luteranizmin dhe kalvinizmin) e në anën tjetër ndarja e qartë e shtetit nga religjioni. Kjo ndarje manifestohet në idenë se shtetet në praktikën e tyre politike mund të krijojnë aleanca jo sipas përkatësisë fetare të vendeve, por sipas interesave të tyre

politike. Tani, karakteristika kryeore e relacioneve të shteteve është konkurrenca ekonomike e politike. Duke shumëzuar dhe intensifikuar këmbimet ekonomike shtetet njëherazi rrisin rivalitetet midis tyre. Kështu, shteti tani nuk reduktohet vetëm si qëllim në vete, por del edhe si aktor i një raporti konkurrence. Ky raport bëhet i theksuar ngase asnjë nga fuqitë e mëdha nuk ka aq fuqi sa t'i mbisundojë të gjitha të tjerat. "Ato kërkojnë të afirmohen në një hapësirë që është hapësirë e konkurrencës komerciale dhe sundimit komercial, në një hapësirë të qarkullimit monetar, në një hapësirë të pushtimit kolonial, në një hapësirë të kontrollit të detrave[...]"<sup>60</sup>

Karakteristikat e shtetit modern shpërfaqen më së miri te shteti i Spanjës, në shekullin e XVI. Në këtë kohë Spanja, përmes mekanizmave dinastike dhe falë familjes së Habsburgëve, shikohej si trashëgimtare e Perandorisë dhe e një *monarkie universale*. Ky ishte aspekti tradicional i këtij shteti. Mirëpo, në anën tjetër, Spanja ishte bërë fuqi koloniale e detare në përmasa planetare. Kjo pozitë bëri të mundur që ajo të pasurohet shumë brenda disa dekadave, edhe pse gjatë shekullit të XVII njëherit përjetoi dobësimin dhe varfërimin e vet.<sup>61</sup> Pikërisht shembulli i Spanjës, rritja e rrëmbyeshme e fuqisë së saj dhe dobësimi i saj, do të behet objekt i analizave të arsyes së shtetit. Analiza këto që nxjerrin në pah dinamikën e rivaliteteve ekonomike e politike të fuqive kryesore të asaj kohe: Spanjës, Francës, Anglisë, Suedisë, Holandës e Gjermanisë. Foucault-ja pranon se edhe më parë kishte rivalitete midis shteteve. Por risia e rivaliteteve të kësaj kohe do të marrë trajtën e konkurrencës dhe bëhet e vrojtueshme në faktin se ato "hyjnë në një prizëm refleksiv që bën të mundur që ato të organizohen si strategji". Risia qëndron në faktin se mendimi mbi arsyen e shtetit bëhet "mendim dhe strategji e konkurrencës për të koduar të gjitha këto fenomene".<sup>62</sup> Në analizën e vet të ngjarjeve politike që cilësonin shekujt e XVI e XVII, Foucault-ja nxjerr në shesh disa transformime të rëndësishme. Njeri prej tyre kishte të bëjë me dallimin midis llojeve të rivaliteteve midis shteteve paramoderne dhe atyre moderne. Më parë rivaliteti midis shteteve manifestohej kryesisht si rivalitet i fuqisë dhe pasurisë së princërve, i dinastive princërore, tani kemi të bëjmë me kundërshtitë dhe konkurrencën midis fuqisë së shteteve: "ky është ndryshimi nga më thelbësorët njëherit në jetën politike dhe në historinë e Perëndimit".<sup>63</sup>

Një dukuri tjetër të re që heton Foucault-ja në këtë periudhë është nocioni i forcës, të cilën ende nuk e kishin artikulluar teoricienët e arsyes së shtetit të asaj kohe. Ky nocion i forcës bën të mundur të kapet ndryshimi në orientimin e veprimit të shteteve: ndërsa më parë tendenca kryesore ishte zgjerimi i vazhdueshëm i territorit, tani tendenca do të jetë rritja e forcave të shtetit. Këto forca do të synojnë të shtohen jo më me lidhjet martesore midis dinastive, por me aleancat politike që kanë karakter të përkohshëm. Kështu, dija politike tani do të merret me *kategorinë e forcës*, me përdorimin strategjik dhe llogaritjen e forcave, si edhe me problemin e dinamikës. Foucault-ja thekson se lindja e kësaj kategorie të re politike doli si rezultat i një varg procesesh historike, midis të cilave ishin zbulimi i Amerikës, formimi i perandorive koloniale, mbarimi i Perandorisë romake, heqja e funksioneve universaliste të kishës.<sup>64</sup>

Në këto shqyrtime Foucault-ja përvijon edhe një bashkëkohësi midis lindjes së dinamikës në fushën e politikës dhe dinamikës si shkencë fizike. Leibnizi (Lajbnic) ishte mendimtar i cili arriti të lidhë aspektin historiko-politik të forcës me atë të shkencës fizike ose

"homogjenitetin e këtyre dy proceseve".<sup>65</sup> Filozofi bashkëkohor francez André Robinet (Andre Robine) në librin e vet, *G.W.Leibniz. Bota më e mirë përmes balancit të Evropës* (Paris, PUF, 1994), thekson se Leibnizi e kishte kapur idenë e balancit të Evropës si një "fizikë politiko-ushtarake e kombeve ku forcat antagoniste të ndryshueshme ushtrohen sipas ndeshjeve violente të rastit njëra me tjetrën, njëra kundrejt tjetrës".<sup>66</sup> Duke dashur të përmbledhë këtë analizë të dukurive që cilësojnë *racionalitetin e ri qeverisës*, Foucault-ja vë në pah një zhvendosje të rëndësishme: derisa më parë çështja ishte si të ruhet shteti brenda një rendi të përgjithshëm (natyror a hyjnor), tani çështja është si të mbahet e të zhvillohet një dinamikë e forcave dhe një raport i forcave midis shteteve.<sup>67</sup> Shoqëritë e botës perëndimore, sipas Foucault-së, me qëllim të mbajtjes së këtij raporti të forcave midis shteteve, do të ndërtojnë dy dispozitiva: njëri është *dispozitivi diplomatiko-ushtarak* e tjetri është *policia*, në kuptimin që kishte asokohe. Dispozitivi i dytë do të ketë për funksion kryesor të bëjë të mundur zhvillimin e forcave të brendshme të çdonjërit nga shtetet. Ndërkaq, lidhja midis mbajtjes së raportit të forcave midis shteteve dhe rritjes së forcave të brendshme të shteteve do të quhet më vonë "mekanizëm i sigurisë".<sup>68</sup>

## Drejtpeshimi i Evropës

Pas përfundimit të luftës Tridhjetëvjeçare, e cila shënonte në fakt përfundimin e luftërave fetare e politike prej një shekulli, morën fund dy ëndrra: ajo mbi mundësinë e sajimit të një perenadorie unike dhe ajo mbi universalizmin e kishës katolike. Në këto rrethana të reja çështja kyçe do të jetë çfarë raporte mund të mbahen midis shteteve të mëdha, asnjëri prej të cilëve nuk mund të pretendonte të ishte kryesori, e që do të mund të impononte vullnetin e vet. Këtu do të lind atëherë ideja e balancit apo e drejtpeshimit të Evropës. Origjinën e kësaj ideje Foucault-ja e gjen brenda mendimit politik në rilindjen italiane: Giucardini (Xhiukardini) në fakt kishte zhvilluar idenë mbi domosdoshmërinë e krijimit të një drejtpeshimi midis principatave-shtete të vogla brenda Italisë. Por tani çështja e balancit shtrohej në një horizont më të gjerë, në horizontin e Evropës. Foucault-ja vëren se kërkesa e shteteve nënshkruese të traktatit të Westphalia-së ishte që, krahas, ripërkufizimit të kufijëve, të arrihet një drejtpeshim midis shteteve të Evropës.<sup>69</sup>

Evropa në pjesën e parë të shekullit të XVII, si ide e re, në njerën anë, del e zhveshur nga pretendimi universalist i krishtëritimit, e në anën tjetër shihet si një hapësirë gjeografike, në të cilën asokohe nuk bënin pjesë as Rusia e as Anglia, ngase nuk ishin nënshkruese të traktatit të Westphalia-së. Raportet midis shteteve të kësaj Evrope nuk ishin të përcaktuara nga ndonjë strukturë hierarkike ngase ajo shikohej si "thelbësisht plurale" ose si "një shumësi pa unitet".<sup>70</sup> Kjo natyrisht nuk do të thotë se midis tyre nuk kishte dallime. Dallimi kryesor ishte ai i forcës ekonomike, ushtarake e politike. Së këndejmi, këshilltari i mbretit francez Henrikut IV, duka Sully (Syli), zhvillonte projektin për Evropën si koalicion i 15 shteteve, me forca përafërsisht të barabarta. Karakteristikë tjetër e kësaj ideje të re të Evropës, për Foucault-në, ishte raporti i saj me pjesën tjetër të botës. Ky raport cilësohej me dominimin e Evropës në sajë të politikës koloniale mbi vendet e kontinenteve të tjera dhe shfrytëzimit të pasurive të tyre.<sup>71</sup>

Foucault-ja përkujton se në shekullin e XVII u zhvilluan pikëpamje të ndryshme mbi balancën e Evropës. Thelbësisht, kjo ide, e thënë edhe me shprehjet latine "*trutina sive bilanx Europeae*", do të thotë se asnjë nga shtetet e mëdha të Evropës nuk mund t'i imponoj vullnetin e vet ekskluziv ndonjë shteti tjetër. Prej nga rrjedh edhe domosdoshmëria e kërkimit të një drejtpeshimi midis shteteve të Evropës. Ky drejtpeshim duhej të realizohej përmes kufizimit të forcave të shteteve më të forta, me barazimin e më të fortëve dhe me mundësinë e bashkimit të shteteve më të dobëta për t'u mbrojtur nga ato më të forta. Aspekti dinamik i këtyre raporteve midis shteteve evropiane shihet edhe në nevojën e pajtimit të dy tendencave: derisa në relacionet e jashtme duhej të synohej drejtpeshimi dhe pengimi i mbisundimit të një shteti mbi tjetrin, synimi i brendshëm i çdo shteti i duhej të ishte rritja e vazhdueshme e forcave të tij, por gjithnjë duke patur parasysh ruajtjen e paqës dhe balancin midis shteteve.<sup>72</sup>

Njëri nga mjetet kryesore për mbajtjen e drejtpeshimit dhe ruajtjen e paqës do të jetë, sado paradoksale që mund të duket, pikërisht *lufta*. Funkcioni i luftës do ishte që të pengoj prishjen e paqës dhe balancit. Derisa në mesjetë lufta shikohej si zbatim i një ideje të drejtësisë në konfrontimin publik e privat të princërve (luftëra të drejta dhe luftëra të padrejta), në modernitet, lufta do të shpjegohet nëpërmjet arsyes së shtetit. Arsyeja e luftës nuk do të kërkohet brenda të drejtës, por brenda politikës, e cila duhet të mbaj drejtpeshimin midis shteteve. Foucault-ja mendon se pikërisht në këto rrethana lind parimi, të cilin, do ta formulojë 200 vjet më vonë von Klauzewitz-i: "Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera". Foucault-ja përkujton njëherit se topat e mbretit të Francës, në shekullin e XVII mbanin mbishkrimin: "*Ultima ratio regum*" (arsyeja e fundme e mbretërve).<sup>73</sup>

Mjeti tjetër për mbajtjen e drejtpeshimit midis shteteve apo për funksionimin e sistemit të sigurimit të tyre, do të jetë *diplomacia*. Kështu, fjala ven, traktati i Westphalia-së përmban një shembull konkret se si shtetet evropiane të asaj kohe orvateshin të zgjidhnin kontestet midis tyre përmes mekanizmave diplomatike. Edhe këtu Foucault-ja tregon risinë e diplomacisë moderne. Kjo nuk do të mbështetet më në ligjet e të drejtës së trashëgimisë së princërve e mbretërve e as në normat e traditës, por në "linjat e përcaktuara nga domosdoshmëria e një drejtpeshimi".<sup>74</sup> Në marrëveshjet diplomatike do të bëhet një pazarllëk e një këmbim i territoreve, qyteteve, fshatrave e porteve, jo sipas të drejtës së trashëgimisë e as të drejtës së fituesit në një konflikt, por sipas parimit të drejtpeshimit midis shteteve. Foucault-ja thekson se ndonëse institucioni i ambasadorëve permanent u paraqit në Evropë qysh nga fundi i shekullit të XVI, megjithkëtë "organizimi i vetëdijshëm, i menduar mirë dhe absolutisht permanent i një diplomacie e cila rregullisht negocion" lindi në shekullin e XVII.<sup>75</sup> Në këtë kohë lindi madje edhe shprehja e një "shoqërie të kombeve" si hapësirë brenda së cilës shtetet i rregullojnë marrëdhëniet e tyre dhe zgjidhin konfliktet e tyre.

Kjo ishte gjithashtu koha kur lindi *jus gentium*, apo e drejta e njerëzve, e cila kishte për qëllim të rregulloj marrëdhëniet juridike midis shteteve të shikuara si individ e subjekte juridike. Kështu Jean-Jacques Burlamaqui (Zhan Zhak Byrlamaki) në veprën *Parime të drejtës natyrore dhe të drejtës së njerëzve* (1768) shkruan: "Evropa përbën sot një sistem politik, një trup ku gjithçka është e lidhur me marrëdhënie dhe me interesa të ndryshme të kombeve që banojnë këtë pjesë të botës [...]. Kujdesi i vazhdueshëm i sovranëve ndaj gjithë asaj që ndodh tek ata dhe tek të tjerët, diplomatët permanent dhe negociatat e vazhdueshme



e bëjnë Evropën moderne një lloj republike anëtarët e pavarur të së cilës janë të lidhur me interes të përbashkët, ata bashkohen për të mbajtur aty rendin dhe lirinë".<sup>76</sup>

Mjeti i tretë i sistemit diplomatiko-ushtarak, i cili do të bëjë të mundur balancin evropian, do të jetë dispozitivi ushtarak permanent, i mbështetur mbi një armatë profesionale dhe një dije taktike ushtarake. Kështu, për Foucault-në, institucionalizimi i ushtrisë përbën një element të rëndësishëm në ndërtimin e drejtpeshimit dhe sigurisë midis shteteve evropiane.<sup>77</sup>

## Bibliografi e zgjedhur

### Vepra të Michel Foucault-së

*Dits et écrits*, I, 1954-1975, II, 1976-1988, Paris, Quarto Gallimard, 2001.

*Folie et Déraison. Histoire de la folie à l'âge classique*, Paris, Plon, 1961.

"*Il faut défendre la société*". Cours au Collège de France. 1975-1976, Paris, Gallimard-Seuil, *Histoire de la sexualité*, t.I, *La volonté de savoir*, Paris, Gallimard, 1976, t.II, *L'usage des plaisirs*, 1984, t.III, *Le souci de soi*, 1984.

*L'Archéologie du savoir*, Paris, Gallimard, 1969.

*Le pouvoir psychiatrique. Cours au Collège de France. 1973-1974*, Paris, Gallimard-Seuil, 2003.

*Les mots et les choses. Une archéologie des sciences humaines*, Paris, Gallimard, 1966.

*Les Anormaux. Cours au Collège de France. 1974-1975*, Paris, Gallimard-Seuil, 1999.

*L'Herméneutique du sujet. Cours au Collège de France. 1981-1982*, Paris, Gallimard-Seuil, *L'Ordre du discours*, Paris, Gallimard, 1971.

*Naissance de la clinique. Une archéologie du regard médical*, Paris, P.U.F., 1972.

*Naissance de la biopolitique. Cours au Collège de France. 1978-1979*, Paris, Gallimard, 2004.

*Sécurité, Territoire et Population. Cours au collège de France. 1977-1978*, Paris, Gallimard-Seuil,

*Surveiller et punir. Naissance de la prison*, Paris, Gallimard, 1975.

### Vepra për mendimin e Foucault-së

Alain Brossat, *L'épreuve du désastre*, Paris, Albin Michel, 1996.

Blandine Kriegel, *Michel Foucault aujourd'hui*, Paris, Plon, 2004.

François Evrard, *Michel Foucault et l'histoire du sujet en Occident*, Paris, Lacoste, 1995.

Frédéric Gros, *Michel Foucault*, Paris, PUF, 1996

H.Dreyfus, P. Rabinow, *Michel Foucault. Un parcours philosophique*, Paris, Gallimard, 1984.

Maria Bonnafus-Boucher, *Le libéralisme dans la pensée de Michel Foucault*, Paris, L'Harmattan, 2004.

Marie-Christine Granjon, *Penser avec Michel Foucault*, Paris, Karthala, 2004.

Philippe Chevalier, *Michel Foucault. Le pouvoir et la bataille*, Paris, Pleins Feux Edt.  
Maurice Blanchot, *Michel Foucault tel que je l'imagine*, Fata Morgana, Montpellier, 1986.

## Réferenca

<sup>1</sup> Michel Foucault, *Sécurité, Territoire, population* (1977-1978), Gallimard - Seuil, Paris, 2004. *Naissance de la biopolitique* (1978-1979), Paris, Gallimard-Seuil, 2004.

<sup>2</sup> Po aty, f. 238.

<sup>3</sup> Po aty, f. 238.

<sup>4</sup> Po aty, f. 239.

<sup>5</sup> Po aty, f. 239.

<sup>6</sup> Po aty, f. 242

<sup>7</sup> Po aty, f. 242

<sup>8</sup> Po aty, f. 243

<sup>9</sup> Veç teksteve tjera, lidhur me këtë çështje Foucault-ja do të mbështetet në librin e historianit E. Thuau, *Arsye e shtetit dhe mendimi politik në kohën e Richelieu-së (Raison d'Etat et pensée politique à l'époque de Richelieu*, Armand Colin, Paris, 1966.

<sup>10</sup> Po aty, f. 248

<sup>11</sup> Po aty, f. 248

<sup>12</sup> Po aty, f. 246

<sup>13</sup> Po aty, f. 251

<sup>14</sup> Po aty, f. 253

<sup>15</sup> Po aty, f. 253

<sup>16</sup> Po aty, f. 253

<sup>17</sup> Po aty, f. 253

<sup>18</sup> Po aty, f. 263

<sup>19</sup> Po aty, f. 263

<sup>20</sup> Po aty, f. 263

<sup>21</sup> Po aty, f. 264

<sup>22</sup> Po aty, f. 266

<sup>23</sup> Po aty, f. 267

<sup>24</sup> Po aty, f. 268

<sup>25</sup> Po aty, f. 269

<sup>26</sup> Po aty, f. 269

<sup>27</sup> Po aty, f. 270

<sup>28</sup> Biseda është botuar në vëllimin e dytë të *Dits et écrits*, me titullin *Skena e filozofisë*, f. 571-595.

<sup>29</sup> Po aty, f. 571

<sup>30</sup> Po aty, f. 572

<sup>31</sup> Po aty, f. 573

<sup>32</sup> Po aty, f. 573

<sup>33</sup> Po aty, f. 574

<sup>34</sup> Po aty, f. 271

<sup>35</sup> Po aty, f. 271

<sup>36</sup> Po aty, f. 271

<sup>37</sup> Po aty, f. 272

<sup>38</sup> Po aty, f. 273

<sup>39</sup> Po aty, f. 274

<sup>40</sup> Po aty, f. 274

<sup>41</sup> Po aty, f. 274

<sup>42</sup> Po aty, f. 276

<sup>43</sup> Po aty, f. 277

<sup>44</sup> Po aty, f. 277. Mirëpo, për Lefort-in, populli te Machiaveli nuk del aq pasiv: ai është aktor politik i rëndësishëm, ai ka për synim lirinë, si vlerë e modernitetit; ai e ruan më së miri lirinë, siç thotë një nëntitull i *Ligjëratave*. Në një fragment tjetër, Machiaveli e këshillon kështu princin: "Kështjella më e mirë që mund të jetë është të mos jesh fare i urretur nga populli". Fragment i cituar nga Leforti te *Travail de l'oeuvre. Machiavel*. f. 430.

<sup>45</sup> Po aty, f. 277

<sup>46</sup> Po aty, f. 278

<sup>47</sup> Po aty, f. 278

<sup>48</sup> Po aty, f. 280

<sup>49</sup> Po aty, f. 280

<sup>50</sup> Po aty, f. 280

<sup>51</sup> Po aty, f. 281. Pak më tutje Foucault-ja shkruan: "Publiku si subjekt-objekt i një dije: subjekt i një dije e cila është "opinion" dhe objekt i një dije që është e një tipi krejt tjetër, ngase ajo ka opinionin për objekt dhe se është fjala për këtë dije të shtetit të modifikoj opinionin apo të shërbehet me të, ta instrumentalizojë atë. Ne jemi larg idesë së "virtutshme" të një komunikimi të monarkut dhe të nënshtetasve të tij në njohjen e përbashkët të ligjeve njerëzore, natyrore e hyjnore".

<sup>52</sup> Po aty, f. 281

<sup>53</sup> Po aty, f. 282

<sup>54</sup> Po aty, f. 282

<sup>55</sup> Po aty, f. 284

<sup>56</sup> Po aty, f. 293

<sup>57</sup> Po aty, f. 293 - 294

<sup>58</sup> Po aty, f. 294

<sup>59</sup> Po aty, f. 298

<sup>60</sup> Po aty, f. 299

<sup>61</sup> Po aty, f. 300

<sup>62</sup> Po aty, f. 301

<sup>63</sup> Po aty, f. 302

<sup>64</sup> Po aty, f. 303

<sup>65</sup> Po aty, f. 304

<sup>66</sup> Po aty, f. 315

<sup>67</sup> Po aty, f. 304

<sup>68</sup> Po aty, f. 304. Kështu OSBE-ja sot mund të shihet si shprehje e kësaj tendence për të krijuar rrethanat e sigurisë brenda Evropës.

<sup>69</sup> Po aty, f. 305

<sup>70</sup> Po aty, f. 305-306

<sup>71</sup> Po aty, f. 305

<sup>72</sup> Po aty, f. 307-308

<sup>73</sup> Po aty, f. 309

<sup>74</sup> Po aty, f. 310

<sup>75</sup> Po aty, f. 310

<sup>76</sup> Po aty, f. 313

<sup>77</sup> Po aty, f. 313



## FUKUJAMA: NDËRTIMI I SHTETIT, QEVERISJA DHE RENDI BOTËROR NË SHEKULLIN E XXI

Enri HIDE\*

**P**ak kohë më parë, në Shqipëri padritën e botimit, nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, një prej librave më interesantë dhe më të debatueshëm të shkruar kohët e fundit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare i titulluar “*Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e Njëzetinjë*” nga Francis Fukujama (Francis Fukuyama). Ky i fundit mbart mbi supë një histori të gjatë akademike dhe politike. Profesor në universitetin amerikan “John Hopkins”, autor i librit të famshëm “*Fundi i Historisë dhe Njeriu i Fundit*”, ish-këshilltar i presidentit Bush dhe “ati” filozofiko-politik i neokonservatorëve amerikanë, që kanë dominuar gjatë këtyre tetë viteve të fundit në arenën politike të vendit, Fukujama është lëkundur midis qëndrimeve të tij neokonservatore në favor të ndërhyrjeve për demokratizimin e shoqërive të Lindjes së Mesme, dhe largimit gradual e kritikës ndaj tyre.

Megjithatë Fukujama është një autor që ia vlen ta lexosh. Pavarësisht nëse biem dakord ose jo me idetë e tij, ai ka imponuar shpesh herë temën e diskutit në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare pas fundit të Luftës së Ftohtë. Në këtë kuadër, nuk përjashtohet as libri i tij kuptimplotë dhe i ngjeshur për nga thellësia ideologjike dhe konceptuale, “*Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e Njëzetinjë*”, i cili po shërben si determinues i një axhende akademike të studimeve të politikës globale. Kjo për faktin se pyetja që shtrohet pas çdo libri të Fukujamas<sup>1</sup> prek natyrën e disiplinës në fjalë dhe shërben si një rregullator i axhendës akademike dhe politike.

E thënë përmbledhtazi, Fukujama dëshiron të na vërë në dukje pikësëpari faktin se shtetet mbeten ende të rëndësishme dhe se shumë prej problemeve të sotme – nga lufta kundër SIDA-s deri tek terrorizmi – i atribuohen dështimit në ndërtimin e shtetit dhe qeverisjes së paefektshme. Kjo përbën qartazi një shmangie nga nocioni tepër i thjeshtësuar i “shteteve minimale” që dominoi debatin rreth zhvillimit deri në mes të viteve '90-të. Prandaj, qëllimi i vendeve të dobëta duhet të jetë gjetja e mënyrës optimale të ndërtimit të shtetit dhe përhapja ndër to e qeverisjes efikase. Sipas autorit, kjo është rruga drejt Rendit Botëror. Kështu, vetiu, pyetja themeltare që shtrohet nëpërmjet leximit dhe, më pas, një kritike konstruktive të “Ndërtimit të Shtetit” është: A është ndërtimi i shtetit rruga më e mirë dhe e vetme drejt arritjes së një rendi botëror? A është ky i fundit veçse rendi botëror i dëshiruar nga një apo disa superfuqi, apo mos ndoshta jemi duke debatuar rreth rrugës praktike drejt arritjes së paqes globale?

Në vijim do përpiqemi të paraqesim shkurtazi kontributin e librit të Fukujamas në Marrëdhëniet Ndërkombëtare si dhe të hulumtojmë skajet e argumenteve të tij. Gjithsesi, për t'iu përmbajtur reçencave tradicionale, një përmbledhje fillestare e këtij libri do ishte ajo, sipas së cilës: “Fukujama përpiqet të bashkojë traditat e hulumtimit në shkencat politike, të sociologjisë politiko-historike, të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe, çka është ndoshta më e rëndësishmja, Ekonominë Neo-Institucionale”. Fukujama i lidh leksionet e tij teorike me një sërë rastesh studimore dhe skenarë nga politika e botës reale, që nga ndërtimi i shtetit (i dështuar disa herë) në Evropën Lindore deri tek ndërhyrjet ushtarake në shtete sovraane (siç

\* Enri Hide është pedagog në Universitetin European të Tiranës.

dëshmojnë Bosnja, Kosova, Iraku, etj.). "Ndërtimi i Shtetit" është një libër me tematikë shumë të gjerë dhe, për të përdorur fjalët e vetë autorit, gjerësia tematike rrezikon ndonjëherë të kufizojë fuqinë e argumentit themeltar. Fukujama përpiqet në thelb t'i "shoshitë" dhe zgjerojë shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me mprehtësinë epistemologjike të Ekonomisë Neo-Institucionale.

Sipas tij, është e rëndësishme që shteti të jetë i fortë, për të garantuar sigurinë dhe stabilitetin e nevojshëm për ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Për të ka rëndësi kufizimi i kontrollit qeveritar, në mënyrë që të lulëzojë lirshëm iniciativa private dhe tregu. Faktorët e jashtëm nuk duhet të zëvendësojnë institucionet lokale – ky ka qenë gjithnjë "mëkati" i organizatave ndërkombëtare. Pikërisht për këtë arsye, në Afrikë për shembull, gjenden ende, megjithëse kanë kaluar 20 apo 30 vite, organizata ndërkombëtare ndihme, të cilat kanë shkatërruar të gjithë kapacitetet institucionale lokale.

Ai bën një dallim të rëndësishëm midis ndërtimit të shtetit dhe ndërtimit të kombit.<sup>2</sup> Aktorët e jashtëm nuk mund të ndërtojnë kombe, në kuptimin e krijimit të të gjitha lidhjeve dhe indeve sociale, kulturore dhe historike që mbajnë të bashkuar një komb. Nga ana tjetër, ndërtimi i shtetit ka qëllim më të kufizuar pasi synon vetëm forcimin e institucioneve qeverisëse si gjyqësori, ushtria, forcat policore, stabiliteti dhe bashkëpunimi politik – faktorë këta që krijojnë minimumin e qëndrueshmërisë së një shteti.

## Argumenti i Fukujamas

**Kapitulli 1**, "Dimensionet e Munguara të Shtetit", ka si pikënisje debatin rreth rolit të shtetit në qarqet e zhvillimit ekonomik, të trajtuara gjerësisht në literaturën e Ekonomisë Neo-Institucionaliste. Ai bën dallimin midis fuqisë dhe shtrirjes së pushtetit qeveritar. Shtrirja e pushtetit të shtetit lidhet me funksionet që ai kryen. Këto identifikohen përgjatë një spektri, i cili varion nga një shtrirje minimale (për shembull garantimi i të mirave publike, përkufizimi i të drejtës së pronës dhe imponimi i saj, apo stabiliteti makroekonomik), tek ajo e mesme (për shembull politikat arsimore dhe ato mjedisore), deri tek funksionet më të gjera (të tilla si politika industriale apo rishpërndarja e pasurisë brenda shtetit). Nga ana tjetër, pushteti lidhet me fuqinë që kanë shtetet për të implementuar funksionet e tyre. Kjo reflekton kapacitetin institucional për të vepruar në mënyra specifike. Teza e Fukujamas është ajo sipas së cilës konflikti midis këtyre dy dimensioneve shkakton konfuzion dhe receta politike të ngatërruara. Për të, pyetja shtrohet: "Si të arrijmë të bëhemi Danimarkë?" (f. 50), një shtet ky i cili përfaqëson një vend të zhvilluar me institucione shtetërore që funksionojnë në mënyrë optimale.<sup>3</sup>

Duke u bazuar në dallimet midis shtrirjes dhe fuqisë së një shteti, Fukujama na thotë se për të kuptuar kapacitetet e një shteti duhet gjithashtu të shtrohet pyetja e ofertës dhe kërkesës së institucioneve. Çështja e ofertës përbëhet nga katër aspekte "(1) struktura organizative dhe menaxhimi, (2) kompozimi i sistemit politik, (3) bazat e legjitimitit dhe (4) faktorët strukturorë dhe kulturorë" (f. 51-61).

Çështja e kërkesës për institucione i referohet faktit se, nëse nuk ekziston një kërkesë e brendshme e mjaftueshme për një shtet të mirorganizuar, nuk ka gjasa të ketë sukses një proces shtet-ndërtimi (f. 62). Por, "në mungesë të kërkesës së fortë të brendshme për institucione, kjo kërkesë duhet krijuar nga faktorë/aktorë të jashtëm. Kjo mund të kryhet nga një ose dy burime. I pari përbëhet nga kushte të ndryshme që i bashkëngjiten rregullimit

strukturor, programimit dhe huadhënies nga agjenci të jashtme ndihme, donatorë ose huadhënës individualë. E dyta ka të bëjë me ushtrimin e drejtpërdrejtë të pushtetit politik nga autoritete të jashtme që kanë ngritur pretendimin e dorëzimit të sovranitetit në shtete të dështuara, të shkatërruara ose të pushtuara” (f. 63-72). Prandaj autori thotë se nuk është e pamundur të ndërtohen shtetet nëpërmjet përdorimit të politikës së fuqisë – të paktën deri në një nivel të caktuar.

**Kapitulli 2**, “Shtetet e Dobëta dhe Vrima e Zezë e Administratës Publike”, përmban kontributin më domethënës të Fukujamas. Në të autori nxjerr në pah faktin se, edhe pse njohuritë formale rreth administrimit dhe strukturimit organizativ mund të transferohen nga njëri shtet (apo aktor në përgjithësi) tek tjetri, kjo nuk do të thotë se është e mundur të sajohet një organizatë perfekte, si në kontekstet private ashtu edhe në ato publike. Sipas këtij argumenti ai shfaqet kritik ndaj shumicës së qasjeve dominuese ekonomike të studimit të organizimit institucional, sepse ato shpeshherë anashkalojnë dhe nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur institucioneve informale, si, bie fjala, kulturës organizative.

Në një ambient dinamik ndërkombëtar, pra në një ambient që karakterizohet nga lindja e problematikave të reja dhe, për rrjedhojë, e nevojës për një rregullim organizativ, ekzistojnë tre arsye esenciale që e bëjnë të pamundur hartimin e një organizimi optimal: (1) së pari, shumë qëllime organizative nuk mund të përcaktohen gjithnjë me përpikmëri; (2) së dyti, monitorimi nuk është panacea; dhe (3) së treti, nuk ekziston një rregull fiks për shtrirjen e delegimit të pushtetit. Le t'i shohim me radhë dhe shkurtazi këto tre arsye:

Së pari, nëse individët zotërojnë një racionalitet të kufizuar<sup>4</sup> atëherë nuk është bindëse hipoteza se qëllimet janë të qarta dhe, kësaj, mund të vendosen në formën e një problemi optimal kontrolli. Problemet organizative nuk janë aq mekanike nga sa nënkuptohet prej teorisë së çmimeve. Në fakt, në vend që të rrjedhin sipas një qasjeje në formë koni të kthyer përmbys, shumica e dijes organizative shpërndahet dhe specializohet. Si e tillë ajo nuk i përgjigjet medoemos formalizimit. Shumë probleme organizative zgjidhen nëpërmjet dijes rreth organizimit, e cila shfaqet gjatë procesit reflektues dhe përshtatjes me rrethanat e ndryshueshme – për shembull, përballë inovacioneve ose presioneve ekzogjenike konkurruese.

Së dyti, problemi i stimujve nuk është tipik vetëm për organizatat private, por edhe për ato publike. Dyshja stimul-radhitje, sikurse njihet, “zgjidhet” nëpërmjet monitorimit të produktit [ang. “*output*”], përderisa është e vështirë të matet prurja [ang. “*input*”] – pra munda i harxhuar në punë – në çdo moment të dhënë kohor. Për këtë arsye, skemat stimuluuese – si për shembull “kontrata optimale punësimi” - janë funksione të një produkti të vrojtueshëm dhe të matshëm nga pikëpamja sasiore. Por, sipas Fukujamas, edhe produkti mund të matet me vështirësi, si në rastin e Izraelit (f. 80-88). Por a do të thotë kjo se për vendet në zhvillim institucionet informale janë zgjidhja për performancën e dobët të atyre formale? Fatkeqësisht përgjigja ndaj kësaj pyetjeje nuk është e thjeshtë pasi çështja varet nga maturia e kapitalit social dhe jo nga kapitali social në vetvete.

Problemi i shtrirjes së lirisë së veprimit që i duhet deleguar përbërësve organizativë është problemi i fundit konjitiv, i cili kufizon aftësinë tonë për të ndërtuar organizata optimale. Probleme të tilla ekzistojnë si në sipërmarrjet private ashtu edhe në ato publike, si për shembull federalizmi fiskal (f. 92-108). Në këtë pikë Fukujama i referohet teorikisht sidomos kontributit të dhënë në këtë fushë nga Friedrich A. von Hayek.<sup>5</sup> Ky i fundit argumentonte se

është i pamundur kontrolli qendror ekonomik mbi një ekonomi të planifikuar: asnjë individ nuk mund të zotërojë të gjithë dijen e mjaftueshme. Në realitet, që shumë probleme të zgjidhen, kanë nevojë për “dijen e rrethanave të caktuara kohore dhe hapësinore”.<sup>6</sup> Kështu, mbërrijmë në argumentin e Michael Polanyi, sipas të cilit dija është jo vetëm e shpërndarë, por dhe ideosinkretike.<sup>7</sup> Për të zbritur disa nivele analize më poshtë, kjo nënkupton që, edhe pse në disa raste qeverisja qendrore mund të ketë avantazhe (për shembull në menaxhimin e inovacioneve teknologjike) disa detyra duhen deleguar nëpërmjet një niveli të caktuar decentralizimi. Dhe sigurisht, kjo çon në problemin e sasisë optimale të hapësirës së veprimt, e cila, nga ana e saj, sipas autorit, është partikulare në kohë dhe hapësirë (f. 109-120).

**Në Kapitullin e tretë**, të titulluar “Shtetet e Dobëta dhe Legjitimiteti Ndërkombëtar”, Fukujama lidh problemin e shteteve të dobëta me nivelin ndërkombëtar, duke pohuar se “qeverisja e dobët zhbën parimin e sovranitetit mbi të cilin është ndërtuar rendi ndërkombëtar post-Vesfalian” (f. 139). Megjithatë, përgjigjet e dhëna rreth çështjes së qeverisjes së dobët nga ky kapitull kapërcejnë debatet e kapitujve të mëparshëm. Fukujama përpiqet të lidhë debatin normativ rreth ndërhyrjeve ushtarake<sup>8</sup> me çështjen e ndërtimit të institucioneve efikase. Përfundimet e arritura për çështjet e legjitimitetit ndërkombëtar, demokracisë dhe sovranitetit (dhe qasjet e ndryshme ndaj procesit të ndërtimit të shtetit të Shteteve të Bashkuara dhe Evropës) duhet të shihen si vlerësime që nuk bazohen dhe aq në debatet teorike të dy kapitujve të parë. Ajo që Fukujama dëshiron dhe synon të ofrojë në këtë kapitull, i cili vetëm deri në një pikë të caktuar ndjek linjën argumentative të dy të mëparshmeve, është paralajmërimi dhe analiza e kujdeseshme. Ai bën dallimin midis fazave të ndryshme të procesit të ndërtimit të shtetit dhe artikulon mendimin se vetëm brenda fazës së parë – asaj të rikonstruksionit postkonfliktual – mund të pritet logjikisht të arrihen rezultate të prekshme. Fukujama shfaqet skeptik në lidhje me detyrën e krijimit të institucioneve publike të pavarura nga ndikime të jashtme. Por, në vend të propozimit të zgjidhjeve të reja për brendësimin e kërkesës për institucione, autori propozon në fakt uljen e stekës së nivelit të pritshmërive tona, pasi “...ende nuk kemi gjetur mënyrën se si t'i transferojmë me shpejtësi kapacitetet institucionale” (f. 155).

### **Mbi Qasjen e Fukujamas**

Përpjekja e Fukujamas është impresionuese pasi ai përpiqet të integrojë teorinë bashkëkohore ekonomike institucionale dhe organizative në diskursin realpolitik. Paralelisht mund të identifikojmë tre çështje që ngrihen në lidhje me argumentin e paraqitur nga Fukujama. Së pari, autori është i saktë nga pikëpamja epistemologjike kur i refohet nevojës së konceptimit konstruktiv të ndërtimit të shteteve dhe “eksportimit” të institucioneve të përshtatshme. Të dyja këto çështje kanë qenë përherë në epiqendrën e arenës politike ndërkombëtare. Format që merr procesi i ndërtimit të shtetit janë të rëndësishme për shkak të problemit të shpërhapjes së pasigurisë në komunitetin ndërkombëtar në rastin e dështimit të shtetit/qeverisë. Për më tepër, Fukujama mendon se kemi ende nevojë për të përpunuar format e ndryshme të ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe legjitimitetit të tyre në “shtete sovrane”, si në rastin e Serbisë, Afganistanit apo Irakut. Kjo nxjerr në pah ndërlidhjen e qartë midis atij që emërtohet “rend ndërkombëtar” dhe qeverisjes së shteteve. Por autori e lidh nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar vetëm tematikisht (për shembull ndërtimi i dështuar i shtetit në një cep të



botës ndikon në pjesën tjetër të saj) dhe normativisht (duke u përpjekur të krijojë disa parime udhërrëfyese mbi domosdoshmërinë e ndërhyrjes ndërkombëtare), por jo teorikisht. Kjo na pengon të njohim se shtetet formohen dhe ri-formohen brenda një sistemi ndërshtetëror konkurrence politike dhe ekonomike.<sup>9</sup> Ky nocion kombëtar dhe ndërkombëtar i politikës së fuqisë lidhet jo vetëm me ndërtimin e institucioneve *per se*, por edhe me dinamikat e tyre. Nëse shtetet u zhvilluan edhe si reagim ndaj pozicionit të tyre brenda sistemit ndërshtetëror konkurrues, kjo gjë mund të vërehet fare mirë edhe sot. Për shembull, nuk përbën opsion serioz për liderët politikë të vendeve të zhvilluara mobilizimi i qytetarëve të tyre për të forcuar shtetin dhe për ta përgatitur atë për luftë, siç ndodhi me Francën dhe Anglinë e shekujve XVIII-XIX-të. Shtetet e dobëta janë të detyruara të gjejnë mënyra të tjera për t'i përshtatur situatës.

Fukujama ka të drejtë kur thotë se qeverisja e një shteti luan rol të rëndësishëm në zhvillimin politik dhe ekonomik. Por në vullin e kësaj dëshire të tij të madhe për "ta rikthyer dhe ringjallur rolin e shtetit", ai i konceptualizon në mënyrë të pashmangshme shtetet si njësi të mbyllura analitike, të cilat ndërveprojnë në nivel ndërkombëtar vetëm kur keqmenaxhojnë çështjet e tyre të brendshme. Por shtetet ndërveprojnë për nga natyra me njëri-tjetrin, pavarësisht gjendjes së tyre të brendshme. Ky konstatim e nxit autorin të diagnostikojë një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave do gjendej vetëm me menaxhimin më të mirë të programeve shtetërore. Por analiza e tij bëhet një nivelore – sistemi ndërkombëtar dhe impakti i tij mënjanohet. Gjithsesi, përpjekja e tij për të "rikthyer shtetin" nuk do të thotë ringjallje e kuptimit hobesian të shtetit. Pavarësisht kritikave, debati rreth globalizmit ka shërbyer për të ndërgjegjësuar dhe zgjuar shkencëtarët socialë për mënyrat e shumta me anë të të cilave shtetet kufizohen nga forca ekzogjene dhe për shumëllojshmërinë e aktorëve jo-shtetërorë, lokalë dhe transnacionalë që formësojnë qeverisjen.

Në një farë mënyre, Ndërtimi i Shtetit duhet parë si vazhdim i shkrimit të parë të shumë-debatueshëm të Fukujamas, pas Luftës së Ftohtë "Fundi i Historisë", megjithë ndryshimin e stilit midis tyre. Në atë artikull, shkruar valën e rënies së Bllokut Lindor, Fukujama pretendonte se struktura universale finale e qeverisjes së njerëzve ishte arritur: ajo nuk ishte tjetër veçse ekonomia e tregut dhe liberal-demokracia perëndimore. Duke ndjekur hapat e Hegelit, Fukujama ngriti një pretendim universal: struktura përfundimtare qeverisëse prekte vetëm racën njerëzore: dhe nëse struktura finale qeverisëse nuk ishte arritur ende tjetërkund, kjo ishte veçse çështje kohe, pasi e gjithë bota i nënshtrohej të njëjtave forca historike.<sup>10</sup> Por në librin e tij "Ndërtimi i Shtetit" Fukujama është motivuar nga një çështje me natyrë shumë më pragmatike: si ta arrijnë vendet dhe njerëzimi atë formë finale të qeverisjes njerëzore? Ose, e thënë ndryshe, si t'i ndërtojmë shtetet që të mundësojnë vlerat liberale dhe prosperitetin ekonomik? Në fund të fundit, kjo pyetje motivuese është korridori nëpër të cilin Fukujama ka kanalizuar udhëtimin e tij më të fundit jo-filozofik. Dhe itinerari i ndjekur brenda këtij korridori është "hulumtimi i hipotezës nëse institucionet dhe vlerat e Perëndimit liberal janë realisht universale" – dhe, nëse nuk merren nga të gjitha shtetet mund t'u transferohen atyre në mënyra të caktuara – "apo nëse ato përfaqësojnë, siç argumentoi Samuel Huntingtoni në vitin 1996, thjesht rritjen e disa zakoneve kulturore të disa pjesëve të Evropës Perëndimore dhe Amerikës së Veriut". (f. 25).

## Referenca

<sup>1</sup> Këtu nuk duhen harruar debatet që pasuan artikullin "Fundi i Historisë", *The National Interest*, 16, Verë 1989. Duhet pohuar gjithsesi se në të Fukujama nuk foli për fundin e historisë *për se*, porse për fundin e zhvillimit ideologjik të njeriut, i cili arriti momentumin maksimal në fitoren e liberal-demokracisë perëndimore kundër socializmit të aplikuar të Bllokut Lindor (dhe jo vetëm).

<sup>2</sup> Terminologjia ndoshta mbarë një tjetër ngarkesë kuptimore apo konceptuale kur përdoret në gjuhën fillestare, atë angleze. Kështu respektivisht termat e sipërpërmendur janë "*state-building*" dhe "*nation building*". Për më tepër shih A. Rakipi, "The Weak States and Security", AIIIS, Tiranë, 2008. Gjithashtu, Richard Jackson, "Regime Security and Weak States", në "Contemporary Security Studies", Alan Collins (ed.), Kapitulli 9, Oxford University Press, 2006.

<sup>3</sup> Për më tepër rreth këtij argumenti shih L. Pritchett and M. Woolcock, 'Solutions when the Solution is the Problem: Arraying the Disarray in Development', *World Development* 32(2), Shkurt 2004, ff. 191-212.

<sup>4</sup> Racionalitet në kuptimin e mirënjohur që i është dhënë termit nga Herbert Simon. Shih Kap. 10 nga R. N. Langlois në R. N. Langlois (ed.) "Economics as a Process: Essays in the New Institutional Economics", Cambridge University Press, Nju Jork, 1986.

<sup>5</sup> Shih Pritchett and Woolcock, *ibid.* ff. 191-212.

<sup>6</sup> *Ibid.* 521.

<sup>7</sup> Shih M. Polanyi, "Personal Knowledge: Towards a Post-critical Philosophy", University of Chicago Press, Chicago, 1958.

<sup>8</sup> Pra: kur shtetet duhet të ndërhyjnë, kur konsiderohet legjitim dhunimi i sovranitetit të një shteti dhe çfarë duhet të kërcënohet "kërcënim", kush vendos, dhe a kanë të drejtë Shtetet e Bashkuara të ndërmarrin iniciativa vetmitare në mungesë të institucioneve ndërkombëtare adekuate?

<sup>9</sup> Kjo e fundit përbën një nga postulatet kryesore të teorisë së realizmit politik të marrëdhënieve ndërkombëtare. Më tepër rreth saj shih Hans Morgenthau, "Politics among Nations", Nju Jork: Alfred A. Knopf. Gjithashtu shih Kenneth Waltz, "Theory of International Politics", McGraw-Hill. New York: 1979.

<sup>10</sup> Këtu nuk duhen harruar debatet që pasuan artikullin "Fundi i Historisë", *The National Interest*, 16, Verë 1989. Duhet pohuar gjithsesi se në të Fukujama nuk foli për fundin e historisë *për se*, porse për fundin e zhvillimit ideologjik të njeriut, i cili arriti momentumin maksimal në fitoren e liberal-demokracisë perëndimore kundër socializmit të aplikuar të Bllokut Lindor (dhe jo vetëm).



Shtypi u realizua në shtypshkronjën

**“KRISTALINA-KH”**

Rr. “Lord Bajron”

Tel.: ++355 4 356928;

Cel.: 068 20 38373, Cel.: 069 20 38373

Tiranë / Albania